

Nëntor 2016  
Numri: 104  
E përmuajshme

Revistë edukative-kulturore - [www.revistaetika.com](http://www.revistaetika.com)

# ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë  
Kosovë: 1.5 Euro  
Maqedoni: 90 Den  
Evropë: 7 Euro



## JI I MORALSHËM & ZEMËRGJERË!



*Shtëpia botuese Progresi  
vjen me 6 libra të rinj, të cilët  
do të ushqejnë botën tonë shpirtërore  
dhe do t'i japin drejtim jetës sonë  
individuale dhe shoqërore.*

TË  
RINJ


Një këshillë  
1001 mësimë  
**350 Lekë**  
**3 Euro**



Si edukonte  
Ai (s.a.v.s.)  
**150 Lekë**  
**1 Euro**



101 Parime  
në shërbim  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Shoqetësimi  
për brezat  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Udhëtimi  
drejt Zotit  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**



Shërbimi  
**200 Lekë**  
**1.5 Euro**

**Nëntor 2016**

VITI: X

NUMRI: 104

**BOTUESI**

Shtëpia botuese "Progresi"

**DREJTOR**

Albert Halili

**KRYEREDAKTOR**

Alban Kali

**REDAKTOR**

Zija Vukaj

**PËRKTHYES**

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

**DIZAJN**

Bledar Xama

**ADRESA**

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

**MOBILE**

+355 67 340 6182

**E-MAIL**

rev.etika@gmail.com

**WEBSITE**

www.progresibotime.com

**KOSOVË**

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 4411 9848

**MAQEDONI**

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7042 8245

**ABONIMI VJETOR**

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur

se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrave të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Dije se, nëse nuk kalon mirë me njerëzit, ata do të bëhen armiqtë e tu. Edhe nëse do të jenë prindërit e tu, ata nuk do të të respektojnë. Nëse shkon mirë me një xhemat që nuk është prej të afërmve të tu, ata mund të bëhen si prindër për ty.

Ti mos i kundërshto dhe mos ndërhyj tek njerëzit. Nëse do t'i lësh ata, edhe ata do të të lënë ty. Nëse do t'i ofendosh, edhe ata do të të ofendojnë ty. Nëse do t'i konsiderosh si njerëz të humbur, edhe ata do të të konsiderojnë ty si njeri të humbur. Nëse do të veprosh në këtë mënyrë, kjo do të jetë një njollë edhe për ty, edhe për ne. Nëse do të tentosh të ikësh prej tyre, ky nuk është veprim i zgjuar, sepse, ai që nuk ua fiton zemrat njerëzve në një vend që duhet të sillet mirë, nuk konsiderohet i mençur...

Çdo njeri respektoje sipas gradës së tij. Nderoju njerëzit e nderuar dhe pranoji për të mëdhenj njerëzit e dijes. Respektoji të diturit. Bëj shaka me të rinjtë dhe takohu nga afër me popullin. Kundërshtoji të këqijtë. Formo shoqëri me njerëzit e mirë.

Mos përçmo asnjë njeri. Mos ji i dobët në burrëri dhe mos ia trego askujt sekretin tënd. Mos i beso miqësisë së askujt pa e provuar. Mos u bëj mik me njerëz të poshtër dhe të këqij. Mos rri me mendjelehtët. Kalo mirë me njerëzit. Ji durimtar. "Ji i moralshëm dhe zemërgjerë!"

Rrobat t'i kesh të reja dhe të pastra. Përdor aroma të mira... Ji shumë bujar në të ushqyerit e të tjerëve. Ushqejti të gjithë, sepse njeriu koprrac dhe dorështrënguar nuk mund të bëhet zotëri për njerëzit.

Nëse dëgjon për ndonjë përçarje dhe mosmarrëveshje, menjëherë shko dhe rregulloje. Nëse dëgjon për punë të mira në një vend, nxito për atje. Vizitoji ata që të vizitojnë dhe ata që nuk të vizitojnë.

Ti bëju mirë të gjithëve, edhe nëse ata të bëjnë mirë apo keq. Gjithmonë shfaq mirësi. Fal dhe bëj sikur nuk i sheh disa gjëra. Lëre atë gjë që të mundon dhe përpiqu të veprosh me drejtësi. Vizitoji personalisht shokët e tu që sëmuren. Interesohu për gjendjen e atyre që nuk mund t'i vizitosh. Interesohu edhe për ata që nuk vijnë tek ti...

Shfaq dashuri ndaj njerëzve sa të kesh mundësi. Jepu selam të gjithëve, gofshin ata edhe prej njerëzve të thjeshtë.

Sillu me butësi ndaj tyre dhe trajtoji mirë. Mos u mërzit dhe mos u bezdis nga asnjëri. Mos u propozoj njerëzve që të bëjnë diçka me të cilën nuk janë të ushtruar. Pëlqeje edhe ti atë që pëlqejnë ata. Gjithmonë ki nijet të mirë ndaj tyre. Ji i drejtë ndaj tyre. Mendjemadhësinë lërë në një anë. Nëse ata sillen keq me ty, ti mos u sill keq me ta. Ti mbaje amanetin, edhe nëse të tradhtojnë. Gjithmonë ji njeri besnik dhe i devotshëm. Sillu mirë kundrejt klerikëve të çdo feje.

Ji i moralshëm dhe zemërgjerë!



# Përmbajtja



34

Horizonti i ndërgjegjes  
dhe humanizmit  
Osman Nuri Topbash



Zemra të gjera si det  
që gjejnë e japin qetësi e prehje  
Dr. Adem Ergyl

8



Rrahim - Manifestimi i veçantë i mëshirës  
Ilir Hoxha

40

- 5 Zemra e gjerë si det  
Ahmet Tashgetiren
- 10 Të jesh zemërgjerë  
Prof. dr. Sulejman Derin
- 12 Fitimi i shpërblimit të madh  
Xhafer Durmush
- 14 Ka një problem në lutjet tona  
M. Edip Beki
- 17 Çfarë është Tevekkuli?  
Sadik Dana
- 18 Vetëdija për amanetin  
Nihat Tyzyn
- 19 Unë jam një udhëtar i shkretë  
në rrugën e jetës  
Mehmet Dinç
- 22 Gjuha si dhuratë hyjnore  
Dr. Erzen Koperaj



48


- Thoni inshallah 24  
Adem Saraç
- Tregoni mëshirë dhe butësi 28  
Mustafa Kçyqkashçë
- Mrekullitë e Kuranit 30
- Një Ajet - Një Hadith 32
- Dijetari që ushqehet prej qiellit 46  
Makro Univers
- Karuni e ka mbushur thesarin e tij plot me ar! 48  
Mikro Univers
- Muhasebe 50  
Rrugëtim Shpirtëror
- Alija Izetbegović 52  
Personalitete botërore islame
- Etika dhe estetika përbëjnë një binom 55  
Estetikë
- Istihare, Istishare 56  
Hytbe të zgjedhura



Natë  
Edison Çeraj

51

Motivimi



42



# Ji i moralshëm dhe zemërgjerë

— Ahmet Tashgetiren —

“Ji i moralshëm dhe zemërgjerë!”

Këtë fjalë/pjesë e kam marrë nga libri i Muhamed Ebu Zehrës me titull “Ebu Hanife” kur po shkruaja veprën time me titull “Këshilla të arta”. Kjo pjesë përbëhet prej këshillave që Ebu Hanifja ia dha nxënësit të tij, Jusuf b. Halid Semtit kur e dërgoi në Basra. Kjo pjesë formonte kornizën e “marrëdhënieve njerëzore” të një besimtar. Hazreti Ebu Hanife i jepte përgjigje edhe pyetjes: “Çdo të thotë të jesh një njeri me zemër të gjerë?”

Në librin tim me titull “Këshilla të arta”, pjesën kryesore të këshillave të Ebu Hanifes i kam paraqitur duke i marrë nga Marifetname-ja e Hazreti Ibrahim Hakkë. Në këtë material do të ndaj me ju pjesën që Muhamed Ebu Zehra i jep vend në librin me titull “Ebu Hanife”. Ebu Hanife e këshillon kështu nxënësin e tij:

“Dije se, nëse nuk kalon mirë me njerëzit, ata do të bëhen armiq të tu. Edhe nëse do të jenë prindërit e tu, ata nuk do të të respektojnë. Nëse shkon mirë me një xhemat që nuk është prej të afërmeve të tu, ata mund të bëhen si prindër për ty. Tani po largohesh nga unë dhe po shkon në Basra. Ti nuk

do t'i kundërshtosh dhe nuk do të ndërhysh tek ata. Nëse do t'i lësh ata, edhe ata do të të lënë ty. Nëse do t'i ofendosh, edhe ata do të të ofendojnë ty. Nëse do t'i konsiderosh si njerëz të humbur, edhe ata do të të konsiderojnë ty si njeri të humbur. Nëse do të veprosh në këtë mënyrë, kjo do të jetë një njollë edhe për ty, edhe për ne. Nëse do të tentosh të ikësh prej tyre, ky nuk është veprim i zgjuar, sepse, ai që nuk ua fiton zemrat njerëzve në një vend që duhet të sillet mirë, nuk konsiderohet i mençur...

Kur të hysh në Basra, njerëzit do të të presin, do të të vizitojnë dhe do të të nderojnë. Çdo njeri respektoje sipas gradës së tij. Nderoju njerëzit e nderuar dhe pranoji për të mëdhenj njerëzit e dijës. Respektoji të diturit. Bëj gazmore me të rinjtë dhe takohu nga afër me popullin. Kundërshtoji të këqijtë. Formo shoqëri me njerëzit e mirë. Mos ji indiferent ndaj sulltanit. Mos përçmo asnjë njeri. Mos ji i dobët në burrëri dhe mos ia trego askujt sekretin tënd. Mos i beso miqësisë së askujt pa e provuar. Mos u bëj mik me njerëz të poshtër dhe të këqij. Mos rri me mendjelehtët. Kalo mirë me njerëzit. Ji durimtar. “Ji i moralshëm dhe zemërgjerë!” Rrobot t'i kesh të reja dhe të pastra. Kafshën e transportit



duhet ta kesh të mirë. Përdor aroma të mira... Ji shumë bujar në të ushqyerit e të tjerëve. Ushqejti të gjithë, sepse njeriu koprrac dhe dorështrënguar nuk mund të kalojë në krye dhe të bëhet zotëri për njerëzit.

Nëse dëgjon për ndonjë përçarje dhe mosmarrëveshje, menjëherë shko dhe rregulloje. Nëse dëgjon për punë të mira në një vend, nxito për atje. Vizitoji ata që të vizitojnë dhe ata që nuk të vizitojnë. Ti bëju mirë të gjithëve, edhe nëse ata të bëjnë mirë apo keq. Gjithmonë shfaq mirësi. Fal dhe bëj sikur nuk i sheh disa gjëra. Lëre atë gjë që të mundon dhe përpiku të veprsh me drejtësi. Vizitoji personalisht shokët e tu që sëmuren. Interesohu për gjendjen e atyre që nuk mund t'i vizitosh. Interesohu edhe për ata që nuk vijnë tek ti... Shfaq dashuri ndaj njerëzve sa të kesh mundësi. Jepu salam të gjithëve, qofshin ata edhe prej njerëzve të thjeshtë.

Nëse mblidhesh në një kuvend me disa njerëz apo gjendesh me ta në një xhami dhe ata debatojnë rreth disa çështjeve duke u shprehur në kundërshtim me ato që di ti, mos i kundërshtoj ata. Nëse të pyesin edhe ty, shpjegojua siç e dinë ata. Pastaj u thuaj që në atë çështje ka edhe një mendim tjetër. Tregojua atë që di duke ua shprehur edhe argumentin. Në këtë mënyrë, ata do të të dëgjojnë dhe do ta kuptojnë gradën që ke në dije. Nëse të pyesin se mendimi i kujt është ai që u the, u thuaj se është mendimi i disa fukahave. Nëse vazhdon në këtë mënyrë, ata do të mësohen me ty dhe do të të nderojnë. Për këtë arsye, të rritet edhe pozita.

Jepu dije të gjithë atyre që vijnë te ti. Secili prej tyre le të mësojë diçka prej teje. Jepu atyre të dhëna të vlefshme dhe mos u preokupo me gjëra të parëndësishme. Ji si shok me ata. Madje nganjëherë bëj edhe gazmore, sepse miqësia dhe sinqeriteti i bën ata të marrin dije vazhdimisht prej teje. Herë pas here jepu për të ngrënë dhe plotësojua nevojat. Dijua vlerën dhe mbylli sytë kundrejt mangësive të tyre.

Sillu me butësi ndaj tyre dhe trajtoji mirë. Mos u mërzit dhe mos u bezdis nga asnjëri prej tyre.

Veten mbaje sikur të ishe njëri prej tyre. Mos u propozoj njerëzve që të bëjnë diçka me të cilën nuk janë të ushtruar. Pëlqeje edhe ti atë që pëlqejnë ata. Gjithmonë ki nijet të mirë ndaj tyre. Ji i drejtë ndaj tyre. Mendjemadhësinë lërë në një anë. Nëse ata sillen keq me ty, ti mos u sill keq me ta. Ti mbaje amanetin, edhe nëse të tradhtojnë. Gjithmonë ji njeri besnik dhe i devotshëm. Sillu mirë kundrejt klerikëve të çdo feje.”

Një fjalë e urtë thotë: “Të gjithë librat e dijetarëve myslimanë janë për të kuptuar një Libër.” Këtë fjalë mund ta shpjegojmë edhe kështu: Të gjitha fjalët e dijetarëve myslimanë janë shpjegim dhe tefsir i atij Libri. Po ashtu shpjegojnë edhe Sunetin e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut goftë mbi të. Ndoshta mund të

shprehemi edhe kështu: Të gjitha përpjekjet për ta arritur personalitetin prej besimtari mysliman janë mbartje në jetën tonë të mirësive të të Dërguarit të Allahut (a.s.).

Ajeti fisnik i mëposhtëm ka zbritur mbi mendimet e ndryshme që dolën në pah përgjatë diskutimeve të luftës ndërjet sahabëve të nderuar dhe të Dërguarit të Allahut (a.s.), në luftën e Uhudit:

**“Në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta (o Muhamed). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoji falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai.”** (Al Imran, 159)

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ishte Pejgamber, kryetar shteti dhe komandant. Në Uhud, i cili ishte vendi ku u përjetua ndoshta momenti më i vështirë i jetës profetike të të Dërguarit të Allahut (a.s.), këto tri cilësi u ndërthurën natyrshëm. Siç e shikojmë, kjo natyrshmëri buron nga takimi me “mëshirën e Allahut Teala”, ndërsa rezultati i saj është “sjellja e butë dhe falja”. Në thelbin e kësaj sjelljeje nuk ka “ashpërsi dhe zemërngurtësi”. Konsultimi me ata që udhëheqin, në çfarëdo çështjeje apo grade që të jenë, duhet të bëhet me këto “cilësi

*Të përparosh në jetë me një zemër që i përjashton të tjerët është shumë e vështirë. Të formosh familje është e vështirë. Të jetosh në lumturi më bashkëshorten dhe fëmijët është e vështirë. Formimi i marrëdhënieve të shëndetshme është i vështirë në jetën e biznesit. Të marrësh produktivitet nga ata që i kemi nën udhëheqje kur të bëhemi udhëheqës është e vështirë. Kur të udhëheqim shtetin, është e vështirë të gesh rehati me popullin dhe ata që i kemi nën udhëheqje. Ndërtimi i një mjedisi të qetë brenda një shoqërie me besim është i vështirë...*

shpirtërore”. Siç e kuptojmë edhe nga fundi i ajetit fisnik, në thelbin e këtyre cilësive shpirtërore gjendet “ndjeshmëria për t’iu mbështetur Allahut Teala” pasi të funksionojnë në mënyrën më të mirë proceset e “vendosmërisë”. Ndërsa ndjeshmëria për t’iu mbështetur Allahut (xh.xh.), i jep njeriut këtë vetëdije: “Ti nuk ke fuqi për ta zgjidhur çdo gjë vetë. Asnjëherë mos e harro fuqinë përfundimtare dhe caktimin e Allahut Teala në çdo punë. Për këtë arsye, lija Allahut Teala gjykimin për vendimin përfundimtar, i vogël apo i madh qoftë ky vendim. Në këtë mënyrë, do të marrësh shpërblimin dhe begatinë e nënshtrimit ndaj Tij.”

Ne kemi dëshmuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), i ka kaluar me një prehje shpirtërore të tillë të gjitha pengesat përgjatë procesit për të qenë një njeri i thjeshtë nga njëra anë dhe kryerjes së një detyre mjaft të vështirë siç është profecia nga ana tjetër.

Le të mendojmë pak rreth jetës së të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, në Mekë. Le të mendojmë pak rreth përjashtimeve dhe bojkoteve që i vunë të afërmit e tij përgjatë viteve të para të predikimit të Islamit. Le të mendojmë pak gjendjen e atyre që torturoheshin në mënyrat më çnjerëzore apo detyroheshin të emigronin ngaqë i kishin besuar atij. Le të mendojmë pak për gjendjen e të Dërguarit të Allahut (a.s.), kur nuk kishte më asnjë vend për t’u strehuar, kur e kërcënonin me vdekje, kur u detyrua të largohej nga vendlindja. Le të mendojmë pak se si ua vuri gjoksin i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, problemeve që lindnin pikërisht ndërmjet besimtarëve përgjatë fitoreve dhe humbjeve në luftërat që zhvilloi pasi emigroi në Medinë. Le të mendojmë pak për plagën e madhe që hapën në zemrën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), dëshmorët e Uhudit si Hamzai (r.a.) dhe Mus’abi (r.a.), për të cilët ai (a.s.), ndjente një dashuri të madhe për ta. Le të mendojmë pak për tensionet që dolën në pah ndërmjet besimtarëve të parë në ndarjen e mallrave të luftës. Le të mendojmë pak për lëvizjet njerëzore që ndodhën në jetën familjare të të Dërguarit të Allahut (a.s.), të cilat ndikuan në botën shpirtërore të tij. Le të mendojmë pak për shqetësimet që i Dërguari i Allahut (a.s.), ndjente për të ardhmen e umetit dhe për reflektimet e tyre në zemrën e tij...

Dashuria dhe udhëheqja e tij përgjatë një periudhe njëzet e tre vjeçare që erdhën vetëm duke u lartësuar janë si rezultat i prehjes së tij shpirtëro-

re. Për këtë arsye, ajo që i takon besimtarit është mbartja e kësaj prehjeje shpirtërore të të Dërguarit të Allahut (a.s.), në jetën e tij. Ne si njerëz kemi disa gjëra të përbashkëta me Pejgamberin tonë të nderuar. Pra, kemi fuqi, fitojmë, harxhojmë, martohemi, bëhemi me bashkëshort/e, formojmë shumë marrëdhënie me njerëzit, etj... Ndërsa si besimtar jemi të obliguar t’i kryejmë detyrat që na ka lënë i Dërguari i Allahut (a.s.), si: Të besojmë, të bëjmë një jetë siç i ka hije besimtarit dhe të mbartim përgjegjësinë e predikimit që do të thotë, ta përcjellim Islamit te një person i dytë...

Të gjitha këto e bëjnë të domosdoshme përforcimin e cilësisë së zemrës. Edhe nëse nuk do të kemi në zemër të njëjtën pjekuri që ka pasur i Dërguari i Allahut (a.s.), posedimi i një zemre të gatshme për të mbartur “Amanetin” edhe si njeri i thjeshtë, edhe me vetëdijen e nënshtrimit ndaj Allahut Teala, është një qëllim që duhet të arrihet.

Të përparosh në jetë me një zemër që i përjashton të tjerët është shumë e vështirë. Të formosh familje është e vështirë. Të jetosh në lumturi më bashkëshorten dhe fëmijët është e vështirë. Formimi i marrëdhënieve të shëndetshme është i vështirë në jetën e biznesit. Të marrësh produktivitet nga ata që i kemi nën udhëheqje kur të bëhemi udhëheqës është e vështirë. Kur të udhëheqim shtetin, është e vështirë të gjesh rehati me popullin dhe ata që i kemi nën udhëheqje. Ndërtimi i një mjedisi të qetë brenda një shoqërie me besim është i vështirë... Përfundimisht, të qenët zemërgur do të jetë burim jo i koherencës, por i përçarjes. Domethënë, nuk do të jetë burim harmonie, por shkatërrimi.

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: **“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”** (Furkan, 63) Përgjatë jetës nuk takohemi gjithmonë vetëm me njerëz të rregullt. Për këtë arsye, gjithmonë do të ketë “injorantë” që nuk e kuptojnë përgjegjësinë e ekzistencës së tyre në këtë botë. Por qëndrimi i besimtarit edhe kundrejt atyre është të përgjigjurit me “Selam/paqe”. Të thënët “Selam” është vepër e një zemre të qetë. Domethënë, vepër e një zemre të pastër, të dëlirë, të qetë dhe të gjallë që mund ta gjallërojë edhe atë që shkon për ta vvarë. Çfarë të themi tjetër? Allahu Teala na e dhëntë të gjithëve një pjekuri shpirtërore të tillë!



# ZEMRA TË GJERA SI DET

*që gjejnë dhe japin Qetësi e Prehje*

Dr. Adem Ergyl

Në Kuranin Fisnik, Allahu Teala, flet për zgjerimin dhe ngushtimin e kraharorëve. Në këtë kontekst përdor shprehjet “sherhu’s-sadr” dhe “diku’s-sadr”. Pastaj e shtjellon lidhjen që ka kjo gjendje me besimin dhe Islamin. Gjithashtu nxjerr në pah të vërtetën se zemrat që hapen ndaj Islamit shndrisin me një dritë prej Zotit (xh.xh.) dhe pastrohen prej shqetësimeve.

Kur fjala “sherh”<sup>1</sup>, që në kuptimin leksikor do të thotë të hapësh, të zgjerosh dhe të shpjegosh një shprehje të mbyllur apo më kuptim indirekt, i bashkëngjitet sadrit (kraharorit), siç shprehet edhe Ragib el-Isfehani, do të thotë: “Hapje dhe zgjerim i kraharorit me një prehje dhe dritë hyjnore.”<sup>2</sup> Ndërsa fjala “dik”, që përdoret për të shprehur varfërinë, koprracinë dhe shqetësimin e brendshëm, përdoret edhe në kuptimet si, të ngushtohesh, të mërzitesh dhe të brengosesh. Kur kësaj fjale t’i shtohet edhe fjala “sadr”, mbart kuptimet si, shqetësim i brendshëm, stres, mërzitje, pikëllim dhe brengosje.<sup>3</sup>

Çështja e zgjerimit të zemrës (sherhu’s-sadr) dhe ngushtimit të saj (diku’s-sadr), së pari është një temë që mund të shtjellohet si hapje apo ngushtim i rrugës së zemrës nga këndvështrimi i besimit apo mohimit. Me një shprehje tjetër, hapja e perdes së inkarit/mohi-

mit që e mbështjell zemrën dhe hyrja e dritës së besimit në zemër është “sherhu’s-sadr”, ndërsa mbulimi i zemrës me mëkatin e inkarit është “diku’s-sadr”. Ky ajet fisnik që do të transmetojmë tani qartazi shpreh këtë kuptim: **“Allahu ia hap zemrën për (të pranuar) Islamin atij që dëshiron ta udhëzojë, ndërsa atij që dëshiron ta lërë në humbje, (ia mbyll zemrën e) ia shtrëngon gjoksin si të jetë duke u ngjitur në qiell. Kështu, Allahu, i ndëshkon ata që nuk besojnë.”**<sup>4</sup>

Prehja dhe qetësimi i zemrës që ngushtohet për shkak të faktorëve të jashtëm, mund të konsiderohet si një lloj i “sherhu’s-sadrit”. Allahu i Lartësuar, i Cili na njofton se të Dërguarit të Tij iu ngushtua kraharori për shkak të thashethemeve dhe sjelljeve të femohuesve<sup>5</sup>, e këshillon kështu Hz. Pejgamberin për t’ia qetësuar zemrën: **“Prandaj duro! Durimi yt është vetëm me ndihmën e Allahut. Dhe mos u pikëllo për ta e mos u ngushto për shkak të dredhivë të tyre!”**<sup>6</sup> Nisur nga kjo, pastrimi i zemrës së të Dërguarit të Allahut (a.s.), nga shqetësimet e brendshme e pikëllimet dhe prehja e qetësia e saj prej këtyre është një lloj “sherhu’s-sadr”. Për këtë arsye, edhe ajeti: **“Vallë, a nuk ta hapëm dhe zgjeruam ty (Muhamed)**

4. En’am, 125.

5. “Ne e dimë mirë, që ty të ngushtohet zemra nga fjalët e tyre...” (Hixhr, 97) Në lidhje me këtë çështje ka edhe ajete të tjera. (Shik. Hud, 12; Nahl, 127; Shuara, 24-25; Neml, 70.)

6. Nahl, 127.

1. Shik. Ragib, Mufredat, fq. 258; Asim Efendi, Kamus, I, 909.

2. Ragib, Mufredat, fq. 258.

3. Ragib, Mufredat, fq. 300; Asim Efendi, Kamus, 924.



**kraharorin?**<sup>7</sup> – është komentuar edhe në formën: “A nuk të shpëtua dhe qetësua ty (Muhamed) nga shqetësimet dhe pikëllimet?”<sup>8</sup>

Këto lloj shqetësimesh dhe qetësimesh që ndodhin në një zemër me besim mund të shprehen edhe me termat kabz (ngushtim) dhe bast (zgjerim). Fjalët kabz (inkibaz) dhe bast (inbisat) që më së shumti njihen si terma mistikë, janë përmendur pranë njëra-tjetrës në këtë ajet të Kuranit Fisnik: “...**Allahu e shtrëngon (kabz) dhe e liron/zgjeron (bast) (riskun)...**”<sup>9</sup>

Edhe një çështje tjetër që mund të vlerësohet si “sherhu’s-sadr” është ngjarja e largimit të shqetësimeve, zhdukja e telasheve dhe vendosja e prehjes në zemër. Lutja e Musait (a.s.): “**O Zoti im! Zgjeroma kraharorin tim, lehtësoma punën time dhe zgjidhja nyjen e gjuhës sime!**” (Ta Ha, 25-27) – në këtë kontekst është “sherhu’s-sadr”. Edhe një herë tjetër Musai (a.s.), i parashtrori Zotit (xh.xh.), këtë kërkesë: “O Zoti im! Unë kam frikë se ata do të më përgënjeshtrojnë. Kraharori po më ngushtohet dhe gjuha s’po më zgjidhet. Për këtë arsye, jepi profeci edhe Harunit!” Në këtë kontekst, “sherhu’s-sadr” mund të shpjegohet edhe si qetësim i zemrës së njeriut dhe shtim të forcës për përballimin e vështirësive.

Ndërkohë që ngushtimi i zemrës e shndërron jetën në një xhehenem të vërtetë, zgjerimi i zemrës e kthen jetën në një paradys. Bota jonë e brendshme që fillon të zgjerohet me besim, në sajë të kësaj gjen prehjen dhe rehatinë për t’u dhënë përgjigje shumë pyetjeve që e shqetësojnë zemrën. Ndërkohë që hallkat e para të zgjerimit të zemrës realizohen me besim, ky zgjerim arrin hallka edhe më të gjera me zbatimin e dispozitave të Islamit dhe përjetimin e moralit të tij. Gjendja e njeriut për të qenë dhe për t’u ndjerë sikur e sheh Allahun në çdo gjë që bën, domethënë, kur njeriu arrin në gjendjen e ihsanit, atëherë, nuk mund t’i vihet ndonjë kufi gjerësisë së botës shpirtërore të tij. Veçanërisht mistikët i japin rëndësi të madhe zgjerimit të zemrës. Madje, bëjnë një lidhje direkte ndërmjet zgjerimit të zemrës dhe arritjes së nivelit njeri i përsosur. Mevlana Xheleddin Rumi (k.s.), e përshkruan kështu pakufizueshmërinë e zemrës:

“Zemra është një qenie në të cilën humbasin dhe bëhen të padukshëm njëqind qiej si këta shtatë qiej.”<sup>10</sup>

Kur bota shpirtërore pastrohet dhe edukohet, njeriu mund të shpëtojë nga ngushtimi i brendshëm. Ata njerëz që kanë brenda smirë, urrejtje dhe mendjemadhësi, natyrisht që përjetojnë ngushtim të zemrës. Egoizmi dhe koprancia janë prej sëmundjeve më të rënda shpirtërore që e ngushtojnë zemrën. Dhënia e zemrës pas kësaj bote dhe gjërave që ajo mbart, apo me një thënie tjetër, dhënia e zemrës pas dashurive

të përkohshme, përbën shqetësim shpirtëror. Një ditë Mevlana Xhelaleddin Rumi pa njërin prej ndjekësve të tij që ishte i mërzitur dhe i tha:

“Bir! I gjithë ngushtimi i zemrës vjen nga lidhja e zemrës me këtë botë. Nëse e konsideron veten një hiç, mund të shikosh çdo lloj ngjyre dhe mund të marrësh kënaqësi nga çdo lloj shijeje. Pastaj do t’ia hapësh krahët një bote të atillë që asnjëherë në të nuk do të përjetosh ngushtim të zemrës.”

Sahibu’l-vefa, Musa Efendi (k.s.), thotë:

“Njerëzit që janë të përkushtuar ndaj dëshirave të nefsit, edhe nëse kanë shumë ibadete, prapë se prapë janë të dëshpëruar, sepse kraharorët (zemrat) i kanë të ngushta. Ato që pëlqejnë janë vetëm opinionet dhe mendimet e tyre. Kudo që të gjenden këta njerëz, nxjerrin kontradikta, sepse bota shpirtërore e tyre është e errët. Sado që të bëhen përpjekje, me njerëz të tillë nuk mund të ndërtohet një raport miqësor. Kur këtyre njerëzve t’u tregoni të bardhën, thonë se është e zezë, edhe pse e dinë që është e bardhë. Kur t’u tregoni të zezën, thonë se është e bardhë, edhe pse e dinë se është e zezë. Njerëzit e tillë absolutisht nuk mund të duan asnjë. Për shkak se nuk duan asnjë, nuk duhen edhe nga njerëzit e tjerë, sepse ata kanë moral të ulët. Për këtë arsye, me këta njerëz asnjëherë nuk duhet të këshillohemi, madje, duhet të qëndrojmë larg tyre sa të jetë e mundur. Gjendja e ngushtimit të zemrës është një sjellje e çuditshme që shikohet te njerëzit e ashpër, që e shikojnë veten mbi vëllezërit besimtarë të tjerë duke u mposhtur nga ndikimi i nefsit, që s’kanë vizion dhe që janë mendjengushtë. Ata që janë në këtë gjendje nuk mund të kenë marrëdhënie të mirë me asnjë njeri. Ata nuk kanë vendosmëri në asnjë punë dhe e gjithë dita e tyre kalon me zemërim dhe shqetësim. Këta njerëz bëjnë më shumë dëm se dobi. Këtë dëm ia bëjnë edhe vetes, edhe shoqërisë.”

Nëse dëshirojmë ta bëjmë këtë botë një vend në të cilin jetohet, madje, në të cilin merret frymë lirisht krahas të gjitha dhimbjeve dhe gëzimeve, baticave e zbaticave, vështirësive e lehtësive, mund t’ia dalim mbanë vetëm me zgjerimin e zemrës. Ata të cilët e zgjerojnë zemrën, edhe vetë janë të qetë, edhe të tjerëve u falin prehje e qetësi. Gjëja për të cilën kanë më shumë nevojë njerëzit në jetën familjare, në jetën e biznesin, në fushat e shërbimeve fetare, në marrëdhëniet me fqinjët, shokët dhe miqtë, është pjekuria për zgjeruar zemrën. Ata që e kanë zemrën e gjërë, nuk mund të ndoten dhe turbullohen. Ajo që duhet të bëjmë në këtë rrugë është arritja e bindjes absolute në besim me anë të pastrimit dhe edukimit serioz të nefsit, zbatimi i dispozitave të Islamit, përjetimi i moralit të Islamit dhe më kryesorja, zgjerimi i zemrës me dhikër të vazhdueshëm aq sa ajo të mund ta përfshijë të gjithë universin dhe të fitojë vetëdijen se gjithmonë jemi nën vëzhgimin e Allahut Teala.

7. Inshirah, 1.

8. Elmallëllë, VIII, 5911.

9. Bakara, 245.

10. Mesnevi (përkth. Shefik Khan), V, 80, bejt: 872; Veçanërisht shik. Mesnevi, I, 223, bejt: 3488.

# Të jesh zemërgjerë



Zemërgjerësia dhe prehja shpirtërore vijnë në krye të cilësive që i kemi humbur sot në krahasim me kohët e kaluara. Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik se zemrat qetësohen dhe gjejnë prehje vetëm duke e përmendur Zotin (xh.xh.). Për këtë arsye, aq sa të largohemi nga dhikri/përmendja e Zotit (xh.sh.), rrethohemi dhe rrëmbehemi nga shqetësime të brendshme, stresi dhe ndjenja negative. Miqtë e Allahut Teala, mistikët e mëdhenj kanë caktuar makame (gjendje, pozita) të ndryshme në çështjen e robërisë së vërtetë kundrejt Allahut të Madhëruar. Sipas Gazaliut, makami më i lartë është “makami riza” (gjendja në të cilën robi e pranon me nënshttrim e përlulje çdo gjë që i vjen nga Zoti). Në sajë të këtij makami, robi e pranon çdo gjë që i vjen nga Allahu i Lartësuar dhe nuk u jep aspak rëndësi vështirësive dhe problemeve që vijnë nga njerëzit.

Sekreti që sufitë / mistikët ia kanë dalë mbanë për t’u bërë zemërgjerë, gjendet në të vërtetën se ata gjithmonë preokupohen me përmendjen e Allahut Teala. Udhëtari i kësaj rruge, i cili e ka zemrën plot me dhikër, shkëputet nga krijesat dhe lartësohet drejt Zotit (xh.sh.). Ndërsa ata që nuk ia dalin mbanë për ta bërë këtë, të gjithë vëmendjen e tyre ua përkushtojnë gjërave që të tjerët bëjnë kundrejt tyre. Siç shprehet edhe Mevlana, Xhelaledin Rumi, luftojnë me kadanë dhe kaderin:

“O njeri i zemëruar! Mos lufto me kadanë dhe kaderin, në mënyrë që edhe kazaja e kaderi të mos luftojë me ty.

Ti duhet të jesh si i vdekur kundrejt ligjit dhe caktimit të Allahut, në mënyrë që mos të të vijë ndonjë ndëshkim nga Allahu, i Cili është Zoti i agimit.”

Veçanërisht për lumturinë në familje, bashkëshortët duhet t’i kenë zemrat e tyre të lara me dritën e dhikrit. Nëse bashkëshortët nuk e përmendin Allahun e Madhëruar dhe nuk marrin mësim shpirtëror, së pari i bëjnë dëm vetes dhe pastaj të gjithë pjesëtarëve të tjerë të familjes. Mevlana e shpjegon si më poshtë këtë gjendje:

“Burrat injorantë dhe të ashpër kanë pak hijeshi, mirësi dhe dashuri, sepse në natyrshmërinë e tyre sundon cilësia kafshërore. Dashuria është hijeshi, dhembshuri dhe veti njerëzore. Domethënë, është cilësi njerëzore. Ndërsa zemërimi dhe epshi janë veti kafshërore. Pra, cilësi të kafshëve.” (Vëll. I, 2434-35)

Imam Gazaliu e shpjegon çështjen e zemërimit dhe të epshit në kontekstin e engjëjve dhe kafshëve. Engjëjt i kanë zemrat e qeta dhe nuk bëjnë mëkat në asnjë çështje, ngaqë janë të krijuar plotësisht nga drita. Ndërsa kafshët janë të krijuara për të kënaqur instinktet dhe epshet e tyre. Për këtë arsye, synimi i vetëm i tyre është që të bëjnë gjëra që u japin kënaqësi atyre. Ndërkohë njeriu është krijuar me një natyrshmëri engjëllorë dhe kafshërore. Kur pason epshin e tij, u afrohet kafshëve. Ndërsa kur pason mendjen, u afrohet engjëjve. Nisur nga kjo, për ta arritur prehjen shpirtërore duhet të qëndrojmë larg epshit dhe zemërimit siç na orientojnë urdhrat e Allahut (xh.xh.). Me një thënie tjetër, të jesh njeri do të thotë që t’i kesh nën kontroll epshin dhe zemërimin.

Nisur nga këto që thamë më lart, vetëm kafshët nuk mund t’i marrin nën kontroll zemërimin dhe epshin. Ata, nisur nga natyra në të cilën janë krijuar, e sulmojnë çdo gjë që e shikojnë në kundërshtim me



to. Ndërsa njeriu që është njeri, e përdor epshin dhe zemërimin në vendin e duhur dhe nuk bie rob i tyre. Ai asnjëherë nuk merr hak për çështje personale. Shembulli më i bukur i mistikëve në lidhje me këtë çështje është ngjarja me Ali ibn Ebi Talibin (r.a.), i cili e fali qafirin që e pështyu në fytyrë dhe nuk ia hoqi kokën, ngaqë nefsi u përzie në atë çështje. Mevlana, Xhelaleddin Rumi u tregon këtë ngjarje duke e vënë Aliun (r.a.), në rolin e folësit:

“Zemërimi është padishahu i padishahëve, por ai është robi ynë. Unë ia kam lidhur gojën zemërimit. Shpata e butësisë sime ia ka prerë kokën zemërimit tim. Për këtë arsye, zemërimi i Zotit është bërë mëshirë dhe prehje për mua (shpresoj që Zoti të mos më ndëshkojë). Prandaj, kur po luftoja, e gjykova më të drejtë uljen e shpatës, ngaqë mendova se mund të kaplohesha nga egoizmi dhe zemërimi kur më pështyve në fytyrë.”

Sipas mistikëve, shkakun më kryesor i ngushtimit të zemrave është e vërteta se njerëzit mendojnë vetëm për nefsin e tyre duke e nënvlerësuar botën shpirtërore dhe se janë të përkushtuar për të bërë një jetë plot argëtim e dëfrim. Kur nefsi mësohet të bëjë çfarëdo që të dëshirojë dhe kur i jepet çfarëdo që të kërkojë, asnjëherë nuk mund të bëhet i lumtur, por përkundrazi, siç e shtojnë më tepër drutë zjarrin, edhe këto e shtojnë zjarrin e epshit të nefsit. Si rezultat, tymi i këtij zjarri e nxin dhe e ngushton zemrën. Për këtë arsye, nëse dëshirojmë ta pakësojmë tymin që gjendet në zemrat tona, së pari duhet të përpiqemi të mos i hedhim më shumë dru atij dhe ta fikim. Kur njeriu bën çfarëdo që i kërkon nefsi, nefsi fillon e kaplohet nga prirja për të zotëruar. Pastaj fillon e zemërohet kundrejt atyre që nuk e lavdërojnë dhe nuk e duan. Kur nefsi fillon ta shikojë ekzistencën e saj mbi çdo gjë tjetër, vjen në një gjendje që nuk pranon asnjë lloj kundërshtimi. Për këtë arsye, mistikët e konsiderojnë të domosdoshme vrasjen e nefsit, domethënë, marrjen e tij nën kontroll të rreptë.

“Vendosja gishtin kokës dhe vrite atë nefsin e keq, sepse, për shkak të atij nefsi të keq, çdo moment cenon ekzistencën e ndonjë krijese të nderuar.

Për shkak të nefsit, e gjithë kjo botë e gjerë të duket e ngushtë. Për shkak të nefsit, lufton me Zotin dhe me njerëzit.

Nëse e vret nefsin (nuk i merr në konsideratë kërkesat e tij) dhe nuk ia dëgjon fjalën, do të shpëtosh nga kërkimi i ndjesës ndaj të tjerëve në sajë të mosrënies në gabime. Përveç të tjerash, nuk do të kesh asnjë armik në vendin ku jeton.” (Vëll, II, 783-85)

Sipas mistikëve, vrasja e nefsit ka dy dimensione. Dimensio- ni i marifetit dhe dimension i veprës. Dimensio- ni i marifetit do të thotë të perceptosh se ka një qenie e cila na bën të zemërohem, na mbush

botën tonë të brendshme plot e përplot me ndjenja negative dhe që na shfaqet si mik, por që në të vërtetë është një armik që na shpie drejt shkatërrimit të sigurt. Kur besimtari i devotshëm e mëson një herë se nefsi është armik i vërtetë i njeriut, nuk ua vë veshin pëshpëritjeve të tij. Për fat të keq, në ditët e sotme shumë myslimanë janë kapluar nga pëshpëritjet e nefsit emmare. Si rezultat, i zbatojnë me plot kënaqësi të gjitha urdhrat e tij.

Së dyti, mistikët e shuajnë zjarrin e nefsit që gjendet në zemër me anë të dritës së përmendjes së Allahut të Lartësuar. Drita e nuri i përmendjes së Allahut Teala që përftohet nga gjuha e një besimtari të devotshëm, i djeg të gjitha ndjenjat e këqija që gjenden në zemër, madje, e shuan edhe zjarrin e zemërimit. Për sa i përket kësaj çështjeje, mistikët e kanë bërë udhërrëfyes këtë hadith fisnik për veten e tyre. Kur njerëzit e devotshëm dhe ata që i bëjnë dhikër Allahut të kalojnë mbi Siratin (ura e Siratit që do të vendoset mbi Xhehenem), zjarri i Xhehenemit fillon të flasë dhe u thotë: “*O besimtarë! Kaloni shpejt, sepse drita juaj e shuan zjarrin tim.*” (Xhamiu’s-Sagir). Zemra e besimtarit zgjerohet aq shumë me përmendjen e Allahut Teala saqë ai nuk u përgjigjet të këqijave që i bëhen atij dhe që kanë të bëjnë vetëm me atë. Pasqyra e zemrës së tij nuk ndotet me avullin e veprave që bëjnë robërit e tjerë.

Zemërgjerësia nuk është një çështje që ka të bëjë vetëm me mirësjelljen personale të njeriut siç pënde- hin disa. Përkundrazi, siç shprehet shpesh edhe Imam Rabbani (r.a.), në Mektubatin e tij, ajo ka të bëjë edhe me të ardhmen e njeriut në jetën tjetër. Këto hadithe fisnike që Imami i ka përfshirë në letrën e tij të 98-të, janë tepër të rëndësishme sa i takon të vërtetës se njerëzit me zemër të ngurtë nuk do të hyjnë dot në Xhenet:

“*Kini kujdes, po ju tregoj për njeriun që e ka haram (të ndaluar) hyrjen në Xhehenem dhe që Xhehenemi e ka haram ta djegë atë. Ky është njeriu modest, që ua lehtëson gjërat të tjerëve, i dashur dhe i butë.*” (Ahmed, Musned, nr: 3938.) “*Besimtarët janë të qetë dhe të butë si një deve që i është vënë kapistra në hundë (kokë). Nëse lidhen në një vend, qëndrojnë të qetë. Nëse u kërkohet të ulen në ndonjë gur, ulen.*” (Dejlemi, el-Firdevs, nr: 6583) (Mektubat, vëll. I, letra e 98-të.)

Përfundimisht, dhikri që bëhet për Allahun Teala i pastron katër faktorët kryesorë që përbëjnë njeriun e që janë: ajri, uji, toka dhe zjarri. Si rezultat, në pah dalin njerëz me zemër të dëlirë dhe të gjerë. Ata janë zemërgjerë ndaj kadasë dhe kaderit të Allahut (xh. xh.) dhe vështirësive që u shkaktojnë njerëzit e tjerë. Prandaj, i lutemi Zotit (xh.sh.), që të na bëjë prej këtyre robërve dhe të na dhurojë zemërgjerësi!



Xhafer Durmush



# Fitimi i shpërblimit të madh

Allahu Teala në suren Isra thotë: **“Në të vërtetë, ky Kuran udhëzon drejt asaj që është më e mira dhe u jep lajmin e gëzuar besimtarëve, që bëjnë vepra të mira se ata do të kenë shpërblim të madh. Ndërsa atyre që nuk besojnë në jetën tjetër, Ne u kemi përgatitur dënim të dhembshëm.”** (Isra, 9-10)

Tani dëshiroj që t'ia hapim zemrën tonë ngrohësisë së “shpërblimit të madh”, për të cilin flitet në ajetin fisnik. Nisur nga kjo, dëshiroj që përsëri t'i lexojmë ajetet fisnike të cilat i ftojnë besimtarët për te shpëtimi i përhershëm dhe për të kërkuar shpërblimin e madh. E vërteta është kjo se Allahu i Lartësuar na fton ne për te kopshtet e Xhenetit që quhet Daru's-Selam. Na fton që të shpëtojmë nga errësirat e mëkateve dhe gjynaheve e të synojmë dritën e pëlqimit të Tij. Zoti (xh.xh.), na i ka treguar me të gjitha detajet e tyre rrugët që na mundësojnë për të fituar kënaqësinë e Tij. Për këtë arsye, na tregon cilësitë / veprat e atyre që e arrijnë shpëtimin e përhershëm dhe e fitojnë këtë shpërblim të madh. Nisur nga kjo, ata që do të shpëtojnë janë ata:

**“...Të cilët besojnë në të fshehtë, falin namazin dhe japin nga ajo që u kemi dhënë Ne; dhe ata që besojnë në atë që të është shpallur ty (o Muhamed), në atë që është shpallur përpara teje dhe që me bindje i besojnë jetës tjetër.”** (Bekare, 3-4)

**“...Që kryejnë namazin, japin zeqatin dhe besojnë bindshëm në jetën tjetër. Këta janë udhëzuar nga Zoti i tyre dhe vetëm këta janë të shpëtuar.”** (Lukman,

4-5) **“...Të cilët janë të përlurur në namazin e tyre dhe të cilët shmangen nga fjalët e kota.”** (Mu'minun, 2-3) **“...Që thërrasin në mirësi, urdhërojnë për vepra të mira e ndalojnë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit.”** (Al Imran, 104)

**“Nuk gjen njerëz, që besojnë në Allahun dhe në Ditën e Fundit, që të ushqejnë dashuri ndaj atyre, të cilët kundërshtojnë Allahun dhe të Dërguarin e tij, edhe në qofshin ata etërit e tyre ose bijtë e tyre, ose vëllezërit e tyre, ose farefisi i tyre. Allahu ka skali-tur besimin në zemrat e tyre dhe i ka fuqizuar ata me shpalljen e Vet. Ai do t'i shpjerë ata në kopshte, nëpër të cilat rrjedhin lumenj e ku do të qëndrojnë përgjithmonë. Allahu është i kënaqur me ata, por edhe ata do të jenë të kënaqur me Të. Ata janë Pala e Allahut dhe, vërtet që Pala e Allahut do të jetë fituese.”** (Muxhadile, 22)

**“O ju që keni besuar! Me të vërtetë, pijet alkoolike, bixhozi, idhujt dhe shigjetat e fallit janë vepra të ndyta nga punët e djallit. Prandaj, largohuni nga këto, me qëllim që të shpëtoni!”** (Maide, 90) **“O besimtarë! Bëhuni të durueshëm dhe nxiteni njëri-tjetrin të jeni të tillë; bëhuni të vendosur dhe vigjilentë (në vepra të mira dhe në ruajtjen e kufijve) dhe kijeni frikë Allahun, që të shpëtoni!”** (Al Imran, 200) **“Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndjejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse**



vetë janë nevojtarë. **Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.**” (Hashr, 9) **“Peshimi (i veprave), atë ditë do të jetë i drejtë. Ata që u rëndon peshorja me vepra të mira, do të jenë të shpëtuar.”** (A'raf, 8)

Ja, këto janë disa prej ajeteve që na njoftojnë për cilësitë dhe veprat e atyre që do të shpëtojnë. Ndërsa për ata që do të marrin shpërblimin e madh thuhet:

**“Me të vërtetë që për myslimanët dhe myslimanet, besimtarët dhe besimtare, të bindurit ndaj Allahut dhe të bindurat ndaj Allahut, të drejtët (të sinqertët) dhe të drejtat (të sinqertat), duruesit dhe durueset, të përlulurit dhe të përlulurat, mirëbërësit dhe mirëbërëset, agjëruesit dhe agjërueset, ruajtësit e nderit dhe ruajtëset e nderit, përkujtuesit e Allahut vazhdimisht dhe përkujtueset, pra, për të gjithë këta Allahu ka përgatitur falje dhe shpërblim të madh.”** (Ahzab, 35)

**“Por ata që pendohen, përmirësohen, mbështeten fort tek Allahu dhe që besimin e tyre e kanë singërisht vetëm për Allahun, do të jenë me besimtarët e vërtetë. Allahu do t'u japë shpërblim të madh besimtarëve.”** (Nisa, 146)

**“Muhamedi është i Dërguar i Allahut. Ata që janë me të, janë të ashpër ndaj jobesimtarëve e të mëshirshëm midis tyre. I sheh ata si përkulen dhe bien në sexhde, duke kërkuar dhuntinë dhe kënaqësinë e Allahut. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e sexhdes. Ky është përshkrimi i tyre në Teurat. Ndërsa në Ungjill, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filiza e forcohet e pastaj ngrihet e fortë me kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit. (Kështu përshkruhen ata) me qëllim që, nëpërmjet tyre, Ai t'i zemërojë mohuesit. Për ata midis tyre që besojnë dhe kryejnë vepra të mira, Allahu ka premtuar falje dhe shpërblim të madh.”** (Fet'h, 29)

**“Ja, këto janë urdhërimet që Allahu i ka zbritur për ju. Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t'ia shlyejë veprat e keqija dhe do t'ia rrisë shpërblimin.”** (Talak, 5) **“O ju që keni besuar, frikësojuni Allahut dhe thoni vetëm të vërtetën. Ai do t'ju bekojë veprat tuaja dhe do t'ju falë gjynahet. Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të arrijë një fitore madhështore.”** (Ahzab, 70-71)

Ata që janë përmendur deri këtu ndoshta do të ishin me vend t'i përmbledhim me këto dy ajete fisnike: **“Kush është ai, që do t'i japë vullnetarisht Allahut një hua të mirë, që Ai pastaj t'ia kthejë shumëfish?! (Veç kësaj), për atë do të ketë shpërblim fisnik, ditën që do të shohësh besimtarët dhe besimtare, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e**

**do t'u thuhet): “Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!”** (Hadid, 12)

Kur i Dërguari i Allahut (a.s.), e tregon me një shembull arratisjen e pavetëdijshme të umetit të tij për të shpëtuar, i krahason njerëzit e umetit me fluturat e natës që garojnë me njëra-tjetrën për të hyrë në zjarr. Kur Muadh ibn Xhebeli (r.a.), e pyeti të Dërguarin e Allahut (a.s.), që ta njoftonte për punët që të fusin në Xhenet dhe ato që të largojnë nga Xhehenemi, Hz. Pejgamberi i tha atij: **“O Muadh! Po kërkon diçka shumë të madhe.”** Pastaj i tha kështu: **“Vetëm se kjo është shumë e lehtë për atë që ia lehtëson Allahu. Prandaj, adhuroje Allahun pa i shoqëruar asnjë ortak, fale namazin siç duhet, jepe zekatin, mbaje agjërimin e muajit të Ramazanit dhe shko në haxh nëse do të kesh mundësi.**

Ndërsa tani, a të të njoftoj për dyert e mirësisë? Agjërimi është mbrojtje. Lëmosha e shuan ndëshkimin e mëkatit siç e shuan uji zjarrin. Edhe namazi që njeriu e fal natën, e fshin mëkatin.” Pasi i Dërguari i Allahut (a.s.), ia tha këto fjalë Muadh ibn Xhebelit (r.a.), këndoi këtë ajet fisnik: **“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne. Askush nuk di se çfarë gëzimesh janë fshehur për ata (në jetën tjetër), si shpërblim për punët e mira që kanë bërë.”** (Sexhde, 16-17)

Pastaj tha kështu për ta njoftuar për veprën më kryesore: **“Vepra / çështja më kryesore është Islami, shtylla e saj është namazi dhe pika kulmore e saj është xhihadi.”** Dhe së fundi, për t'i treguar Muadh ibn Xhebelit (r.a.), atë më të cilën janë të lidhura të gjitha këto, i tha: **“Mbroje gjuhën.”** (Tirmidhi, Iman, 8.)

Tashmë mund të themi: Cilësia e përbashkët e atyre që thamë këtu është fakti se të gjitha këto janë detyra të vështira dhe të rënda për nefsën. Pra, siç është durimi, mbajtja e gjuhës, bujaria, xhihadi dhe dhënia e pasurisë dhe e jetës duke e sakrifikuar për hir të Allahut të Madhëruar.

Këtu është e rëndësishme që të mos mashtrohem pas dëshirave e kënaqësive që i pëlqejnë dhe i duken të bukura nefsit. Pastaj veten / nefsën duhet ta ushtrojmë me adhurimet e urdhëruara dhe me obligimet financiare. Pastaj duhet të vazhdojmë me durim dhe vendosmëri që ta largojmë nefsën nga gjërat e ndaluara. Gjithashtu duhet t'i besojmë në mënyrë absolute shpërblimit të madh që është premtuar nga Allahu i Lartësuar dhe ta vazhdojmë këtë vendosmëri përgjatë gjithë jetës. Për këtë arsye, pyetja që sot duhet t'ia bëjmë vetes është kjo: **“Në çfarë gjendjeje është “vullneti për të kërkuar shpërblimin e madh”?**



## Ka një problem

# *në lutjet tona*

— M. Edip Beki —

Allahu i Lartësuar e ka krijuar njeriun dhe e ka dërguar atë në këtë botë për ta sprovuar. Jeta e kësaj bote nuk është një vend në të cilin çdo gjë shkon vaj. Në të vërtetë, jeta e kësaj bote nuk është krijuar për këtë. Për këtë arsye, jeta e kësaj bote ka baticat dhe zbaticat e saj. Pra, ka vështirësi, ka edhe lehtësime. Ka kohë kur përjetohet skamje, ka edhe kohë kur rritet mirëqenia. Këto janë periudhat e kësaj jete me të gjitha veçoritë e tyre: Fëmijëria, rinia dhe pleqëria.

Mbi të gjitha, njeriu është dërguar në këtë botë dhe nuk është lënë të veprojë sipas kokës së tij. Gjithashtu, ai nuk është lënë dhe nuk është harruar. Përkundrazi, prova është shumë e vështirë. Jeta e kësaj bote është një prej stacioneve më të rëndësishme të udhëtimit të ekzistencës, sepse ky stacion është caktuar si vendi i sprovimit që do ta bëjë të qartë pjesën e mëtejshme të udhëtimit. Këtu çështja më kryesore e njeriut është nëse ai do ta arrijë apo jo besimin e vërtetë. Vetëm se çështja nuk

mbaron me kaq. Pasi njeriu të besojë, ai sprovohet çdo moment me trupin, pasurinë, bashkëshorten, fëmijët dhe nefsin e tij. Gjithashtu sprovohet me çdo situatë që përballet. Njeriu sprovohet me pasuri dhe varfëri. Njeriu sprovohet me shëndet dhe sëmundje. Njeriu sprovohet me të mirë dhe me të keqe. Me këto sprova në të njëjtën kohë i matet besimi, durimi e vendosmëria kundrejt ngjarjeve dhe sjellja e tij kundrejt urdhrave e ndalesave të Allahut (xh.xh.).

Njeriu është një qenie me fuqi dhe pushtet të kufizuar. Gjithashtu ai është i paaftë, i dobët, i ngutshëm dhe nevojtar. Krahas të gjitha këtyre, dëshirat dhe imagjinatat e tij janë mjaft të gjera, por prapë se prapë është nevojtar në lidhje me çdo situatë me të cilën përballet. Ai asnjëherë nuk mund të jetë i mjaftueshëm për veten e tij. Gjithashtu është i privuar edhe nga mundësia për ta bërë trupin e tij që t'i bindet. Siç nuk mund të kontrollojë trupin e vet, nuk mund t'i kontrollojë



dot as ngjarjet që ndodhin përreth tij. Për këtë arsye, në çdo situatë ndjen nevojë për ndihmë. Ja pra, thirrjeve për ndihmë në lidhje me situatat që nuk mund t'i përballojmë i quajmë lutje.

Lutje do të thotë përgjërimit, thirrje, kërkim i ndihmës dhe të shprehurit e nevojës. Allahu Teala i jep rëndësi kësaj gjendjeje të njeriut dhe për shkak të kësaj gjendjeje i jep vlerë atij. Allahu i Madhëruar thotë: **“Lutmuni Mua, në mënyrë që t'i përgjigjem lutjes suaj.”** Në këtë mënyrë, i inkurajon robërit e Tij për t'iu lutur dhe për t'i kërkuar ndihmë duke e perceptuar dobësinë e tyre. Për këtë arsye, lutjen e ka caktuar si ibadet i çdo kohe dhe si një përgjërimit që vazhdimisht e vë në funksion lidhjen ndërmjet Tij dhe njeriut.

Në ibadetet e tjera ka një kohë të caktuar kur mund të kryhen ato. Namazi falet në kohë të caktuara dhe agjërimiti në muajin e Ramazanit etj. Ndërsa në kuptim të përgjithshëm, nuk është bërë ndonjë specifikim i kohës për lutjen. Njeriu mund të lutet në çdo kohë të ditës duke qenë i pavarur nga kushtet dhe mund t'ia parashtrijë gjendjen e tij Zotit (xh.xh), i Cili është poseduesi i botës së ekzistencës dhe i Cili ka çdo gjë në dorë. Kjo është një gjë e mrekullueshme për një rob. Nëse marrim parasysh të vërtetën se mosmarrja në konsideratë, mosdëgjimi dhe mosgjetja e mundësisë së mjaftueshme për ta shprehur veten është njëra prej pikëpamjeve më të rëndësishme që i shqetësojnë njerëzit, mund të kuptohet më qartë se sa lidhje e madhe shpirtërore është lutja ndërmjet njeriut dhe Zotit (xh.sh.). Krijuesi, i Cili nuk ka nevojë për asnjë gjë, i inkurajon robërit e Tij, të cilët kanë nevojë për çdo gjë, që t'iu lutin, t'iu drejtohen vetëm Atij dhe t'iu kërkojnë vetëm Atij: **“Lutmuni Mua, në mënyrë që t'i përgjigjem lutjes suaj.”**

Nga ana tjetër, për vazhdimësinë e kësaj lidhjeje të mrekullueshme dhe për t'iu bërë njerëzit që t'iu japin më shumë rëndësi disa kohëve, në literaturën islame flitet për disa kohë të caktuara në të cilat lutja pranohet dhe për njerëzit të cilëve u pranohet lutja. Nisur nga kjo, thuhet se lutja e babait për fëmijën e tij është e pranueshme. Lutja e të sëmurit dhe e mysafirrit është e pranueshme. Këto thënie profetike që sjellin një sistem social, nxjerrin në pah se lutja është një gjendje e cila duhet të përhapet në çdo fushë të jetës. Nisur nga kjo pikëpamje, lutja është një mirësi e madhe dhe një mundësi e vyer për ne, sepse ne jemi në një jetë, në të cilën çdo gjë gjithmonë nuk shkon siç

dëshirojmë, në të cilën ka prej atyre që kanë humbur të afërmit, ka prej atyre që janë sëmure, ka prej atyre që kanë formuar biznes të ri, ka prej atyre që kanë filluar shkollën, ka prej atyre që janë të suksesshëm dhe ka prej atyre që janë të pasuksesshëm. Një pjesë prej këtyre e dëshmojmë dhe një pjesë tjetër e përjetojmë vetë. Për këtë arsye, ne nxjerrim nga një këndvështrim në lidhje me çdo situatë që përjetojmë apo përballemi dhe këto këndvështrime i mbështesim me lutje. Këtë në shumicën e rasteve e bëjmë me nijet/qëllim të mirë. Ngaqë besojmë se lutjet që bëjmë do të pranohen, nganjëherë nxitojmë dhe presim që lutjet tona të plotësohen ashtu siç i kemi shprehur. Kur dëshirat dhe kërkesat tona të mos realizohen, së pari ndalemi pak dhe pastaj fillojmë ta pyesim veten se përse nuk pranohen lutjet tona e në mendje na vjen ajeti i Allahut të Madhëruar në të cilin thotë: **“Lutmuni Mua, në mënyrë që t'i përgjigjem lutjes suaj.”**

Ndërkohë që e shpjeguam konceptin e “lutjes”, ndërkohë që Kurani na inkurajon që të lutemi, që lutja duhet përhapur në çdo moment të jetës por veçanërisht në kohët e caktuara kur pranohet ajo dhe njerëzit prej të cilëve pranohet, do të thotë se këtu ka një problem serioz nëse themi: “Lutjet që bëjmë nuk pranohen. Allahu nuk i pranon lutjet tona.”

Nëse mendojmë rreth fjalëve që i përdorim me nijet të mirë apo me qëllim për t'iu lutur në jetën shoqërore, në të vërtetë mund të themi se ka një problem shumë të rëndësishëm. Po, kemi një problem mjaft serioz në këtë çështje. Ky është një problem jashtë formës dhe rregullave të lutjes. Ky është një problem gjuhe dhe metode. Ne nuk e kuptojmë atë që themi. Gjithashtu nuk themi gjëra që mund të kuptohen. Tjetër gjë mbartin fjalët që kemi në zemër dhe tjetër gjë mbartin fjalët që i shprehim. Synojmë gjëra të tjera dhe themi gjëra të tjera. Këto gjëra më së shumti janë prej atyre që kanë marrë formën e kallëpit/shabllonit. Ne mendojmë: “Le të themi atë që na vjen për goje. Sidoqoftë Allahu e di atë që është më e përshtatshme. Kështu që pranon atë që duhet.” Për këtë arsye, shumë shprehje i përdorim pa i menduar mirë dhe pa i kuptuar.

Për shembull, dikujt që e duam apo që na ka ndihmuar, i themi: “Allahu të dhëntë ç'të duash!” Ose: “Allahu të dhëntë ç'të dashtë zemra!” Ne mendojmë se ia kënaqim zemrën atij duke bërë një

lutje të tillë. Qëllimi ynë është që atij t'i plotësohen dëshirat dhe të përjetojë një lumturi siç e kemi përjetuar ne. Ndërkohë ne nuk kemi asnjë informacion në lidhje me të vërtetën se çfarë ka ai në zemër apo se është e mirë apo jo ajo që ai ka në zemër. Ndoshta ajo që i do zemra është diçka e palejueshme. Ndoshta ajo që ka në zemër nuk është e mirë për të. Nisur nga kjo, një lutje e sinkertë në këtë formë mund të mos jetë një lutje e mirë për atë.

Në të njëjtën mënyrë, interesante është edhe lutja në formën: "Allahu i pranoftë të gjitha lutjet!" Në të vërtetë, me këtë lutje dëshirojmë të themi: "O Zot! Unë e di se çfarë dua dhe këto i kërkoj prej Teje. Prandaj m'i prano lutjet dhe kërkesat e mia!" Ndërkohë ne nuk dimë asgjë në lidhje me çështjen se do të jenë apo jo për të mirën tonë kërkesat që i kemi parashtruar. Ne vetëm kërkojmë dhe përkush-tohemi te realizimi i kërkesave tona. Pastaj pandehim se do të bëhemi të lumtur nëse ato realizohen siç dëshirojmë. Por sa prej nesh mund të bëhen të lumtur prej realizimit të të gjitha dëshirave? Në të njëjtën mënyrë, si mund të jemi plotësisht të bindur se ato që kemi në zemër janë të mira për ne?

Në të njëjtin kontekst mund të vlerësohen edhe lutjet si: "Allahu të dhëntë jetë të gjatë! Allahu të dhëntë jetë të gjatë dhe të shëndetshme!" Këtu duket sikur ka një lutje me një jetë të mirë, por kuptimi që shprehin fjalët është komplet tjetër. Nëse jeta e gjatë do t'i japë njeriut mundësinë për ta përsosur veten e tij shpirtërisht, kjo është një jetë e mirë. Por nëse jeta e gjatë do t'ia shtojë mëkatet njeriut dhe do të jetë negative për të ardhmen e tij në Ahiret, edhe nëse është e shëndetshme si jetë, do të thotë se nuk është e mirë për atë njeri për të cilin jemi lutur. Për këtë arsye, kjo është diçka e padëshirueshme dhe diçka që nuk kërkohet prej nesh. Prandaj, asnjëherë nuk duhet të lutemi në këtë mënyrë.

Në këtë kontekst duhet të vlerësohen edhe fjalët që thuhën me një lutjeje si: "Allahu të bëftë siç të di! Allahu të dhëntë dhjetëfishin e asaj që mendon për mua!"

Për këtë arsye, në vend që të mendojmë për kuptimin e atyre që themi, mendojmë se përse nuk pranohen lutjet tona. Mospranimi i lutjeve që bëjmë vazhdimisht mund të na shpjerë deri në pikën e këputjes së besimit tonë, i cili është i lidhur me fije pambuku.

Në shprehjet e lutjes duhet të gjendet esenca e lutjes. Domethënë, në lutje duhet të shprehet dobësia, varfëria dhe pamundësia e robit. Krijuesit duhet t'i drejtohem me emrat e cilësitë e Tij dhe duhet ta madhërojmë Atë. Përgjatë lutjes duhet ta shprehim nevojën që kemi për ndihmën e Tij. Çfarëdo që të jetë ajo që do të kërkohet nga Allahu Teala, duhet të caktohet në mënyrë të qartë. Po ashtu, ai që i lutet Zotit (xh.sh.), për diçka, duhet t'i lutet patjetër që ajo të jetë e mirë për të në këtë botë dhe në botën tjetër. Prandaj, duhet të jemi të qartë për gjërat që kërkojmë nga i madhi Zot. Në Kuranin Fisnik ka shumë shembuj lutjesh që janë bërë nga gjuhët e pejgamberëve. Në të vërtetë, Allahu i Lartësuar me këto ajete i mëson robërit e Tij se si duhet të luten.

Përfundimisht, pasi t'i qartësojmë mendjet dhe fjalët tona, me një nënshtrim prej robi, duhet të strehohemi te madhështia e Krijuesit dhe t'i kërkojmë të na japë atë që është më e mirë për ne:

**"O Zoti im! Mbështetem tek Ti për Të të mos kërkuar gjëra, për të cilat nuk kam dijeni. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron, do të jem prej të humburve."** (Hud, 47)

**"O Zoti im! Më frymëzo që të jem mirënjohës për mirësitë që Ti më ke dhënë mua dhe prindërve të mi, dhe që të bëj vepra të mira, me të cilat Ti do të jesh i kënaqur. Më prano, me mëshirën Tënde, në gjirin e robërve të Tu të devotshëm!"** (Neml, 19)

### Lutje

*do të thotë përgjërimit,  
thirrje, kërkim i ndihmës dhe të  
shprehurit e nevojës. Allahu Teala i jep  
rëndësi kësaj gjendjeje të njeriut dhe  
për shkak të kësaj gjendjeje i jep vlerë  
atij. Allahu i Madhëruar  
thotë: "Lutmuni Mua,  
në mënyrë që t'i përgjigjem  
lutjes suaj."*





## Çfarë është TEVEKKULI?

Khunejd Bagdadi, rahmetullahi alejhi, thotë:

“Tevekkuli/mbështetja te Allahu nuk është as kesb, domethënë, fitim dhe as lënie e punës duke mos bërë asnjë gjë. Tevekkul do të thotë që një zemër, e cila i beson premtimit të Allahut Teala, të jetë e qetë, domethënë, të qëndrojë larg shqetësimit për riskun. Sipas një transmetimi, Ibn Abbasi (r.a.), ka thënë: “Jemenasit merrnin rrugën pa bërë asnjë përgatitje për udhëtim, duke pohuar se ishin “njerëz që i mbështeteshin Allahut Teala”. Pasi i merrte uria, kërkonin ndihmë nga njerëzit, madje edhe lypnin. Nisur nga kjo, Allahu i Madhëruar zbriti këtë ajet fisnik: “**...Pajisuni me gjërat që ju nevojiten për rrugë dhe dijeni se pajisja më e mirë është devotshmëria. Prandaj, kini frikë prej Meje, o njerëz të mençur!**” (Bekare, 197)

Një ditë herët në mëngjes, një i ri i shëndetshëm dhe i fuqishëm u nis për rrugë që të kryente disa punë. Kur sahabët e nderuar e panë atë, thanë: “Ah sikur ky i ri ta harxhojë rininë e tij në rrugë të Allahut!” Nisur nga kjo, i Dërguari i Allahut, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, u tha: “*Mos thoni ashtu! Nëse ai ka dalë për të shpëtuar nga lypja, është në rrugë të Allahut. Nëse ka dalë për të siguruar jetesën e prindërve të tij të moshuar apo për të ushqyer fëmijët e tij të vegjël, përsëri është në rrugë të Allahut. Por nëse përpiqet për t’u mburrur dhe shtirur, ja, atëherë është në rrugë të shejtanit.*” (Ihjaul-Ullum, 2; 163.)

Domethënë se çdo hap që hedh në rrugë për kërkimin e riskut një njeri që i fal namazet obligative dhe që i zbaton edhe urdhrat e tjerë të Allahut të Lartësuar, konsiderohet ibadet. Sigurisht se, siç bëhet e qartë edhe në hadithin fisnik, kjo ka të bëjë me nijetin që mbart zemra. Davudi, alejhi’s-salam, i cili ishte njëri prej shembujve më të shkëlqyer për ne në çështjen e sigurimit të jetesës me djersën e ballit, në të njëjtën kohë ishte edhe një sundimtar. Myslimani nuk ka nevojë të heqë dorë nga kjo botë për të përparuar në aspektin shpirtëror. Ndërkohë që nga njëra anë kryen detyrën e nënshtrimit ndaj Allahut Teala, nga ana tjetër përpiqet të shkruajë në defterin e sevapeve edhe punët që i përkasin kësaj bote. I Dërguari i Allahut (a.s.), i tha një personi që dëshironte të shkonte pranë një uji të ëmbël dhe të preokupohej me adhurim ndaj Zotit (xh.xh.):

“*Mos bëj ashtu, sepse puna në rrugë të Allahut është më e mirë se shtatëdhjetë vjet falje e namazit (nafle).*” (Musned, 2, 524.)

Lënia e punës dhe ngujimi në ndonjë qoshe, e bën njeriun nevojtar ndaj të tjerëve. Ndërsa Islami nuk e lejon një gjendje të tillë që e kërcënon dinjitetin e myslimanit. Feja jonë nuk dëshiron që myslimani të jetë i varfër dhe të lypë. Për këtë arsye, Islami, i cili i jep njeriut një personalitet të lartë, sigurisht që nuk e lejon këtë. I Dërguari i Allahut (a.s.), thotë:

“*Mbartja e druve në kurriz është më e mirë për ty se sa të shkosh për të lypur te dikush që Allahu i ka dhënë pasuri nga mirësia e Tij.*”

Sa shembuj të bukur që ka në jetën e sahabëve të nderuar! I Dërguari i Allahut (a.s.), i pati bërë vëllezër shpirtëror Sa’d ibn Rebi dhe Abdurrahman ibn Aufin (r.a.). Sa’d ibn Rebi i bëri këtë propozim Abdurrahman ibn Aufit: “Vëlla! Unë kam shumë pasuri. Gjysma e pasurisë sime le të jetë e jotja!” Abdurrahman ibn Aufi u gëzua shumë nga ky propozim, por iu përgjigj: “Vëlla! Pasuria jote qoftë e bekuar! Mua më trego rrugën e vendit ku bëhet allishverishi (tregtia)!”

Abdurrahman ibn Aufi (r.a.), u lut për pasurinë e vëllait të tij, Sa’d ibn Rebi (r.a.) dhe nuk pranoi që ta shfrytëzonte këtë mundësi dhe ta merrte gjysmën e pasurisë. Për këtë arsye, shkoi në treg me moralin dhe dinjitetin që ia dha Islami dhe preferoi të fitonte me djersën e ballit.

Tevekkul do të thotë t’i besosh dhe t’i mbështetesh krejtësisht Allahut Teala në çdo punë. Vendi i tevekkulit është zemra. Domethënë, tevekkuli është një gjendje shpirtërore. Marrja e masave në pamjen e jashtme nuk është pengesë për tevekkulin e zemrës. Përcaktimi është nga Allahu Teala. Nëse ndonjë gjë vështirësohet, përsëri është me caktimin e Atij. Ajo që u takon të gjithë robërve të bëjnë është që ta njohin vetëm Allahun si të adhuruar. Atij duhet t’i besojnë dhe t’i mbështeten në kuptimin e plotë të fjalës. Mbështetja dhe besimi ndaj pasurisë, prejardhjes, mendjes, pozitës dhe fëmijëve gjithmonë mund të mos japë rezultate premtuese, sepse edhe këta kanë nevojë për Allahun Teala, i Cili i ka krijuar dhe ka marrë përsipër riskun e tyre.



# Vetëdija për amanetin

Nihat Tyzyn

***“Ne ua ofruam përgjegjësinë qiejve, Tokës dhe maleve, por ato nuk pranuan ta marrin përsipër dhe u frikësuan ta pranojnë atë, kurse njeriu e pranoi. Me të vërtetë, njeriu u tregua i padrejtë me veten dhe i paditur (për pasojat e kësaj përgjegjësie).”*** (Ahzab, 72)

Allahu Teala e ka krijuar krijesën që quhet njeri në formën më të bukur, duke i fryrë atij nga shpirti i Vet. Pastaj atij i dha detyrën e mëkëmbësit në tokë. Të gjithë njerëzit, përveç profetëve dhe të devotshmëve, të sinqertëve, dëshmorëve dhe atyre që i ndjekin këta, të cilët janë lavdëruar në Kuranin Fisnik, nuk shpëtuan dot prej paralajmërimit të ajetit të mësipërm. Domethënë, u bënë mosmirënjohës duke mos e mbajtur fjalën që e dhanë.

Amaneti është çdo gjë materiale dhe shpirtërore e lënë te një njeri besnik për ta marrë përsëri. Amaneti është një përgjegjësi e madhe që nuk mund të ngelet i kufizuar vetëm me gjëra materiale. Shpirti është amanet, jeta është amanet, dija është amanet, fjala është amanet, detyra është amanet, autoriteti është amanet etj. Jo vetëm të afërmit tanë, por të gjithë njerëzit janë amanet për ne. Jo vetëm të gjithë njerëzit, por edhe kafshët janë amanet për ne. Madje, edhe toka në të cilën shkelim dhe çdo gjë që ajo na jep, është amanet për ne. Domethënë, janë lënë nën mbrojtjen tonë. Nisur nga ky këndvështrim, askush nuk ka të drejtë të veprojë me papërgjegjshmëri apo të shpërdorojë, sepse Allahu i Madhëruar do të kërkojë llogari nga të gjithë ata që kanë mendje dhe vullnet për të gjitha mirësitë që ka dhënë.

Askush nuk e ka luksin dhe të drejtën që t'i neglizhojë të tjerët. Askush nuk mund të thotë: “A nuk është jeta e imja? A nuk është pasuria e imja? A nuk është puna e imja? A nuk është fuqia e imja?” Në bazën e çdo vuajtjeje, duke filluar nga dhimbjet e te lotët e deri te shkatërrimi i marrëdhënieve njerëzore,

nga ndryshimet e klimës e deri te tragjeditë natyrore në çdo anë të kësaj bote, gjendet sëmundja e tradhtisë ndaj këtij amaneti.

Një njeri që është i vetëdijshëm për amanetin, në përgjithësi nuk bie në shkujdesje. Ai nuk ua shkel të drejtat të tjerëve dhe nuk i lejon të tjerët t'ia shkelin të drejtat e tij. Ai e njeh cakun dhe nuk e kalon atë. Asnjëherë nuk tregon një fjalë që i jepet sekret. Atij mund t'i bëhet padrejtësi, por ai vetë kurrë nuk e bën diçka të tillë. Një njeri i tillë nuk mund të sillet si i verbër dhe i shurdhër kundrejt mjedisit në të cilin jeton. Ai nuk ngacmon kënd, ngaqë e di se çdo heshtë e hedhur me papërgjegjshmëri, mund t'i kthehet si bumerang. Ai nuk dëmton vendin ku jeton... Nuk e pret degën në të cilën ka hipur.

Në ditët e sotme pasuria, për fat të keq, po qëndron në duar të caktuara, ngaqë pjesa që duhet t'u jepet nevojtarëve në veçanti dhe pjesa që duhet të harxhohet për shoqërinë në përgjithësi nuk shkon dot në vendin e saj. Dija e ka humbur vlerën e të qenit amanet, prandaj nuk po shndërrohet dot në urtësi, ngaqë konsiderohet si fuqi dhe mjet shfrytëzimi. Fuqia, ngaqë nuk përdoret më si amanet, po përhap padrejtësi në çdo vend. Së fundi, ndjejnë dhimbje si ata që shtypin, si ata që shtypen, sepse, në një botë ku sundon ambicia për të zotëruar çdo gjë, të gjithë do të jetojnë të shqetësuar.

Garancia për një botë të qetë dhe të sigurt gjendet vetëm te njerëzit e respektuar që e kanë arritur vetëdijen ndaj amanetit dhe shfaqin besnikëri ndaj fjalës që ia kanë dhënë Allahut Teala, sepse respekti është pranim i ekzistencës së të gjithëve. Prandaj, kjo derë ju shpie te dashuria. Kur ta shihni gjithësinë me dashuri, edhe ajo do t'ua shfaqë fshehtësitë e saj. Atëherë, as nuk do të lëndoni dhe as nuk do të lëndoheni.



# Unë jam një udhëtar i shkrete NË RRUGËN E JETËS

Mehmet Dinç

Unë udhëtoj shumë shpesh për shkaqe të ndryshme. Pothuajse një herë në çdo javë dal jashtë qytetit dhe në shumicën e rasteve udhëtoj më avion. Rruga është e gjatë, koha është e gjatë dhe shokët e rrugës janë të shumtë në numër e të ndryshëm në karakter. Pothuajse në kushte të njëjta, ndani të njëjtin vend me njerëz të moshave dhe karaktereve të ndryshme. Në këtë mënyrë, dashje apo pa dashje, njiheni me shumë njerëz. Si rezultat i vëzhgimeve që kam bërë përgjatë udhëtimeve dhe njohurive që kam marrë në lidhje me shokët e rrugës, kam vënë re se ka dy tipa udhëtarësh.

Tipi i udhëtarit të parë është udhëtari pesimist. Këta lloj udhëtarësh mbartin një tension të gatshëm dhe të paarsyeshëm, të gjithë i shikojnë pak me dyshim sikur duan të thonë: "Nga rashë këtu?" – dhe sillen sikur po presin të dalë ndonjë problem qoftë edhe nga gjëja më e vogël. Ata nuk flasin asgjë përveç ankesave për udhëtarët që kanë rreth e rrotull dhe dialogët që

të tjerët përpiqen të formojnë me ta i përfundojnë shpejt duke dhënë përgjigje të shkurtra dhe të ftohta. Prej mimikës që shfaqin gjatë shërbimit të ushqimit e bëjnë të qartë se nuk do të pëlqejnë asgjë gjatë rrugës. Për këtë arsye, marrin një lugë nga ushqimi ose nuk marrin fare dhe e kthejnë mbrapsht. Pastaj fillojnë të reagojnë në mënyrë që ta dëgjojnë edhe të tjerët, në lidhje me shijen, kripen, llojin apo dhënien e ushqimit. Ata i kontrollojnë shpejt të gjitha kanalet në ekranin që kanë përballë dhe e mbyllin pa pëlqyer asgjë. Pastaj përpiqen të flenë tërë nerva. Pas përpjekjeve të gjata, shfryjnë shumë dhe nuk flenë dot, ngrihen në këmbë dhe fillojnë të ecin lart e poshtë. Ata që flenë rehat apo ndjekin me gjithë qejf ndonjë prej kanaleve, i shohin me zemërim. Kur rrotat e avionit prekin tokën, menjëherë ngrihen në këmbë dhe përpiqen të marrin

valixhet e tyre. Pastaj presin pesëmbëdhjetë minuta me valixhe në duar dhe ua bëjnë zeher çdo sekondë atyre që kanë pranë. Ndërsa pas udhëtimit kanë nevojë të pushojnë të paktën dyfishin e kohës që udhëtojnë.

Tipi i udhëtarit të dytë është udhëtari i gëzueshëm. Këta lloj udhëtarësh çdo udhëtim të tyre e fillojnë me një emocion të sigurt se do të përballen me një lumturi të re dhe e fillojnë vetë të parët dëfrimin e udhëtimit me shikimet kureshtarë e fytyrat e qeshura të tyre. Në fillim të udhëtimit, i urojnë udhëtim të mbarë atyre që kanë pranë dhe bisedojnë me ta njerëzisht. Ose shikojnë poshtë sikur kanë parë gjënë më interesante të botës nga avioni që po fluturon dhe çdo herë mahnitën nga ato që shikojnë. Ndërkohë që vazhdojnë të fluturojnë, e hapin ekranin që kanë përpara dhe e ndjekin me kënaqësi deri në fund filmin që kanë zgjedhur. Pastaj fillojnë të flenë me ndonjë muzikë rehatuese që e gjejnë te kanalet e muzikës. Habia e ëmbël që kanë në fytyrat e tyre kur zgjohen për të ngrënë ushqimin, u japin përshtypjen sikur kanë fjetur në një shtrat mjaft të rehatshëm. Në vaktin e ushqimit patjetër gjejnë diçka që e pëlqejnë dhe e shijojnë. Edhe nëse njeriu është i ngopur, përsëri i vjen për të ngrënë kur i sheh ata se si i hanë ushqimet që kanë përpara. Pastaj, në çdo ndërrim avioni, sado e shkurtër që të jetë koha, zbresin nga avioni, shkojnë në aeroport dhe përpiqen për të zbuluar gjëra të reja. Për shkak të tipit që kanë, patjetër gjejnë diçka të re për të zbuluar. Fundin e rrugës e përjetojnë me kënaqësi dhe ndërsa avioni i afrohet aeroportit, marrin kënaqësi nga çdo sekondë. Pasi ta mbarojnë udhëtimin, ua tregojnë atyre që i presin ato që kanë përjetuar përgjatë udhëtimit sikur të mos ishin lodhur aspak.

Në të vërtetë, edhe kjo jetë është një udhëtim. Të gjithë ne jemi udhëtarë në këtë udhëtim. Ne e kemi në dorë që të bëhemi udhëtarë pesimist dhe ta shohim me sy negativ çdo gjë përgjatë udhëtimit duke ia bërë vetes dhe të tjerëve përreth zeher të gjithë udhëtimin. Gjithashtu, ne e kemi në dorë që të bëhemi udhëtarë të gëzueshëm, ta shijojmë çdo çast të udhëtimit dhe të gjejmë / përjetojmë shumë gjëra interesante që mund të tregohen në lidhje me udhëtimin tonë. Për këtë arsye, zgjedhja më e drejtë do të ishte kjo: Të shpëtojmë nga të gjitha sjelljet pesimiste duke e lënë pas çdo gjë që kemi përjetuar dhe ta kalojmë me gëzim e hare çdo moment këtej e tutje.

Udhëtim të mbarë!



# Jeto në rrugën që të tjerëve ua tregove për të drejtë

~ ~ ~ ~ ~  
Nuredin Nazarko  
~ ~ ~ ~ ~

Realiteti jetësor me anët e tij të dukshme apo përkohësisht të padukshme, është dëshmitari më kokëfortë dhe kokëmushkë, që nuk korruptohet apo kompromentohet, shantazhohet, presionohet për ta braktisur, deformuar apo ndryshuar, dëshminë mbi jetën e njeriut.

Koha, pakthyeshmërisht e pakthyeshme me rrjedhën e saj, është gjykatësi i drejtë dhe i paanshëm, i pakorruptueshëm nga fuqia e parasë apo pushtetit, i papërkulshëm para “madhështisë” së të fuqishmit, dhe dënglave të poterexhinjve, luksi i vetëm i të cilëve, pësja e vetme e të cilëve, janë dhe mbeten gjërat e shtrenjta dhe aksesorët e tyre.

Nuk e zgjedhim ne ardhjen këtu, por ne mund të zgjedhim si do të dalim nga këtu në përfundim të ardhjes, sepse atëherë është koha për të ikur. Mes ardhjes dhe ikjes, të jetosh, të mbetesh gjallë, është sfida themelore e vetë jetës. Nuk është e lehtë të jetosh, sepse të jetosh nuk do të thotë vetëm të thithësh ajër, të ushqehesh, të punosh, të pushosh. Në qoftë jeta kaq e lehtë, pse do të duhej të kalonim

mespërmes dilemash të vështira, për atë se çfarë do të duhet të bëjmë ose jo me jetën tonë?

Të jetosh sipas asaj që thua, shqetësimi më i madh, ankthi më i madh për njeriun përgjatë gjithë harkut kohor mes ardhjes dhe ikjes, vetëm nëse ikën para se vitet e tij të mbërrijnë aty ku fillon përgjegjësia, aty ku fillon ankthi.

Njeriu parapëlqen, në mos i duket dhe shumë argëtuese që gjithmonë të luajë rolin e personit që shqetësohet vazhdimisht mbi atë se çfarë thotë e vepron tjetri. Njeriut i duket shumë mikluese, kur beson dhe i është mbushur mendja top se fjalët e tij godasin e fshikullojnë të ligun dhe ligësitë, kur fjalët e tij rrahin si kamxhik një hapësirë prej 360° dhe kurrizi i shtrembër i disa syresh, duhet të drejtohet me patjetër. Nuk ka gjë më të thjeshtë, sesa të përdorësh fjalën për tu treguar miklues ndaj vetes dhe këshillues ndaj atyre që në emër të së mirës, i kamxhikon si të të vijë për mbarë dhe pastaj krejt çuditshëm, po krejt çuditshëm fare ama, beson se i ke dhënë tjetrit një këshillë fantastike, që edhe në



ëndërr po ta shihte këtë lloj këshille, me siguri do t'i kishte pëlqyer mjaftueshëm. Të flasësh, për t'i tërhequr veshin tjetrit, që të mos bëjë aksh gjëra, apo të bëjë aksh gjëra, në përputhje me parimet e epërme është mëse natyrore. Kur kjo e folur qëndron në antonimitet me atë çfarë vepron ai që flet, pamja që ofrohet është tmerruese. E ç'vlerë kanë fjalët e bukura (*që shpesh shëmtohen nga ai që flet*), oratoria, (*që të lemeris me mungesën e finesës dhe ëmbëlsisë që vjen nga zemra*), retorika (*shpesh për të mos thënë çdoherë, boshe, e skërmitur në gjithë perimetrin e saj, mbushur me thirrje kumbuese, por që nuk arrin as të skërfitë e jo më të depërtojë në zemrën e atij që dëgjon*) e një njeriu, që nuk përpiqet të jetojë sipas rrugës që të tjerëve ua ka treguar për të drejtë?

Ky ka qënë, është dhe mbetet, udhëkryqi themelor i dilemës më të madhe të njeriut, që kërkon të jetë kandil që u ndriçon rrugën të tjerëve. Por nuk ka njeri që të mos e mendojë veten si kandil për tjetrin, sepse është në natyrën e njeriut që të shfaqet si udhërrëfyes, me pretendimin se i njeh mirë shtigjet e jetës, ndërkohë nuk ka zbritur ende atje ku vlugu i jetës është gati të të thithë oksigjenin e jetës, që ti të mbijetosh. Pa zbritur në mes të këtij vlugu, e pa qëndruar faqebardhë në pikën e tij të vlimit nuk mund të jesh kandil ndriçues e udhërrëfyes, edhe pse aktualisht je bërë apo të kanë bërë të tillë, as për veten e lëre më për të tjerët.

T'i shpëtosh leqeve të lëvdatave të marrëzishme që të çojnë në lartësinë ku nuk mund të jesh, t'i shpëtosh lakut të grykësisë që të tërheq rrëshqanas e nuk ta lë shpirtin të ngjitet në sferat e larta të virtyteve, t'i ikësh si djalli temjanit, zjarrit të urrejtjes për motive krejtësisht vetanake e të dashurosh jetën, të këputësh zinxhirët e rehatisë së kolltukut ku je ulur dhe të ndihesh për një ditë i varfër, të kuptosh hallet e hallexhiut dhe jo të fërkoresh pas të molepsurve me zgjeben e kryeneçësisë dhe përçmimit për njerëzoren që fle brenda njeriut. Kjo është sfida që të torturon, kjo është sfida që nuk të lë të jetosh në paqe, edhe pse bën sikur, sepse ti pranove që të jetosh me virtytet dhe rrugës turjela e stomakut nuk të la rehat, derisa me barominën e egos e përgatite veten për të të vërshuar ndër deje, babëzia dhe makutëria për konsum, që asnjëherë nuk qëndron në raport të drejtë me punën që beson se kryen.

Dhe ja sot, ke mbërritur në një pikë ku nuk të nxihet më faqja si dikur, kur sheh se çfarë hendeku ke hapur rreth vetes, mes asaj që ke dashur t'i mësosh tjetrit dhe asaj që vepron vet. I gjendur mes këtij hendeku bosh që të rrethon nga të gjitha anët si kështjellë, në vend që të kuptosh boshllëkun ku ke zhytur njeriun që fle brenda teje, vazhdon të kacajelosesh si një princ që ruan veten nga ligësitë e botës, i izoluar në kështjellën e tij.

O ti që flet e flet dhe prapë flet. Mos e bëj veten

tënde t'i besojë egos tënde, mos e bëj veten tënde, t'i besojë miklimeve të egos tënde, sepse sado shumë ithtarë të kesh rrotull vetes, sërish i braktisur e i nënçmuar do të jesh, peng dhe skllav i llagëmeve të errëta të egos do të përfundosh. Ndoshta miklimet e sotme, të egos dhe të atyre që të bëjnë fresk me temenarat e pashpirtshme, e mbushin hapësirën tënde ekzistenciale dhe nuk të lejojnë të shohësh boshllëkun ku e ke groposur qenien njerëzore brenda teje. Çaje këtë perde me tehun e mprehtë të sinqeritetit dhe kupto se sa thellë je zhytur në bodrumin e lëvdatave pa lavdi, e temenarave pa fisnikëri. Braktisi xhingla-minglat dhe mos gjej një mijë e një justifikime për konsumin e tyre. Zbrit nga fronti i delirit, ku të kanë çuar ata që të ndjekin me pashpirtshmërinë e tyre dhe rehatohu mbi shilten e qetësisë, bërë nga thjeshtësia dhe mbushur me sinqeritet dhe avitu sërish drejt miqve të tu të vërtetë.

Në qoftë se mbërrite deri këtu, atëherë mos përto e lexoje edhe pjesën më poshtë, edhe pse ndoshta nuk do të të thotë shumë gjëra.

Atëherë Zarathustra u kthye në mal në vetminë e shpellës së tij, dhe iu shmang njerëzve; ai priste si mbjellësi që e ka mbjellë farën. Por shpirti iu mbush me padurim dhe me pasion për ata që donte, sepse akoma kishte shumë për t'iu dhuruar. Pikërisht kjo është gjëja më e vështirë; që nga dashuria, të mbyllësh dorën e hapur, dhe megjithëse jep, të ruash dinjitetin.

Kështu i kaluan vetmitarit muaj dhe vite; dituria i shtohet dhe bollëku i saj i shkaktonte dhimbje.

Ama, një mëngjes pa dalë dielli e pasi mendoi gjatë, i shtrirë mbi trojet e tij, së fundi i tha zemrës:

“Pse u tremba në gjumë aq sa u zgjova? A nuk më afrohej një djalë që mbante një pasqyrë?”

“O Zarathustra” -më thoshte fëmija- “shihu në pasqyrë!” Po kur pashë veten në pasqyrë lëshova një britmë dhe zemra sa s'më pushoi, se nuk pashë aty më veten, por balluken dhe ngërdheshjen e një demoni.

Vërtet, me të vërtetë e kuptoj mirë shenjën dhe paralajmërimin e ëndrrës; doktrina ime është në rrezik, grami dëshiron të quhet grurë.

Armiqtë e mi janë bërë të fuqishëm, kanë deformuar pamjen e doktrinës sime, deri në atë masë sa të dashurit e mi turpërohen nga dhuratat që iu dhashë.

Kot shkuan miqtë e mi; erdhi ora pra, ora për të kërkuar miqtë e mi të humbur!

Me këto fjalë, Zarathustra brofi në këmbë, dhe jo si një i asfiksuar që kërkon ajër, por si profet e poet që pushtohet nga shpirti.<sup>1</sup>

1. Nietzsche, F. (2001), *Kështu foli Zarathustra*, Tiranë: Phoenix, f. 75.

Përshëndetje

Hola

Bonjour

こんにちは

Ai është Krijuesi i qiejve dhe i Tokës, pa shembull të mëparshëm dhe, kur vendos për diçka, vetëm thotë për të: “Bëhu!” - dhe ajo bëhet. (Bekare, 117)

# Gjuha si dhuratë hyjnore

Dr. Erzen Koperaj

Elementi më thelbësor që dallon racën njerëzore prej gjallesave të tjera është gjuha dhe komunikimi që realizohet përmes saj. Padyshim, sot shkencë njej edhe gjallesa të tjera që arrijnë të komunikojnë përmes tingujve (p.sh. arinjtë, delfinët dhe bletët), por ky komunikim është shumë i kufizuar dhe i përqendruar në tre-katër kuptime bazë. Në të kundërt, gjuha njerëzore është krijuese, përmes tingujve arrin të ndërtojë fjalë e fjali, të shprehë kuptime dhe ndjenja, e bazuar mbi rregulla (gramatikore), secili individ është përdoruesi dhe krijuesi i saj (ndryshe nga kafshët e mësipërme që kanë të njëjtin artikulum dhe kuptim të përcaktuar gjenetikisht), duke bërë të mundur që përvojën e tij ta transmetojë jo vetëm në shoqërinë që jeton, por edhe në brezat pasardhës; është unike, sepse arrin të shprehë ide e nocione abstrakte, cilësi, pra e pashoqe në çdo lloj komunikimi të të gjitha gjallesave.

Një aftësi e tillë (gjuha dhe të folurit), pa të cilën shoqëria njerëzore nuk do të kishte kuptim, ka tërhequr gjithnjë vëmendjen për origjinën e saj. Që prej antikitetit të hershëm dhe deri më sot dijetarët janë përpjekur të gjejnë një shpjegim sesi soji njerëzor arriti të kishte një dhunti të tillë. U duk se me teorinë e evolucionit të specieve të Ç. Darwin, edhe gjuha gjeti shpjegimin e origjinës së saj. “Unë nuk dyshoj aspak se origjina e gjuhës njerëzore është e lidhur me imitimin dhe modifikimin e tingujve të ndryshëm të zogjve dhe kafshëve tjera duke i shtuar këtu edhe klithmat e veta instiktive të njeriut, ndihmuar shpeshherë edhe me shenja e gjestet” - ishte shpjegimi i shkencëtarit të njohur britanik më 1871 (*The Descent of Man*), përkufizim që u mor si i mirëqenë për afro një shekull. Në kuptimin evolutiv, gjuha ishte zhvilluar si aftësi të tjera të njeriut (si p.sh. përdorimi shumë funksional i dorës), përmes seleksionimit natyror që ka vepruar mbi speciet e gjalla prej qindra mijëra vjetësh.

Por në gjysmën e shekullit XX, një teori e tillë filloi të lëkundej fort, aq sa shkencë e sotme e sheh si një prej varianteve më pak të besueshme. Madje, filozofi dhe gjuhëtari më i njohur i gjysmës së dytë të shek.

XX, Noam Çomski (*The Architecture of Language*, Oxford University Press, 2000), e sheh gjuhën dhe aftësinë e të folurit të njeriut si një dukuri të pazakontë, “..ka ndodhur një prej mutacioneve më të papritura, ndoshta pas një vërshimi rrezesh kozmike kanë riorganizuar trurin tonë dhe kanë ngulitur në të qendrat e të folurit, ndryshe nga ai i pari”. Ndoshta, për të mos lënë që të keqkuptohej, që këtë fjalë të mos ia merrnin fjalë për fjalë, ai shton se kjo mund të jetë shumë më pranë realitetit sesa me përrallat që rrëfejnë për zhvillimin sipas teorisë së evolucionit, duke përfshirë këtu edhe gjuhën. Pas studimeve të shumta u pa që gjuha është “një aftësi” që njeriu nuk ia paska arritur ta fitojë si rezultat i kontakteve me tingujt dhe klithmat, as si rezultat i jetesës në grup, por se njeriu lindka me një aftësi të tillë, me një “gramatikë universale”, që më pas njerëzit e zhvillojnë sipas rrethanave sociale në të cilat jetojnë, dhe gjuhëve të tyre amtare. Por sipas disa studiuesve të tjerë, gjuha dhe të folurit, aftësia e njeriut për të folur vjen ngaqë njeriu nuk është gjallesa që jeton në kope, por në shoqëri me organizim ritual dhe simbolik. Si pjesë e zhvillimit të kulturës simbolike që ka njerëzimi u zhvillua edhe gjuha (T.W. Deacon, *The symbolic species: the co-evolution of language and the brain*. New York, 1997). Fjalët ashtu si shenjat e shkruara, apo dhe gjestet janë simbole veprimesh dhe konceptesh, mendojnë këta të fundit.

Siç shihet, në ditët e sotme, kur studimet gjuhësore, antropologjike, biologjike janë shtuar dhe thelluar shumë, vështirë të gjendet një çështje tjetër që të ketë kaq shumë mendime dhe hipoteza të ndryshme. Përpjekjet për të gjetur shpjegimin e zanafillës së të folurit të njeriut, brenda caqeve të zhvillimit biologjik të specieve, apo në mënyrë rastësore, si shkak i disa rrethanave të caktuara të endjes së njeriut primitiv, gjithnjë kanë dështuar për të qenë bindëse. Kështu që shpjegimi i origjinës së gjuhës quhet si problemi më i vështirë shkencor për t’u zgjidhur (Morten H. Christiansen and Simon Kirby, *Language evolution: the hardest problem in science?* Oxford University Press. 2003).



Hallo

привет

مرحبا

Hallå

Por ajo çfarë vjen befasuese, është se për problemin më të vështirë të shkencës mund të gesh një përgjigje në Kuran. Përmes verseteve kuranore mund të ndërtohet dhe shpjegosh evolucionin gjuhësor duke ecur në përputhje me qëndrimet që rreshtuam më sipër, madje duke i bashkuar ato, dhe duke mos pasur kundërthënie me rezultatet e sotme të gjuhësisë, antropologjisë dhe neurotikës

Gjithnjë e më shumë, që nga sosyrianët e deri tek gjenerativistët e kanë parë gjuhën si një dhunti, si një dhuratë që e ka vetëm njeriu. Si mund të shpjegohet ndryshe aftësia e njeriut për të folur, përveçse si qenia më e përzgjedhur, në ndryshim me gjallesat e tjera, siç shprehet në Kuran: *-Në të vërtetë, Ne krijuam njeriun në trajtën më të përkryer.* (Tin, 4); *-ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.* (Alak, 5)

A mund të jetë gjuha një dhuratë hyjnore që njeriu e ka vetëm prej Krijuesit të tij?

- *Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti engjëjve.* (Kuran, 2.Bekare, 31); - *"O Adem, -tha Ai- ua trego atyre emrat e gjërave!" Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: "A nuk ju kam thënë se vetëm Unë i di fshehtësitë e qiellit dhe Tokës.* (Bekare, 33); *-Ademi mësoi disa fjalë nga Zoti i tij, kështu që ai ia pranoi pendimin.* (Bekare, 37)

Përmes këtyre ajeteve, mund të shpjegohet dhe të qendrojë edhe teoria e natyrës rituale dhe simbolike të shoqërisë njerëzore, produkt i së cilës është dhe gjuha. Zoti i mësoi njeriut emrat, në një mënyrë, edhe simbolet. Madje i jepet përgjigje gjithashtu tezës për kulturën simbolike rituale të cilën ka që në gjenezë shoqëria njerëzore prej nga u zhvillua gjuha dhe më pas shkrimi:

- *Lexo se Zoti yt është më bujari! Ai që mësoi njeriun të shkruaj.* (Alak, 3,4).

(A nuk është e çuditshme sesi të gjitha shoqëritë njerëzore kanë pasur elemente të shkrimit, nga piktogramet e deri tek shkrimi i fjalëve, edhe tek ato më "primitivët"?). Pra, Krijuesi i njeriut i dha atij aftësinë e njohjes, dijes dhe fjalës. A nuk është vetë fjala një element i Krijuesit:

- *Ai vetëm thotë për të: "Bëhu!"- dhe ajo bëhet.* (Al Imran, 47).

Zhvillimi i gjuhës, ashtu si natyra e shenjës, është arbitrar, thotë Sosyri, ai nuk i nënshtrohet vullnetit të individit, madje ndryshimi është i paperceptueshëm, pasi gjuha është gjithmonë në ekuilibër. Pra, një gjuhë jeton, zhvillohet e ndryshon dhe nuk është një krijim artificial i një grupi njerëzish. Madje për gjuhë të krijuara (në mënyrë artificiale) si *esperantoja*, rezultojnë që

krijojnë probleme të mëdha për të qenë gjuhë amëtare (gjuhë e parë që mëson një fëmijë). Megjithëse esperanto është një imitim i gjuhëve latine, me një gramatikë të thjeshtuar, dhe me fjalë të marra nga gjuhët tjera (pra, në fund të fundit, më shumë një imitim sesa një krijim i veçantë), fëmijët tek të cilët prindërit kanë dashur t'i mësojnë esperanton si gjuhë amtare kanë ndeshur probleme të mëdha në komunikim gjatë rritjes së tyre (*The phenomenon of overregularization in Esperanto-speaking children*, Renato Corsetti, Maria Antonietta Pinto and Maria Tolomeo, Università di Roma La Sapienza, 2012). Prandaj, duke qenë një gjuhë artificiale, ajo nuk i ka ato aftësi që i ka gjuha amtare për të shprehur të gjitha ndjenjat e holla të shpirtit të njeriut. Pra, asaj pothuaj i mungon aftësia dhe pasuria i ka gjuha "biologjike". Mungesa e këtyre vetive bëjnë që ajo të mbetet dhe, siç duket ka mbetur, vetëm një eksperiment, pa arritur të konkurojë gjuhët e Krijuesit, të cilat, mesa duket kanë edhe detyrën tjetër, të përcjellin si duhet mesazhin e Tij.

- *Ne nuk kemi çuar asnjë të dërguar, përveçse në gjuhën e popullit të tij, për t'u shpjeguar atyre (shpalljet e Zotit). Allahu e shpie në humbje kë të dojë dhe e udhëzon në rrugë të drejtë kë të dojë. Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.* (Ibrahim, 4)

Dhe në vazhden e këtij hulumtimi të zhvillimit të gjuhëve, në Kuran edhe gjen shpjegimin përsa i përket dallimit, ndarjes së gjuhëve, gjë që shpjegohet si një vullnet hyjnor. Por jo si një mallkim (Kulla e Babelit), por si një pasuri (a nuk i ka shpallur OKB, gjuhët si pasuria më e madhe kulturore e njerëzimit), duke bërë që çdo gjuhë të jetë me po aq vlerë sa çdo gjuhë tjetër:

- *Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave(racave) tuaja. Padyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.* (Rum, 22)

Këtu do të shtoja mendimin e një imami të ditur dhe të njohur të shek.IX-X, Ibn Hamzi (R. Arnaldez, *Grammaire et theologie chez Ibn Hamz de Cordue*, Paris, 1981), që thotë se gjuhët e shumta jo vetëm që shprehin madhështinë e Krijuesit, por edhe kufizimin e njeriut. Secila gjuhë, që flitet dhe është folur, është pjesë e mozaikut të madh që përbën gjuhën hyjnore, "ato janë lulet e mrekullueshme, të larmishme, në lulishten e madhe". Prandaj në secilën gjuhë, njerëzit mund të gjejnë shpirtin, profumin dhe gjurmët e gjuhës hyjnore.

Pas këtyre, verseteve kuranore që lidhen me origjinën e gjuhës, përveçse mbetesh i pajalë, s' të mbetet veçse të kujtosh thënien e dijetarëve muslimanë të shek. VII-XI, se shkencën pa besimin është si anija pa busull në det.



# Thoni Inshallah

Adem Saraç

Politeistët mekas, të cilët nuk kishin aq fat sa t'ia vinin veshin mesazhit universal të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), bënëin çfarëdo që kishin mundësi për ta bërë atë të heshtte apo për ta lënduar.

Njëra prej këtyre iniciativave të shëmtuara ishin tri pyetjet që i bënë të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam, përpara gjithë njerëzve duke u mbështetur te mendimi që kishin marrë nga çifutët:

1. Cila është e vërteta e aventurave të të rinjve që patën ardhur në kohët e hershme? Ata të rinj kanë përjetuar ngjarje shumë të habitshme!

2. Na njofto për atë që e ka shëtitur tokën nga lindja deri në perëndim!

3. Çfarë është shpirti? Si është ai?

Pejgamberi, alejhi's-selam, u tha pa hezituat aspak:

*"Përgjigjet e pyetjeve që më drejtuat, do t'ju jap nesër!"*<sup>1</sup>

Asnjëri nuk pyeti:

"Përse nesër dhe jo tani?" Të gjithë ishin të fokusuar te dita e nesërme sikur ishin të sigurt se kjo punë do të merrte fund nesër...

Por edhe pse kaluan pesëmbëdhjetë ditë nga kjo ngjarje, në lidhje me këtë çështje akoma nuk kishte ardhur ndonjë shpallje. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ngeli në një situatë shumë të vështirë. Madje, edhe engjëlli i shpalljes, Xhebraili, alejhi's-selam, i cili vinte pothuajse çdo ditë, madje nganjëherë disa herë në ditë, nuk shihej gjëkund.

Pasi u formua mjedisi i fitnes / përçarjes, që mushrikët e donin më shumë se përgjigjet e pyetjeve, organizuan argëtime për shkak të gëzimit të madh që ndjenin dhe bënë festë. Sipas mendjes së tyre, ata tashmë ishin fituesit, ndërsa i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ishte mposhtur. Ata e ngritën në këmbë të gjithë Mekën sikur të kishin korrur ndonjë fitore madhështore. Sikur edhe kjo të mos mjaftonte, thashethemet e tyre ishin shumë lënduese. Ato ishin aq lënduese, sa që disa sahabëve po u sosej durimi. Vendi ishte tensionuar jashtë mase dhe çdo moment mund të ndodhte çdo gjë. Politeistët thoshin:

"Ky burrë, i cili thotë se është i Dërguari i Allahut, nuk e mbajti fjalën e dhënë. Edhe pse tha: "Nesër do t'ju jap përgjigje." – akoma nuk ka dhënë ndonjë përgjigje, edhe pse kanë kaluar pesëmbëdhjetë ditë. Ç'është kjo gjë kështu? Nga njëra anë thotë se është i Dërguari i Allahut, nga ana tjetër nuk u jep dot përgjigje pyetjeve tona. Me sa kuptohet, Zoti i

1. Ibn Sejjidu'n-Nas, Ujunu'l-Eser fi Fununi'l-Megazi ve's-Sijer, vëll. 1, fq. 108-19.



tij e ka lënë atë, ose ai gënjen kur thotë se është i Dërguari i Allahut. Nëse është i Dërguari i Allahut, atëherë, le t'i japë përgjigje pyetjeve tona! Nëse nuk është, le ta marrin vesh të gjithë të vërtetën e kësaj çështjeje!<sup>2</sup>

Fjalët e rënda që i thanë politeistët e Mekës e mërzitën shumë të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam. Atij i erdhi shumë rëndë si çdo njeriu që shtypet nga barra e rëndë e thashethemeve. Sa herë që dilte në rrugë për shkak të ndonjë pune apo të misionit që kishte, përballej me talljet e të gjithë mushrikëve, madje edhe të grave dhe të fëmijëve të tyre:

-Ti sikur ishe i Dërguari i Allahut!

Përse nuk e mbajte fjalën edhe pse the: "Nesër do t'u jap përgjigje."

-Apo nuk je i Dërguari i Allahut?

-Mos vallë Allahu të ka braktisur?

Çfarë nuk thoshin! Thashethemet, ofendimet, talljet dhe përçmimet ishin të padurueshme. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, nga njëra anë i duronte këto gjëra të padurueshme dhe nga ana tjetër përpiqej të qetësonte sahabët e tij. Por shqetësimet e politeistëve bëheshin vazhdimisht edhe më të padurueshme.

Ndërkohë që vendi ishte i tensionuar seriozisht me çdo gjë, zbriti ndihma e Allahut dhe më së fundi i erdhi shpallja Resulullahut, alejhi's-selam. Sapo erdhi shpallja, i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, i njoftoi politeistët.

Politeistët, të cilët bënë aleancë me çifutët për ta mposhtur të Dërguarin e Allahut, alejhi's-selam, pas britmave dhe klithmave të fitores që zgjatën për pesëmbëdhjetë ditë me radhë, befasisht ranë në një zbrazëti të frikshme. Ata e dinin se do të merrnin fund një herë e përgjithmonë nëse Hz. Pejgamberi do t'u jepte përgjigje pyetjeve të tyre. Por ja që, me guxim që ua jepte injoranca, përsëri e mblodhën të gjithë popullin në oborrin e Qabesë së Shenjtë.

I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, shkoi në Qabe duke marrë me vete një pjesë prej sahabëve të tij. I gjithë vendi ishte i mbushur plot me politeistë. Për shkak se kishin kaluar pesëmbëdhjetë ditë, njëri prej liderëve të politeistëve doli dhe i përsëriti pyetjet në mënyrë që t'ua rikujtonte njerëzve:

-Kanë kaluar pesëmbëdhjetë ditë nga koha kur ia kemi bërë pyetjet. Unë tani secilën prej pyetjeve do ta parashtoj përsëri. Ndërsa ai do të na japë përgjigje një e nga një. Pyetja jonë e parë ishte kjo:

"Cila është e vërteta e aventurave të të rinjve që patën ardhur në kohët e hershme? Ata të rinj kanë përjetuar ngjarje shumë të habitshme!"

Kur i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, doli në një vend të lartë për të folur, të gjithë u kthyen plotësisht nga ai. Askush nuk nxirrte edhe zërin më të vogël:

"Pyetja juaj e parë ka të bëjë me As'habu'l-Kehf / Banorët e Shpellës, domethënë, me djemtë e rinj që fjetën në shpellë<sup>3</sup>. Aventurat dhe ngjarjet e habitshme që përjetuan ata janë kështu. I Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, filloi t'u lexonte suren Kehf njerëzve të cilët po e dëgjonin me shumë kujdes dhe vëmendje:

**"Çdo lavd dhe falënderim i përket Allahut, i Cili i shpalli robit të Vet (Muhamedit) një Libër të dëlirë nga çdo shtrembërim, (një libër) të drejtë, për të paralajmëruar nëpërmjet tij, dënim të ashpër (për jobsimtarët) dhe për t'u dhënë lajmin e mirë besimtarëve, të cilët bëjnë vepra të mira, se për ta do të ketë një shpërblim të bukur (Xheneti), në të cilin do të qëndrojnë përherë, si dhe për të paralajmëruar ata që thonë: "Allahu ka një bir". Ata nuk kanë kurrfarë dijenie për këtë, as etërit e tyre. Sa fjalë e rëndë është ajo që del nga goja e tyre! Ata flasin vetëm gënjeshtër. A mos vallë do të vrasësh veten nga pikëllimi, nëse ata nuk besojnë në këtë Fjalë (Kuran)? Çdo gjë që gjendet në Tokë, Ne e kemi bërë stoli për të, për të provuar se kush prej tyre punon më mirë. Dhe, Ne do ta bëjmë të shkretë gjithçka, që gjendet në të. Vallë, a mendon ti se banorët e Shpellës dhe Rakimit<sup>4</sup> ishin një çudi nga mrekullitë Tona? Kur disa djelmosha u strehuan në shpellë dhe thanë: "O Zoti ynë, na jep mëshirë nga ana Jote dhe përgatitna për sjellje të drejtë!" Ne ua mbyllëm veshët atyre (duke i lënë të flinin) në shpellë për shumë vjet. Pastaj i ngritëm, për të marrë vesh se cili nga të dyja grupet do ta vlerësonte më mirë sa kohë kishin qenë të strehuar. Ne po ta tregojmë ty historinë e tyre sipas së vërtetës. Ata ishin djelmosha që besonin në Zotin e tyre dhe Ne i forcua në rrugën e drejtë. Ne i forcua zemrat e tyre, kur u ngritën e thanë: "Zoti ynë është**

3. Banorët e Shpellës ishin disa të rinj monoteistë, të arratisur nga qyteti i tyre, për t'i shpëtuar persekutimit të një tirani pagan, që donte t'i detyronte të hiqnin dorë nga besimi i tyre. Për të ruajtur pastërtinë e këtij besimi, ata u strehuan në një shpellë jashtë qytetit dhe u dorëzuan mëshirës hyjnore. Allahu i Madhëruar i bëri të flenë për treqind vjet dhe i zgjoi, kur gjendja në qytet kishte ndryshuar: banorët e tij ishin bërë monoteistë dhe qyteti qeverisej nga një mbret i urtë e i devotshëm. Ringjalljen e tyre Allahu e bëri mrekulli për banorët e qytetit (dhe për tërë njerëzimin) që vërtetonte ringjalljen e plotë, ngaqë ata ishin ndarë në dy grupe: njëri grup thoshte se ishte veç shpirti ai që ringjallej, kurse grupi tjetër thoshte se ringjallej edhe trupi.

4. Rakim mund të jetë emri i një lumi që kalonte pranë Shpellës ose një tabelë në hyrje të Shpellës me emrat e banorëve të saj, ose emri i qenit të tyre.

2. Ali Muhammed Sal-labi, Islam Tarihi Asr-i Saâdet Dönemi, vëll. 1, fq. 293.

Zoti i qiejve dhe i Tokës. Ne nuk do t'i lutemi asnjë zoti tjetër, përveç Tij, sepse atëherë do të thoshim një gënjeshtër të madhe. Ky populli ynë ka zgjedhur në vend të Tij zota të tjerë, ndonëse ata nuk u sjellin dot asnjë provë të qartë. E kush është keqbërës më i madh, se ai që trillon gënjeshtër për Allahun? Kur ju t'i lini ata dhe gjithçka që adhurojnë në vend të Allahut, gjeni strehë në shpellë: Zoti juaj do t'ju mbulojë me mëshirën e Tij dhe do t'ju përgatisë mënyrën nga e cila do të keni dobi". Ti (o Muhamed) do ta kishe parë Diellin kur lindte, se si anohej nga e djathta e shpellës së tyre dhe, kur perëndonte, ata i linte në anën e majtë, ndërkohë që ata gjendeshin në mesin e saj. Kjo është nga shenjat e Allahut. Sa për atë, që Allahu e udhëzon në rrugë të drejtë, pikërisht ai është i udhëzuari. E sa për atë, që Ai e lë në humbje, ti, me siguri, nuk do të mund t'i gjesh mbrojtës që ta udhëzojë. Dhe (po të kishe qenë atje), do të mendoje se ata ishin zgjuar, por ata ishin në gjumë. Ne i rrotullonim ata herë në krah të djathtë e herë në të majtë, kurse qeni i tyre rrinte shtrirë me dy këmbët e para në hyrje të shpellës. Sikur t'i kishe parë, ti do të ikje nga ata dhe do të të kaplonte frika. Kështu pra, Ne i zgjuam që të pyesnin njëri-tjetrin. Njëri nga ata tha: "Sa keni ndenjur (në gjumë?)" - U përgjigjën: "Kemi qëndruar një ditë a një pjesë të ditës". Disa thanë: "Zoti juaj e di më mirë se sa keni ndenjur. Dërgoni njërin prej jush në qytet me këtë monedhë argjendi tuajën e le të shikojë se cili ushqim është më i pastër. Le t'ju sjellë diçka prej tij, le të silltet mirë dhe askush të mos marrë vesh për ju. Me të vërtetë, nëse ju zbulojnë, ata do t'ju gjuajnë me gurë ose do t'ju kthejnë (me forcë) në fenë e tyre dhe atëherë nuk do të shpëtoni kursesi"! Dhe kështu, Ne bëmë që ata të zbuloheshin, me qëllim që të dihej se premtimi i Allahut është i vërtetë dhe, që të mos ketë asnjë dyshim për Orën (e Kiametit, se ajo do të vijë). Kur ata (banorët e qytetit) po haheshin me njëri-tjetrin për këtë rast, disa thoshin: "Ndërtojeni atyre (në hyrje të shpellës) një ndërtesë! Zoti i tyre i njuh më mirë ata". Ata që e fituan çështjen e tyre, thanë: "Ne do të ndërtojmë një faltore mbi ta!" Do të thonë: "Ata ishin tre veta e qeni i tyre ishte i katërti". Disa do të thonë: "Ata ishin pesë veta e qeni i tyre ishte i gjashti", duke hamendësuar për atë që është e fshehtë; kurse të tjerë do të thonë: "Ata ishin shtatë veta e qeni i tyre ishte i teti". Thuaj (o Muhamed): "Zoti im e di më mirë numrin e tyre. Vetëm pak veta dinë diçka rreth tyre". Dhe mos polemizo rreth tyre, përveçse në mënyrë të përciptë dhe për ata mos pyet askënd! Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: "Me siguri që nesër do ta bëj këtë", pa shtuar "Në dashtë Allahu!" Dhe, kur të harrosh (të thuash "në

dashtë Allahu") - kujtoje Zotin tënd e thuaj: "Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo". Ata qëndruan në shpellën e tyre tregind vjet (diellorë), duke shtuar nëntë (për vitet hënore). Thuaj (o Muhamed): "Allahu e di më mirë sa kanë qëndruar. Atij i përket fshehtësia e qiejve dhe e Tokës. Eh, sa mirë sheh Ai çdo gjë dhe sa mirë që dëgjon! Njerëzit nuk kanë tjetër mbrojtës përveç Atij dhe Ai nuk e ndan me askënd pushtetin e Vet." (Kehf, 1-26)

Për herë të parë ishin mbledhur kaq shumë njerëz dhe për herë të parë po dëgjonin me kaq shumë seriozitet. Liderët politeistë, të cilët po përjetonin gjendje shoku nga habia, pa humbur aspak kohë, menjëherë dolën te pyetja e dytë.

Pyetja jonë e dytë ishte kjo:

"Na nofto për atë që e ka shëtitur tokën nga lindja deri në perëndim!"

I Dërguari i Allahut, alejhi's-salam, u kthye nga liderët politeistë dhe nga populli që po e shikonin me një kureshtje në rritje dhe tha:

"Pyetja juaj e dytë ka të bëjë me Dhulkarnejnin, alejhi's-salam. Historia e tij është kështu:

Pejgamberi, alejhi's-salam, lexoi pjesën në lidhje me Dhulkarnejnin (a.s.), nga surja Kehf:

"Ata (hebrenjtë) të pyesin ty (Muhamed) për Dhulkarnejnin, thuaj: "Unë do t'ju tregoj disa lajme për të." Ne i dhamë atij mundësi në Tokë dhe i dhamë mjete e rrugë për të arritur çdo gjë, kështu që ai u nis në një rrugë. Kur arriti në vendin e perëndimit të Diellit, pa se ai po ulej në një burim të zi balte dhe në afërsi të tij gjeti një popull. Ne thamë: "O Dhulkarnejn, mund t'i ndëshkosh ata ose mund t'u bësh mirë atyre." Ai tha: "Sa i përket atij që bën të këqija, Ne do ta ndëshkojmë e pastaj do të kthehet te Zoti i vet, i Cili do ta ndëshkojë me një dënim të rëndë. Sa për atë që beson dhe bën vepra të mira, atij i takon shpërblymi më i mirë dhe do t'i premtojmë atij lehtësira." Pastaj ndoqi një rrugë tjetër. Kur arriti në vendin e lindjes së Diellit, Ai e pa të lindte mbi një popull, të cilit Ne nuk i kishim dhënë gjë, për t'u mbrojtur nga dielli. Kështu ndodhi dhe Ne dinim gjithçka për të. Pastaj mori një rrugë tjetër. Derisa, kur arriti në mes dy malesh, gjeti rrëzë tyre një popull, i cili pothuaj nuk kuptonte asnjë të folme." (Kehf, 83-93)

Përsëri të gjithë po dëgjonin pa nxjerrë zë. Liderët e politeistëve, të cilët ranë në një humbje të madhe dhe të frikshme, ngaqë nuk kishin rrugë tjetër, kalluan te pyetja e tretë:

Pyetja jonë e tretë ishte kjo:



“Çfarë është shpirti? Si është ai?”

I Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, kësaj pyetjeje i dha një përgjigje shumë të shkurtër me një ajet fisnik:

**“Do të të pyesin ty për shpirtin. Thuaj: “Shpirti është çështje që i përket vetëm Zotit tim, ndërsa juve nuk ju është dhënë veçse pak dijeni.”** (Isra, 85)

Pastaj u tha me një ton zëri të lartë:

**“Kështu më janë shpallur përgjigjet e pyetjeve që më keni bërë!”**

Përgjigjet e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-selam, i gëzuan pa masë myslimanët. Ndërsa mushrikët po përjetonin një humbje të tmerrshme. Tradhtarët, të cilët nuk lanë gjë pa bërë dhe fjalë pa thënë përgjatë pesëmbëdhjetë ditëve, tani po heshtnin.

Ndërsa tani le të kërkojmë pak për përgjigjen e pyetjes: “Përse u vonua shpallja kaq shumë?” Në të vërtetë, nuk ka ndonjë gjë për të kërkuar, sepse literatura islame dhe veçanërisht librat e tefsirit, kanë dhënë informacion mjaft të gjerë në lidhje me këtë çështje.<sup>5</sup>

Kur i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, u tha mushrikëve: “Nesër do t’ju jap përgjigje!” – nuk pati thënë “inshallah”. Këtu nuk kishte ndonjë synim të keq, por ja që nuk pati thënë “inshallah”, domethënë, “nëse do Allahu”.

Ngaqë Allahu i Madhëruar është shumë i mëshirshëm kundrejt robërve të Tij, na tregon me këtë shembull se si duhet të veprojmë kur të themi ndonjë fjalë apo kur të bëjmë ndonjë gjë. Meqë i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, është i pari që i drejtohet kjo këshillë, do të thotë se Allahu Teala nuk e ka përjashtuar as atë në lidhje me këtë çështje. Ndërmjet ajeteve që erdhën si përgjigje për pyetjet që bënë politeistët, gjendej edhe ajeti qortues i cili thotë:

**“Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: “Me siguri që nesër do ta bëj këtë”, pa shtuar “Në dashtë Allahu!” Dhe, kur të harrosh (të thuash “në**

dashtë Allahu”) - **kujtoje Zotin tënd e thuaj: “Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo”.**” (Kehf, 23-24)

Kjo është njëra anë e ngjarjes.

Tani le të vijmë te mesazhi i duhur...

Ardhja e përgjigjes dhe drejtimi i mushrikëve ndaj kësaj përgjigjeje pas pritjes së gjatë të shpalljes që u vonua, siç e mbajti çështjen në rend të ditës përgjatë pesëmbëdhjetë ditëve, edhe shpalljen që erdhi e bëri influencuese në dimensione serioze mbi të gjithë, sepse përgjigja erdhi pikërisht në një kohë kur nevoja ishte emergjente. Në këtë mënyrë, ndikoi së tepërmi në zemrat e njerëzve.

Nëse mund ta shprehim kështu, Allahu dhe i Dërguari i Tij ua shkatërruan kurthet politeistëve të Mekës, sepse ata patën folur shumë në lidhje me këtë ngjarje.

Ndërkohë që liderët e politeistëve mekas e ngacmonin Pejgamberin, alejhi’s-selam, nuk arrinin të bënin asgjë kundrejt shpalljes që vinte. Pasi nuk u ngeli asnjë rrugëzgjdhje, hidhnin shpifje të shëmtuara duke thënë: “Ai i ka shpikur vetë këto!” Pasi përgjigja e pyetjeve që patën bërë ata nuk erdhi për pesëmbëdhjetë ditë, filloi të ngjallej mendimi: “Kurani Fisnik është dërguar nga Allahu!” Sepse, po të ishte në dorën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), do të jepte përgjigje menjëherë!

Krahas të gjithave këtyre, të gjithë mushrikët me në krye liderët e tyre, për herë të parë po dëshmonin një mbledhje kaq serioze. Allahu i Lartësuar, i Cili e vonoi kaq shumë shpalljen, absolutisht se çdo gjë e bën sipas një caktimi.<sup>6</sup>

Po... Edhe ne nuk duhet të harrojmë të themi “Inshallah” kur të japim ndonjë fjalë apo kur të premtojmë për të bërë ndonjë punë, sepse qortimi në ajetin e mësipërm i përfshin të gjithë myslimanët. Edhe i Dërguari i Allahut kështu na ka lajmëruar.

Salallahu alejhi ve selem...

**“Asnjëherë mos thuaj, për çfarëdo gjëje qoftë, se: “Me siguri që nesër do ta bëj këtë”, pa shtuar “Në dashtë Allahu!” Dhe, kur të harrosh (të thuash “në dashtë Allahu”) - kujtoje Zotin tënd e thuaj: “Shpresoj se Zoti im do të më udhëzojë në atë që është më e mirë dhe më e dobishme nga kjo”.**” (Kehf, 23-24)

5. Taberi, Tefsir, vëll. 15, fq. 191-192; Fahreddin er-Razi, Tefsir, vëll. 21, fq. 82; Kurtubi, Tefsir, vëll. 10, fq. 346-347; Ebu'l-Fida Ibn Kethir, Tefsir, vëll. 3, fq. 71-72.

6. Muhammed Ebu Zehra, Son Peygamber Hz. Muhammed (sav), vëll. 2, fq. 132-136.



# TREGONI MËSHIRË DHE BUTËSI

Mustafa Kycykashçë

Në ajetin fisnik, i cili thërret për në festën e xhumasë, ka një urdhër:

**“O ju që keni besuar, kur të thirreni për (të falur) namazin (e xhumasë) në ditën e premte, vraponi për ta përmendur Allahun dhe pezulloni tregtinë! Kjo, që ta dini, është më mirë për ju!”** (Xhuma, 9)

Tani le të lexojmë një hadith fisnik:

*“Asnjë prej jush të mos vrapojë për në namaz kur të thirret ikameti për të falur namazin, por të ecë i qetë dhe me dinjitet! Atë që e arrini, faleni (me imamin)! Ndërsa atë që nuk e arrini, faleni kaza (plotësojeni vetë)!”* (Muslim, Salat, 154.)

Në pamjen e jashtme, ajeti fisnik thotë “vraponi”, ndërsa hadithi fisnik thotë “mos vraponi”. Mos vallë ka ndonjë kontradiktë ndërmjet këtyre dy urdhrave? Jo! Dijetarët e shpjegojnë mjaft bukur këtë ndryshim që në aparençë duket si kontradiktë:

Urdhri: “Vraponi!”, në ajetin fisnik do të thotë: “Ejani me dëshirë, mallëngjim dhe përmallim!” Domethënë, nuk duhet të merret në kuptimin e parë: “Vraponi!”

Ndërsa vrapo i ndaluar në hadithin fisnik, është vrapo në një mënyrë shqetësuese.

Domethënë, besimtari duhet të vijë në xhami me një dëshirë të zjarrtë. Duhet të vijë me një përmallim të madh dhe ashtu të dalë në audiencën e Zotit (xh.xh.). Pra, nuk duhet të vijë duke vrapuar, por duhet të ecë me dinjitet.

Përsëri dijetarët e kanë shpjeguar se përse i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka ndaluar ardhjen me vrap në namaz duke gulçuar:

“Njeriu që vrapon merr frymë fort dhe lodhet. Për këtë arsye, futet në namaz i shqetësuar, i lodhur dhe pa përqendrim. Ndërkohë namazi kërkon qetësi dhe vepërime me maturi.”

Kësaj mund t’i shtojmë edhe këtë shpjegim:

Imami dhe xhemati, të cilët po falin namazin në xhami, mund të shqetësohen nga zhurmat dhe zërat e

atyre njerëzve që hyjnë në xhami duke gulçuar dhe duke vrapuar. Për këtë arsye, ata mund ta humbin përqendrimin në namaz dhe mund të kaplohen nga shqetësimi se mos po ndodh ndonjë gjë. Nëse i marrim parasysht kushtet e kohës së të Dërguarit të Allahut (a.s.) dhe, nëse na kujtohen sulmet e dhëna me shembuj në suren Adijat, ky shpjegim përputhet plotësisht me rrethanat e asaj kohe. Andaj, mund të mendojmë se i Dërguari i Allahut (a.s.), e ka ndaluar këtë ngaqë nuk ka dashur që në xhami të hyhet sikur po ndodh ndonjë sulm nga armiku. Domethënë, njerëzit duhet të bëjnë kujdes që edhe kur të hyjnë në xhami të mos i frikësojnë besimtarët që gjenden në namaz.

Në të vërtetë, këta dy urdhra mbartin një mësim të rëndësishëm:

Dëshira e zjarrtë që ka zemra nuk duhet të shndërron në shqetësim kur të shkojmë në xhami. Pra, kjo dëshirë e zjarrtë nuk duhet të anashkalojë maturinë, qetësinë dhe rregullin.

I Dërguari i Allahut (a.s.), ka bërë shumë qortime të tilla. Madje, një titull kreu në “Rijadu’s-Salihin” është:

Ndalimi i shakave të ndërsjella me armë

Ndalesa e bërjes me shenjë ndaj një myslimani me armë apo me gjëra të tjera të ngjashme dhe ndalesa e dhënies së shpatës së nxjerrë nga këllëfi në mënyrë serioze apo duke bërë shaka...

Ebu Hurejra (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, alejhi’s-selam, ka thënë:

*“Asnjëri prej jush të mos ia drejtojë vëllait të tij në fe armën, sepse, ndoshta shejtani ia merr armën nga dora (dhe e vret atë). E si pasojë, rrokulliset në ndonjë prej gropave të Xhehenemit.”* (Buhari, Fiten, 7; Muslim, Birr, 126.)

Kur dëgjojmë se fjala popullore: “E mbush shejtani.” – buron nga hadithi fisnik, ndjehemi krenarë për trashëgiminë shpirtërore që kemi. Me të vërtetë, ata që e kanë neglizhuar këtë urdhër, janë bërë shkak për



shumë vrasje dhe plagosje.

Për këtë arsye, ne duhet të marrim masa edhe kundrejt mbushjeve të tjera të shejtanit të mallkuar.

Zbrazëtirën nëpër rreshtat e namazit, domethënë, zbrazëtirën në vëllazëri e mbush shejtani.

Zbrazëtirën në fillimet pa Besmele e mbush shejtani.

Nëse e lexojmë Kuranin Fisnik me shpirt të boshatisur, shpirtin e mbush shejtani.

Tani le t'i kthehemi përsëri bahçes së haditheve të Rijadus Salihinit:

Shprehjet janë shumë të ashpra dhe mjaft paralajmëruese:

*“Nëse dikush i drejton hekurin vëllait të tij, qoftë ai edhe vëllai nga nëna dhe babai, engjëjt e mallkojnë derisa ta lërë atë.”* (Muslim, Birr, 125. Veçanërisht shik: Tirmidhi, Fiten, 4.)

Edhe shënimi tek shpjegimi i këtij hadithi mbart të njëjtën veti paralajmëruese:

Sipas një hadithi, të cilin Nesai e transmeton nga Ebu Bekri, i Dërguari i Allahut (a.s.), është shprehur se kur një mysliman ia drejton armën vëllait të tij mysliman, që të dy gjenden në buzë të greminës së Xhehenemit. Nëse ndonjëri e vret tjetrin apo, nëse ndodh që ndonjëri prej tyre të vdesë, që të dy bashkë do të rrokullisen në Xhehenem. (Shik. Nesai, Tahrim, 29.)

Xhabiri (r.a.), ka thënë:

“I Dërguari i Allahut (a.s.), e ka ndaluar dhënien dorë më dorë të shpatës së nxjerrë nga këllëfi i saj.” (Ebu Davud, Xhihad, 66; Tirmidhi, Fiten, 5.)

Kur njerëzit, të cilët e njohin edukatën, i zgjasin njëritjetrit thikën, gërshërët etj., pjesën e majës apo pjesën prerëse e kapin me dorë. Ndërsa pjesën ku kapet objekti e kthejnë nga ai që do t'ia japin. Ja, kjo është një edukatë e marrë nga hadithi fisnik...

A vetëm marrje masash janë këto? Këto qortime e paralajmërime tregojnë se në edukimin profetik jepen përpjekje maksimale për ta pastruar madje edhe në nënvetëdije mundësinë e zënkës me vëllain. Një njeri që mëson edukatën për të mos e përdorur diçka të mprehtë duke ia drejtuar vëllait të tij, sigurisht se nuk bëhet fjalë që ta kërcënojë atë me shpatë, ta godasë apo ta vrasë.

Shoqëria në të cilën jetojnë myslimanët duhet të jetë një shoqëri me dinjitet, me sedër, e qetë, e kulturuar, e edukuar dhe një shoqëri që merr masa paraprake për çdo gjë.

Ja pra, si mund të shndërrohem në një shoqëri që ia pret kokën myslimanit pa iu trembur syri duke shqiptuar tekbiere, ndërkohë që jemi umeti i një Pejgamberi të tillë?..

Sa realitet i dhimbshëm...

Domethënë se këta myslimanë nuk kanë marrë asgjë shpirtërisht nga edukimi profetik, edhe nëse i lënë mjekrat, edhe nëse e bëjnë flamur vulën e të Dërguarit të Allahut (a.s.), edhe nëse lexojnë ajete kuranore dhe hadithe fisnike. Qofshin të planifikuar apo qofshin të paplanifikuar, ata janë prodhim i perëndimit. Ata janë

produkt i regjimeve të cilët udhëhiqen nga perëndimi.

Por prapëseprapë pyetja shtrohet: Si kanë rënë në këtë gjendje myslimanët? Si ka ndodhur kjo?

Përgjigja: “I ka mbushur shejtani.”

Ata të cilët e kanë lënë mënjanë vëllazërinë, bashkimin dhe unitetin, ata që i kanë hedhur në një anë dispozitat që na urdhërojnë të mos i lëmë myslimanët dhe të mos formojmë lidhje miqësore me femohuesit, sot kanë krijuar ndasi të theksuara brenda Islamit. Tashmë perëndimi po shikon vrasjet që bëjnë ndaj njëri-tjetrit myslimanët, të cilët i kanë ndarë në Shia, Selefë dhe Suni. Ndërkohë, nëse rrezikohet nafta, ndërhyrjen menjëherë.

Shejtani nuk mbush vetëm armët, por edhe njerëzit që do ta shtypin këmbëzën e atyre armëve. Ai i mbush ata me urrejtje, me armiçësi dhe me tirani.

Me çfarë i mbush tjetër?

I mbush me përgojime.

I mbush me thashetheme.

I mbush me provokime.

I mbush me gënjeshtër.

I mbush me shpifje.

I mbush me lajme të servitura nga të devijuariat. I mbush me operacionet e paragjykitimit.

Kush i përgatit librat e arsimit në vendet arabe për vite me radhë? Kush i udhëheq politikatat sociale të tyre?

Kokat e myslimanëve që vrapojnë drejt shtetit të terrorit janë të mbushura me shembuj nga perëndimi dhe jo nga i Dërguari i Allahut (a.s.). Ata që kanë qenë të burgosur në Guantanamo dhe Ebu Gurejb, shfaqin tirani të mëdha si në Musul dhe Kobane.

Andaj, asnjëherë nuk duhet t'i harrojmë mësimet e të Dërguarit të Allahut (a.s.), i cili na ka treguar se si na mbron Allahu Teala.

Besimtarët duhet të vrapojnë me gjithë shpirt e zemër drejt Allahut. Ndërkohë, çdo hap të tyre duhet ta hedhin me dinjitet, duke marrë masa paraprake dhe duke mos nxituar.

Zgjidhja është kjo:

Ne duhet të mbushemi plot me Islamit e vërtetë, aq sa shejtani të mos gjejë vend për të mbushur...

Duhet të mbushemi me traditën profetike, në mënyrë që bidati të mos ketë vend për t'u futur...

Duhet të mbushemi plot me mëshirë, në mënyrë që dhuna të mos gjejë vend te ne...

Duhet të mbushemi plot me sakrificë, në mënyrë që egoizmi të mos ketë mundësi për të depërtuar...

Duhet të mbushemi plot me bujari, në mënyrë që koprancia të mos na afrohet...

Nëse mbushemi plot me këto, pastaj fillojmë t'ua japim edhe të tjerëve. Atëherë, me mëshirën që shpërthen nga zemrat tona, do t'ia tregojmë fytyrën e vërtetë të Islamit të gjithë botës islame, madje, të gjithë njerëzimit. Në sajë të kësaj, do ta përhapim në çdo vend mëshirën dhe butësinë.

# MREKULLITË E Kuranit

## IDENTITETI NË SHENJAT E GISHTËRINJVE

**"A mendon njeriu se nuk do t'i mbledhim eshtrat e tij? Po, do t'i mbledhim! Madje Ne jemi të zotë t'i krijojmë përsëri edhe majat e gishtërinjve të tij!"** (Kijame, 3-4)

Çdo njeri, duke përfshirë edhe binjakët që mezi dallohen nga njëri-tjetri, ka shenjat e tij të veçanta të gishtërinjve. Me fjalë të tjera, identiteti i secilit është i koduar në majat e gishtërinjve të tij. Ky sistem i koduar mund të krahasohet me sistemin e kodit të vijave, i cili përdoret në ditët tona për identifikimin e prodhimeve të ndryshme, si prodhimet industriale apo ushqimore. Theksimi i shenjave të gishtërinjve ka një domethënie mjaft të veçantë, sepse secili ka shenjën e tij unike të gishtërinjve, e cila nuk i ngjason askujt. Çdo person që jeton apo ka jetuar në këtë botë ka formën e tij unike të shenjave të gishtërinjve. Për këtë arsye, shenjat e gishtërinjve janë një prove mjaft e rëndësishme e identitetit, ndaj dhe sot përdoren pikërisht për këtë qëllim. Por më e rëndësishmja është se kjo veçori e shenjave të gishtërinjve u zbulua nga fundit i shekullit të 19-të. Përpara kësaj periudhe, njerëzit i shihnin shenjat e gishtërinjve si disa rrathë të zakonshëm, pa ndonjë rëndësi apo kuptim specifik. Është Kurani ai që na flet për këtë karakteristikë dalluese të shenjave të gishtërinjve, e cila nuk u kuptua veçse në ditët tona.





## PJESA PËRGJEGJËSE E TRURIT PËR LËVIZJEN DHE GËNJESHTRËN

**"Jo, Jo! Nëse ai nuk ndalon, Ne do ta kapim prej ballukeve. Balluke gënjeshtare dhe mëkatare." (Alek, 15-16)**

Fraza *"balluke gënjeshtare dhe mëkatare"* në ajetin e mësipërm është mjaft interesante. Përse i quan Kurani flokët e pjesës së përparme të kokës gënjeshtare dhe mëkatare? A nuk është vetë njeriu gënjeshtar dhe mëkatar? Cila është lidhja që ekziston midis gënjeshtres e mëkatit nga njëra anë dhe ballukeve (apo flokëve të pjesës së përparme të kokës) nga ana tjetër? Kërkimet e kryera kohët e fundit zbuluan se fusha ballore, e cila është përgjegjëse për drejtimin e të gjitha funksioneve specifike të trurit, ndodhet në pjesën e përparme të tij. Vetëm në 60 vitet e fundit, shkencëtarët e zbuluan funksionin e kësaj zone, gjë të cilën Kurani e ka përmendur që 1400 vjet më parë. Nëse shohim brenda kafkës në pjesën e përparme të kokës, ne do të gjejmë fushën ballore të trurit. Në një libër me titull *Bazat e Anatomisë dhe Psikologjisë*, në të cilin përfshihen kërkimet më të fundit mbi efektet e kësaj fushe në tru, thuhet: Motivimi dhe parashikimi për të planifikuar dhe për të filluar lëvizjet ndodh në pjesën e përparme të lobit ballor, pikërisht në fushën ballore. Kjo është një zonë ku ndodh procesi informues... Libri gjithashtu thotë: Në lidhje me përfshirjen e saj në motivim, fusha ballore mendohet të jetë gjithashtu qendra funksionale e agresionit... Kështu, kjo zonë e trurit është përgjegjëse për planifikimin, motivimin dhe kryerjen e punëve të mira e të këqija, ashtu siç është përgjegjëse për thënien e gënjeshtreve dhe të vërtetave. Është më se e qartë se shpallja *"balluke gënjeshtare dhe mëkatare"* përputhet tërësisht me shpjegimin e mësipërm. Ky fakt, të cilin shkencëtarët e zbuluan në 60 vitet e fundit, është shpallur nga Zoti në Kuran shumë shekuj më parë.

*“Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të (me Kuranin - namazin), është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm.”*

(Isra, 79)

Në ajetin e mësipërm, Pejgamberit i kërkohet të zgjohet nga gjumi në një pjesë të natës dhe të falë namaz.

Ky lloj namazi është quajtur namazi i Tehexhudit nisur nga kuptimi i kësaj fjale në gjuhën arabe.

Pejgamberi (a.s.) u ka tërhequr vëmendjen sahabeve, të cilët rrinin tërë natën zgjuar për të falur namaz, duke u thënë se është një lodhje e madhe për trupin, prandaj nuk e ka parë të arsyeshme të merren tërë natën me adhurime.

Nga sa kuptohet nga ajeti në fjalë, namazi i Tehexhudit është një adhurim që i përket vetëm të Dërguarit të Allahut. Ka nga dijetarët që mendojnë se ky adhurim është mendup dhe nafile, pra një virtyt më shumë për të Dërguarin e Allahut.

Arsyeja e një mendimi të tillë është se Pejgamberit (a.s.) i janë falur të gjitha gjynahet. Natyrisht që një gjë

e tillë nuk bëhet fjalë për bashkësinë e tij. Namazi i natës është një falje e gjynaheve të tyre.

Të tjerë dijetarë kanë theksuar se namazi i natës i quajtur Tehexhud është një farz më shumë për Pejgamberin (a.s.) i shtuar mbi pesë kohët e ditës dhe ky farz i posaçëm është për të përfocuar edhe më shumë prioritetin e tij mbi bashkësinë Islame.

Nisur nga vijimi i ajetit **“është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm”**, vendi i lavdishëm është vendi ku bëhen falënderimet dhe mirësitë. Ky post i lartë i përket Pejgamberit (a.s.).

Në Ditën e Gjykimit çdo bashkësi, apo e thënë ndryshe i gjithë njerëzimi do kërkojë të shpëtojë sa më shpejt nga ajo pritje e frikshme nëpërmjet ndërmjetësimi të Profetit dhe me të shpëtuar nga kjo pritje do ta falënderojë. Makami Mahmud mund të quhet ndryshe edhe makami shefaat.



Transmetohet nga Aishja (r.a.), se Pejgamberi -(a.s.)-, ngrihej natën dhe falte namaz deri në enjtjen e këmbëve. Nisur nga kjo e pyeta: "O i Dërguari i Allahut! Pse e mundon veten kaq shumë ndërkohë që Ty të janë falur të gjitha gjynahet?" I Dërguari i Allahut iu përgjigj: "Pse të mos jem një rob falënderues?"

(Buhari, Muslim)

### **SHPJEGIME**

Pejgamberi (a.s.) ngrihej natën dhe adhuronte Allahun deri sa këmbët i enjtëshin ndërkohë që Aishja shqetësohej shumë për këtë. Ajo mendonte se Ai bënte adhurim me frikën e gjynaheve apo me dëshirën që të falej. Prandaj ia kujtoi edhe shprehjen që zë vend në hadith "Allahu t'i ka falur të gjitha gjynahet". Prandaj ajo e pyet se përderisa Allahu të ka falur të gjitha gjynahet që ke bërë dhe ato që do bësh përse e mundon veten kaq shumë? Natyrisht i Dërguari i Allahut s'mund të rrinte në heshtje. Ai iu për-

gjigj se po bënte vetëm detyrën e një robi për ta falënderuar me sa kishte mundësi Allahun për mirësinë e madhe të faljes.

Sipas Aishes, i Dërguari i Allahut për një kohë të gjatë ka qëndruar me orë të tëra në këmbë duke bërë adhurim dhe këtë e shijonte me një kënaqësi tepër të madhe, por me të shtuar në peshë nisi të falte namaz i ulur. Rrinte një kohë të gjatë ulur dhe lutej, kur donte të binte në sexhde ngrihej në këmbë, pas një farë kohe ulej në ruku dhe në sexhde sërish.

### **Mësimet që nxjerrim nga hadithi:**

1. I Dërguari i Allahut, natën bënte shumë adhurim për ta falënderonte Zotin.
2. Falënderimi për mirësinë është një detyrë njerëzore.
3. Ka shumë rrugë për ta falënderuar Allahun për mirësitë e dhëna. Kjo mund të shprehet edhe me gjuhë ashtu sikurse mund të bëhet edhe me adhurim natën siç vepronte vetë Pejgamberi (a.s.).
4. Nëpërmjet kësaj, Pejgamberi (a.s.) tregonte se kjo është mënyra më e mirë për të shprehur robërinë ndaj Allahut.



# HORIZONTI I NDËRGJEGJES DHE HUMANIZMIT

## KA DY SY QË...

Profeti ynë i dashur (a.s.), thotë:

*“Ka dy sy, që nuk i prek zjarri i Xhehenemit:*

- *Syri që qan për hir të Allahut,*
- *Syri që gdhiet zgjuar duke bërë roje në rrugë të Allahut.”* (Tirmidhi, Fedailu'l-Xhihad, 12/1639.)

Cilësitë e këtyre dy syve të çliruar prej Xhehenemit janë:

Frika nga Allahu, dhembshuria, shërbimi dhe përpjekja.

Një sy që kur zotëron vetëdijen e të qenit nën vëzhgimin e kamerave hyjnore, e madhëron Allahun sikur është duke e parë, dridhet përballë madhështisë dhe fuqisë së Tij, ndjen frikë, digjet nga dashuria dhe loton prej peshës që i jep detyra e përgjegjësia.

Ai është një besimtar që e ndjen në supe gjynahun e amanetit që bart, që i ndjen në ndërgjegje vuajtjet materiale, e sidomos shpirtërore të njerëzve që duhet të mbrojtë dhe që me këtë përpjekje, derdh djersë po aq sa derdh edhe lot.

Një besimtar, që për të mbrojtur fenë, atdheun, vëllain e fesë, vëllazërinë, unitetin; për të ruajtur nderin dhe namusin e vetes, familjes e kombin e tij nga sulmet, qëndron në kufi pa vënë gjumë në sy.

Ja pra, një rob i tillë, është një besimtar që ka gëzuar mëshirën hyjnore, aq sa mund të shuajë Xhehenemin me dritën e tij.

Shembulli më i përsosur i kësaj, është Profeti ynë i dashur (a.s.), i cili zotëronte përsosmërinë e virtyeteve të butësisë, dhembshurisë, mëshirës, përpjekjes, thjeshtësisë dhe frikës ndaj Allahut.

## PROFETI I DREJTËSISË DHE MËSHIRËS...

Viti i dytë i hixhrit përkon me datën 14 mars 624 (sipas kalendarit Gregorian).

Profeti (a.s.), ndodhet në Bedër së bashku me 313 sahabët e tij. Përballë tyre qëndron ushtria e idhujtarëve kurejshë, që ishin tri herë më shumë në numër dhe të armatosur më mirë. Profeti (a.s.), e kalon natën nën një pemë, duke derdhur lot për Allahun dhe duke i drejtuar mëshirës hyjnore lutje që i buronin nga shpirti. Ai e gdhin mëngjesin me kijame dhe sexhde, për mbrojtjen fizike dhe shpirtërore të sahabëve të tij, që po flinin të qetë.

Ai Profet mëshire, i përgjerohej Allahut për fitore. Rrezet e ndritshme të kandilit të Islamit që kishin zënë vend në Medinë, duhej të përhapeshin kudo në horizont. Duhej eliminuar çdo pengesë që e rrezikonte Islamit, ndaj duhej lufta dhe çlirimi. Çlirimi i zemrave...

Myslimanët shkuan herët në fushën e betejës dhe u pozicionuan në vendin ku ndodheshin pusët e Bedrit. Për të përfutur prej ujit të puseve, kishin bërë një hauz.

Kur erdhi ushtria e kurejshëve, një pjesë prej idhujtarëve ndër të cilët ishte edhe Hakim bin Hizami, u afruan të pinin ujë prej hauzit të mysli-manëve. Kur mysli-manët tentuan t'i pengonin, Profeti i Allahut (a.s.), tha:

*“Lërini të pinë!”*

Leja që të pinin ujë njerëzit me të cilët pas disa orësh do të plaste lufta shpatë për shpatë, është një shprehje madhështore e fisnikërisë dhe karakterit të lartë të Islamit.



## HUMANIZËM EDHE NDAJ ARMIKUT

Kjo leje është parimi njerëzor dhe metoda më e bukur e udhëzimit që na mësohet ne. Bujaria, fisnikëria dhe njerëzillëku që shfaqet në kohë të vështira, do të zbutte zemrat e ngurtësuar dhe do të hidhte themelet e udhëzimit në ato zemra. Për rrjedhojë, Hakimi, i cili atë ditë piu ujë nga ai pus, më vonë u bë mysliman. Kur Hakimi dëshironte ta forconte fjalën e tij me një betim, thoshte:

“Jo! Betohe me në Allahun që më shpëtoi nga vdekja në Bedër dhe më dha mirësinë e besimit!” (Ibn Hisham, II, 261.)

Atë ditë, në Bedër u realizua fitorja më madhështore në botë. Shumë prej parisë së idhujtarëve më të flaktë Mekas, të cilët i tallën, i ofenduan, i akuzuan dhe i torturuan në mënyrat më çnjerëzore Profetin (a.s.) dhe myslimanët që prej 14 vitesh, shkuan në Xhehenem. Ndërsa shtatëdhjetë prej tyre, u kapën rob.

Po ashtu, edhe sjellja që u tregua ndaj robërve, tregoi më së miri butësinë dhe ëmbëlsinë e Islamit. Ebu Azizi, vëllai i Mus'ab bin Umejrit, i cili ishte ende prej idhujtarëve, ndodhej midis robërve të kapur në luftën e Bedrit. Si shpërblim për lirinë e tij, ai duhej t'u mësonte fëmijëve shkrim dhe këndim. Ai u caktua të qëndronte në shtëpinë e një familjeje të varfër të ensarëve. Familja ensare, ushqimet e vështira për t'u gjendur ia jepte robit të luftës, i cili u mësonte shkrim dhe këndim fëmijëve. Ndërsa për vete e shtynin me hurma dhe ujë. Ebu Azizi tregon:

“Unë turpërohesha kur shihja se ajo familje m'i jepte mua ushqimet më të mira që gjenin, ndërkohë që për vete hanin vetëm hurma me ujë. Megjithatë unë u thashë: «Mos bëni kështu! Edhe unë dua të ha hurma e të pi ujë si ju, ndërsa këto ushqime të shijshme jepuan fëmijëve!», - ata thoshin: «Jo! Ne kë-

shtu na ka urdhëruar Profeti i Allahut.»” (Hejthemi, VI, 86; Ibn-i Hisham, II, 288.)

Kjo njerëzi, mëshirë dhe përgjegjësi, pa kaluar shumë, nderoi me Islam Ebu Azizin dhe shumë tjerë si ai. Prej njerëzve të egër e të pagdhundur të periudhës së injorancës, doli në pah një qytetari virtytësh, e cila ndërtoi personalitete të larta me zemër të butë, ndërgjegje të pastër dhe të përkushtuar ndaj Allahut.

Profeti ynë (a.s.), që qante për Allahun e derdhte lot për umetin, edhe për çlirimin e Mekës, tregoi po të njëjtën njerëzi dhe bujari. Madje, para se të çliro-

hej Meka, ai dërgoi ndihma për banorët e saj gjatë kohës së zisë për bukë. Në rrjedhën e ngjarjeve që shkojnë deri tek çlirimi i Mekës, ai i mori të gjitha masat e duhura, me qëllim që çlirimi të mos ishte “dita e derdhjes së gjakut, por dita e mëshirës”.



## DITA E MËSHIRËS

Çlirimi u realizua dhe tashmë ishte krijuar mundësia për t'u hakmarrë ndaj njëzet vjetëve padrejtësi, tortura dhe vrasje. Ata që u bënë shkak i martirizimit të vajzës së Profetit (a.s.) dhe që përdhosën edhe trupin e xhaxhait të tij, qëndronin përballë komandantit të ushtrisë fitimtare islame, Rasulullahut (a.s.), duke pritur fermanin që do të dalë prej dy buzëve të tij.

Mirëpo, ai det mëshire dhe faljeje, i pyeti ata:

“O bashkësi e Kurejshëve! Çfarë mendoni se do të veprojnë me ju tani?”

Kurejshët, thanë:

“Ne shpresojmë se ti do të bësh mirë. Prandaj themi: «Do të bësh mirë, sepse ti je një vëlla bujar dhe bamirës. Ti je biri i një vëllai bujar dhe bamirës!”

Pas kësaj, Profeti (a.s.), tha:

“Edhe unë, do t'ju them ashtu siç u tha Jusufi vëllazërve të tij:

**“...Sot s’ka qortim për ju; Allahu do t’ju falë. Ai është më i mëshirshmi i mëshiruesve!”** (Jusuf, 92)  
*Tani shkoni, jeni të lirë!”*

Profeti (a.s.), nuk cenoi askënd dhe as nuk u cenua. Në vend që t’i dëbonte banorët e Hajberit, të cilët deshën ta vrisnin, ai i la ata në tokat e tyre, si ortakë në administrim. Plaçkën e madhe të luftës që u fitua në betejën e Hunejnit, e ndau bujarisht për njerëzit që dëshironte t’u ngrohte zemrën ndaj Islamit. Kjo, sepse ai kërkonte të fitonte zemrat dhe jo të hakmerrej duke u marrë jetën apo pasurinë të tjerëve. Profeti (a.s.), kërkonte të fitonte zemra e të bëhej shërim dhe zgjidhje për çdo hall të umetit të tij. Dhe në këtë rrugë, ai ishte i gatshëm të vuante, të duronte fyerje, të derdhte djersë e lot dhe të kalonte net të tëra pa gjumë.

Në zemrën e tij ziente mëshira dhe dhembshuria. Megjithëse me mundësi të dobëta e të mangëta, Ai u drejtua drejt qëllimit më të lartë dhe arriti rezultate të mrekullueshme.

Ai arriti të edukojë mijëra sahabë të cilët morën hisen e tyre prej frymëzimit të tij shpirtëror. Ai edukoi një brez të devotshëm ndaj Allahut, sakrifikues ndaj të Dërguarit të Tij, shërbyes ndaj umetit dhe vetëmohues.

Ai brez, e barti si flamur frytëror e buzëqeshur të Islamit prej Kinës deri në Oqeanin Atlantik, prej Etiopisë deri në Stamboll dhe i mësoi njerëzimit besimin që i jep vlerën e vërtetë, adhurimin, moralin dhe gjykimin e drejtë.

Kur Omeri (r.a.), mori lajmin se djali i një guvernatori (valiu), kishte rrahur një njeri, e thirri valiun menjëherë në Medinë dhe e qortoi duke i thënë:

*“Qëkur keni filluar t’i skllavëroni njerëzit që kanë lindur të lirë prej nënave të tyre?”*

Një hebre i Hajberit, kafshonte gishtat prej drejtësisë që shfaqti një sahab dhe nuk e mbajti dot veten pa thënë: “Pikërisht prej këtij rregulli qëndrojnë në këmbë toka dhe qiejt!”

Të gjitha këto, sepse sahabët vepronin në bazë të Kuranit dhe Sunetit të Profetit (a.s.). Ata e kishin zhdukur egoizmin, kishin zhvilluar aftësitë shpirtërore, i shihnin njerëzit me syrin e dhembshurisë dhe mëshirës së Krijuesit, duke u bërë ambasadorë të mëshirës dhe udhëzimit.

Ata e kuptuan se njerëzimi dhe myslimanizmi, gjelbërojnë vetëm brenda kufijve që ka vendosur Allahu

i Madhëruar. Ata e shkrinë mendjen brenda shpalljes hyjnore dhe zemrën brenda shpirtit të Librit të Allahut dhe Sunetit të Profetit (a.s.). Atyre u ndryshoi shikimi ndaj gjithësisë dhe materies. Ata mësuan ta peshojnë gjithçka sipas kënaqësisë së Allahut dhe të respektojnë kufijtë e Tij.

## RESPEKTIMI I KUFIJVE TË ALLAHUT

Sepse ata e pranorin me zemër se:

**“...Kush i kapërcen kufijtë e Allahut, pa dyshim që i ka bërë padrejtësi vetes.”** (Talak, 1)

Ata kishin mësuar të arrinin paqen e bindjes ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij (a.s.), duke shpëtuar edhe veten, edhe botën prej padrejtësisë së vetes. Në një ajet fisnik, urdhërohet:

**“Këta janë kufijtë e caktuar prej Allahut. Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, Ai e shpie në kopshte, nëpër të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojë përherë. Kjo është fitorja e madhe.”** (Nisa, 13)

**“Ndërsa atë që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe shkel kufijtë e vënë prej Tij, Allahu e shpie në zjarr, ku do të qëndrojë përherë dhe për të ka ndëshkim poshtërues.”** (Nisa, 14)

Çlirimin e zemrave me mëshirë dhe dhembshuri që realizoi Profeti (a.s.), e vazhduan edhe brezat e devotshëm e të sinqertë që pasuan.

Sulltani Alparslan, i veshur me robra të bardha, që simbolizonin qefinin, me ushtrinë që komandonte vetë, arriti të mundë në Luginën e Malazgirtit ushtrinë e Bizantit, që ishte shumë herë më e madhe se ushtria e tij. Më pas, u soll në mënyrë të njerëzishme me Perandorin Diogjen, i cili ishte mundur dhe kishte rënë rob, duke e lënë atë të lirë.

Po ashtu, e njëjtë ishte edhe sjellja e Jëlldërëm Bejazidit ndaj kalorësve francezë, të cilët kërkuan falje prej tij, duke u betuar: “Nuk do të vijmë më!”

Kështu ishte edhe sjellja e Sullan Mehmet Fatihut ndaj patriarkut të mundur të Bizantit.

Shpata zhdukte vetëm padrejtësinë, thyente dyert e burgjeve dhe i shërbente misionit të largimit të pengesave midis njerëzve drejt rrugës së vetme të lumturisë së përjetshme, Islamit.

Murati i Parë dha jetën e tij në fushën e Kosovës për fitoren e Islamit. Në atë vend të çliruar u sollën familje myslimane nga Anadulli, të cilat e kishin

**Profeti (a.s.),  
zotëronte përsosmërinë  
e virtyteve të butësisë,  
dhembshurisë, mëshirës,  
përpjekjes, thjeshtësisë dhe  
frikës ndaj Allahut.**



bërë Islamit pjesë të natyrës së tyre. Jeta e tyre she-mbullore, ndikoi pozitivisht tek popullsia vendase dhe për rrjedhojë, populli i Maqedonisë, Kosovës dhe Shqipërisë u nderuan me Islam.

Edhe në çlirimin e Bosnjës nga Sulltan Mehmet Fatihu, u realizuan të njëjtat qëllime dhe u arritën të njëjtat rezultate. Boshnjakët i admiruan myslimanët e butë, të dashur e të ndjeshëm, që shihnin përreth xhamive duke e pranuar Islamit grupe-grupe. Ja pra, në sajë të këtyre sakrificave, përpjekjeve, lotëve, djersës dhe vuajtjeve po zgjerohet edhe rrethi i umetit që pranon Islamit duke iu afruar lumturisë së përjetshme.

Shpatat e fatihëve, mbrojtën popujt e mjeruar prej heshtave të vojvodinasve dhe prej sundimtarëve tiranë e të pashpirt. Në shumë raste, ushtritë osmane që përhapnin drejtësi, çliruan shumë vende me ftesën e popujve të shtypur vendas. Madje, edhe pas shumë shekujsh, presidenti hungarez Pal Schmitt, e ka kujtuar me mirënjohje faktin se shkaku i vetëm i mbijetesës së popullit të tij, ishte qëndrimi i tyre për 150 vite nën administrimin e Osmanëve.

Po ashtu, edhe këto përshtypje të gazetarëve dhe ambasadorëve të huaj që i përkasin periudhës së fundit osmane, tregojnë qartë se sa të gjalla ishin në këtë popull karakteri dhe fisnikëria islame deri në çastet e fundit.

### VIRTYTET E POHUARA PREJ ARMIKUT...

Mouradgea d'Ohsson, ka qenë ambasador i Suedisë në Stamboll. Gjatë asaj kohe, ai ka studiuar institucionet dhe organizimin Osman dhe në lidhje me to ka shkruar një vepër me shtatë vëllime. Ndër të tjera, D'Ohsson, tregon:

*“Osmanët, e meritojnë të lavdërohen për virtytet e tyre, si nderi, drejtësia dhe ndershmëria, të cilat mbështeten në ligjet më të çmuara të Kuranit. Një nga virtytet e tyre që duhet lavdëruar, është edhe mbajtja e fjalës së dhënë.*

*Ata do t'i vriste shumë ndërgjegjja nëse do të mashtronin ose do të përfitonin prej naivitetit të disa njerëzve, duke abuzuar me besimin e tyre. Kjo pjekuri që ka zënë vend në të gjitha sjelljet e tyre në marrëdhënie me njëri-tjetrin, shfaqet në mënyrë të njëjtë edhe ndaj të gjithë të huajve, të çfarëdo feje apo medh'hebi qofshin ata.*

*Në këtë pikë, ata nuk bëjnë dallime ndërmjet myslimanëve dhe jomyslimanëve, sepse ata e konsiderojnë haram çdo lloj fitimi të paligjshëm nga pikëpamja islame dhe besojnë në mënyrë të prerë se, një pasuri që nuk është fituar në rrugë të ligjshme, nuk do të ketë mirësi as në këtë botë dhe as në botën tjetër.”*

Charles Mac-Farlane është një armik i Osmanëve,

megjithatë ai nuk mund të rrijë pa e treguar këtë gjë mbresëlënëse:

*“Miku im M. W., kishte një fshatar të varfër me emrin Buxhallë Mustafa, të cilin e përdorte shpesh si korrier midis Çeshmes dhe Izmirit në stinën e pjekjes së frutave.*

*Mustafai ngarkonte torbat me flori dhe në të shumtën e rasteve nisej prej Izmirit në mbrëmje. Ai udhëtonte gjithë natën duke kapërcyer male të thepisura dhe pasi përshkonte rreth 150 km, mëngjesin tjetër arrinte në Çeshme me ngarkesën e tij të çmuar. (...)*

*Ajo që të bën habi këtu, është se nuk kishte ngelur askush që nuk e njihte atë dhe të mos e dinte se çfarë ngarkese kishte. Asnjëri nga tregtarët e Izmirit nuk nguronte të dërgonte paratë e tij gjatë një rruge kaq të rrezikshme...”*

Qoftë për shkak të vullnetit hyjnor që sundon historinë, qoftë për shkak të mosedukimit të brezave idealë që do të ishin flamurtarë të Islamit në të shkuarën dhe gjatë shekujve të fundit, ndodhi që myslimanët mbetën pas nga hapja e horizonteve dhe zemrave të reja, duke u fokusuar vetëm në problemin e mbrojtjes dhe ruajtjes së kufijve ekzistues.

Pavarësisht prej mangësive në aspektin e shkollimit, për shkak se besimi dhe shpirti i popullit ishte ende i mbushur me dashurinë për luftën në rrugë të Allahut, edhe lufta e tij e fundit ishte e mahnitshme.

### FITORJA E ÇANAKALASË

Në këtë luftë, Britania e Madhe (që përfshinte Australinë dhe Indinë), Franca dhe Italia, sulmuan një copë të vogël toke që ishte si një mur me mburojë çeliku, për të kaluar në fillim prej detit, pastaj prej tokës. Populli kishte një vijë kufitare të përbërë vetëm prej zemrës së mbushur me besim tek Allahu, të cilën e mbrojtën me jetët e tyre, aq sa doli edhe shprehja: “Çanakalaja nuk kalohet!”

Këto rreshta prej letrës së një ushtari të luftës së Çanakalasë, përmbledhin qëllimin e pandryshueshëm që prej luftës së Bedrit:

*“O Allah i Madhëruar!*

*E gjithë dëshira e këtyre ushtarëve trima, është t'ua prezantojë emrin Tënd të bukur anglezëve dhe francezëve.*

*Na e plotëso këtë dëshirë fisnike dhe na i mpresh bajonetat e ushtarëve të cilët po të luten Ty në këtë vend të bukur e të qetë, duke u dridhur para Teje. Ti i ke poshtëruar armiqët e Tu, por shkatërroji plotësisht!..”*

Ndërsa një dëshmitar prej ushtarëve, e tregon kë-shtu sjelljen e njerëzishme të Osmanëve ndaj robërve të luftës:

*“Me gjithë epërsinë teknologjike, mundësive dhe të numrit tonë, ne zbrapseshim vazhdimisht përballë guximit dhe përpjekjeve të Osmanëve, pastaj sulmonim përsëri. Në një nga këto sulme, unë u godita rëndë në kokë nga një qytë dhe më ra të ftkët.*

*Kur erdha në vete, e kuptova se ndodhesha midis osmanëve. Në fillim më hyri frika, sepse anglezët na kishin thënë se osmanët janë njerëz të egjër e barbarë. Mirëpo, kur erdha mirë në vete, pashë se plagët e mia ishin të lidhura me fashë dhe më kishin mjekuar. Unë nuk vëreja urrejtje ndaj meje në fytyrën e asnjërit prej tyre. Mbi të gjitha, ata më dhanë edhe ushqime prej çantave të tyre. Unë e dija mirë se ushqimet ishin aq të pakta, madje mund të thuhet se s’kishin fare. Aty përjetova një habi që më shokoi. Këtu isha pothuajse si një mysafir. Tashmë thosha me vete:*

*“Turp për mua! Turp për anglezët gënjeshtarë!”*

Ndërsa bota, gjoja e qytetëruar, që shekullin e fundit kishte arritur fuqi teknologjike, nuk arriti të shfaqë asnjëherë qoftë edhe rregullat më themelore të ligjeve të luftës, ashtu siç i shfaqën ushtritë fituese islame. Me barbarinë që treguan, ata u bënë të njohur si një civilizim grabitqar, pa ndjenja, hiena të zbukuruara dhe të maskuara.

### NJË CIVILIZIM BARBAR...

Dje, ata sulmuan në mënyrën më të pashpirt, në Andaluzi, në Ballkan, në Krime, në Azinë e Mesme, në Afrikë dhe sot po sulmojnë në Lindjen e Mesme, në Siri, në Arakan, në Afganistan, në Kashmir dhe në çdo vend ku gjendet popullsi e vuajtur dhe e shtypur myslimane.

Ata derdhën gjak pa bërë dallim në janë foshnja, gra apo pleq. Sulmuan nderin dhe përdhosën xhamitë. Mbrojtën tiranin dhe i mbyllën sytë ndaj të shtypurit.

Për të shtënë në dorë naftën, ata e konsideruan të lejueshme derdhjen e gjakut. Ata i mbushën anijet e tyre me afrikanët e pashpresë dhe i dërguan si skllevër në Amerikë. Atyre u dhanë ushqimin që hanë kafshët dhe jo atë që hanin vet.

Ky civilizim i maskuar, mbështeti kapitalizmin, që i bën të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Ky sistem i bëri njerëzit skllevër me dëshirë, duke i dënuar të punonin brenda një rrethi të ndyrë që s’ka fund, vetëm për të paguar borxhet e kredive dhe kamatave të tyre.

Po ashtu, ata e shkatërruan familjen me anë të një lirie egoiste, e bënë shoqërinë narkomane, të alkoolizuar dhe të zhytur në kumar, duke i lënë brenda një dhune të gjithanshme. Ndërsa gruan e bënë një mjerane të rrugicave, duke e kthyer në një përfitim të ndyrë tregtar.

Me anë të televizionit, mediave dhe internetit, ata treguan edhe poshtërsinë e prezantimit të botës së tyre të mjerë si një “lumturi e vërtetë”. Për fat të keq, në sajë të këtyre mënyrave mashtruese, e kapërcyen edhe Çanakalanë, na hynë edhe në shtëpi, edhe në xhepat tanë, edhe në vendin e punës, duke na push-tuar zemrat dhe mendjet tona.

Brezi i sotëm, nuk i llogarit gjyshërit që ranë dëshmorë pa iu dridhur syri, për të mos e lënë armikun të shkelë atdheun, të prekë nderin dhe të ndalojë ezanët. Kujt i ngajnë sot nipërit e atyre gjyshërve fisnikë, në aspektin e zemrës e të besimit, në atë të ideve e të mendimit, të ndërgjegjes dhe mënyrës së sjelljes?

### LIGJI I LUFTËS NË ISLAM

Pikësëpari, duhet theksuar se, në përgjithësi, luftërat e Profetit (a.s.), kanë qenë për mbrojtje. Ashtu siç ka ndodhur në luftën Bedrit, në luftën e Uhudit dhe në luftën e Hendekut, edhe lufta e Mutes dhe e Tebukut, kanë qenë luftëra mbrojtëse, të cilat janë zhvilluar për të eliminuar përpjekjet e një sulmi të mundshëm. Ndërsa çlirimi i Mekës, është realizuar në bazë të idesë së rismarrjes së të drejtave që u ishin grabitur myslimanëve dhe për shkak se mekasit shkelën marrëveshjen që kishin bërë me myslimanët.

Domethënë, në themel të të gjitha luftërave të “Profetit të mëshirës”, ka mbizotëruar botëkuptimi i një mëshire dhe drejtësie gjithëpërfshirëse, duke u bërë mëshirë për të gjithë njerëzimin. Për këtë arsye, Islami, i cili ka si parim ruajtjen e paqes, edhe në situatat kur lufta është e domosdoshme, ka ligjëruar një ligj lufte shumë delikat.

Në Islam, është e ndaluar, haram, të luftosh për derdhur gjak dhe për të grabitur toka. Shpata përdoret vetëm për të eliminuar padrejtësitë dhe për t’i hapur rrugën udhëzimit. Një shpatë që nuk i shërben këtij qëllimi, është vetëm një copë hekur.

Edhe në një luftë që zhvillohet për shkak të një situatë të detyrueshme, Profeti (a.s.), ka urdhëruar të mos preken gratë, fëmijët, të moshuarit, të mbjellat

*Shpata zhdukte vetëm padrejtësinë, thyente dyert e burgjeve dhe i shërbente misionit të largimit të pengesave midis njerëzve drejt rrugës së vetme të lumturisë së përjetshme, Islamit.*



dhe ata që ndodhen në kisha apo manastire. Lufta bëhet vetëm ndaj atyre që u hapin luftë ushtarëve Islam.

Urdhrrat e Profetit të mëshirës, janë të qarta:

*“Luftoni në rrugën e Allahut me emrin e Tij dhe përleshuni me ata që nuk e njohin (e mohojnë) Allahun!*

*Mos e tradhtoni plaçkën e luftës!*

*Mos bëni padrejtësi dhe mos torturoni duke prerë veshë, hundë dhe gjymtyrë të tjera!*

*Mos vrisni fëmijë!”* (Muslim, Xhihad, 3; Ahmed, V, 352, 358.)

*“Mos vrisni fëmijët, njerëzit që rrinë në vendadhurimet e tyre dhe merren me adhurime, gratë, të mos-huarit dhe njerëzit që janë pajtuar për punë të tjera jashtë luftës!*

*Mos i digjini e mos i shkatërroni kishat. Mos i prisni pemët me gjithë rrënjë!”* (Buhari, Xhihad, 148)

Gjithashtu, është e ndaluar të preken edhe ata që gjatë luftës kërkojnë mëshirë dhe dorëzohen.

### MASHTRIMI I HUMANIZMIT...

Ky është humaniteti që solli Islami. Ndërsa bota perëndimore që mori si parim humanizmin që solli filozofia, në luftë hedhin raketa dhe bombardojnë fshatrat e qytete. Aty ku bie bomba, djeg e përcëllon këdo që të kapë, gra, fëmijë, pleq, të sëmurë apo doktorë qofshin. Sot, bota po përjeton mizorinë e teknologjisë. I forti shtyp, i dobëti vuan.

Humanizmi është pothuajse asgjë përballë vlerës që Islami i ka dhënë njeriut...

Ky civilizim i maskuar, në botën e tyre mbështetën kapitalizmin, që i bën të pasurit më të pasur dhe të varfrit më të varfër. Ky sistem i bëri njerëzit skllëvër me dëshirë, duke i dënuar të punonin brenda një rrethi të ndyrë që s’ka fund, vetëm për të paguar borxhet e kredive dhe kamatave të tyre.

Po ashtu, ata e shkatërruan familjen me anë të një lirie egoiste, e bënë shoqërinë narkomane, të alkoolizuar dhe të zhytur në kumar, duke i lënë brenda një dhune të gjithanshme. Ndërsa gruan e bëri një mjerane të rrugicave duke e kthyer në një përfitim të ndyrë tregtar.

Me anë të televizionit, mediave dhe internetit, ata treguan edhe poshtërsinë e prezantimit të botë së tyre të mjerë si një lumturi të vërtetë.

Për fat të keq, në sajë të këtyre mënyrave mashtruese, e kapërcyen edhe Çanakalanë, na hynë edhe në shtëpi, edhe në xhepat tanë, edhe në vendin e punës, duke na pushtuar edhe zemrat dhe mendjet tona.

Brezi i sotëm, nuk i llogaritën gjyshërit e tyre që ranë dëshmorë pa iu dridhur syri, për të mos e lënë

armikun të shkelë atdheun, të prekë nderin dhe të ndalojë ezanët. Kujt i ngjajnë sot nipërit e atyre gjyshërve fisnikë, në aspektin e zemrës dhe të besimit, në atë të ideve dhe mendimit, të ndërgjegjes dhe mënyrës së sjelljes?

### NË GJURMËT E KUJT JANË...

A gjenden sot të njëjtat botëkuptime me të njëjtën freski tek nipërit e atyre trimave që dje sakrifikuan jetën për Allahun, atdheun, bashkimin dhe nderin? Apo mos ndoshta janë zbrazur nga brenda dhe janë mbushur me mendime të huaja?

Sipas cilave kriterëve nuk ua japin djersën e ballit punëtorëve të tyre sot bijtë e atij brezi sakrifikues e vetëmohues që dje i dilte për zot robit të luftës e skllavit, duke i dhënë ushqimin më të mirë që hante vetë dhe duke e veshur me atë që vishej vetë?

A ruhet edhe sot e njëjta ndjeshmëri nga ana e tregtarëve në lidhje me hallallin, haramin, hakun e Allahut dhe të robit, ashtu siç veprohej dje kur gjyshërit e tyre ruheshin edhe prej mashtrimit të jomuslimanëve?

Në çfarë gjendjeje është sot ajo vetëdije bashkimi, ajo vëllazëri dhe ai entuziazëm që ekzistonte dje në Çanakala?

Sa ndihet në zemra rënkimi dhe vuajtja e heshtur e mijëra të përvuajturve që po trondisin botën? Sa po u japim zemër vëllezërve tanë që gjenden sot në mjerim, brenda një rrethi të zjarrtë, atje në Siri dhe vende të tjera të ngjashme?

Sa jemi në të njëjtën linjë me sahabët dhe gjyshërit, të cilët plot entuziazëm shkuan në vendet që sot vuajnë nga uria materiale dhe shpirtërore, si në Afrikë, Ballkan, Azi të Mesme etj.?

Çfarë përgjegjësie kemi për të mos e kaluar dhe për të mos e lejuar shkeljen e “kufirit të Allahut”?

Allahu i Madhëruar, na e bëftë të mundur t’u përgjigjemi këtyre pyetjeve në mënyrën më pozitive.

Zgjidhja e vetme për të arritur këtë, është të zbatojmë Sunetin e Profetit (a.s.), në jetën tonë dhe të përpiqemi me dashuri e dëshirë të flaktë si sahabët dhe gjyshërit tanë, për të marrë hisen tonë prej frymëzimit shpirtëror të Profetit (a.s.).

**O Zot!.. Na bëj neve dhe pasardhësit tanë njerëz të kumtimit të fesë dhe shërbimit, të cilët janë të aftë ta shprehin drejtësinë, ëmbëlsinë, mëshirën, bukurinë e Islamit tek njerëzit, në rolin e dëshmitarëve të Tu dhe të së vërtetës!..**

**O Zot! Na bëj prej besimtarëve të ndërgjegjshëm e të butë, që derdhin lot dhe djersë, që ngrysen dhe gdhihen për Ty e për të vuajturit prej umetit të Muhamedit (a.s.)!..**

**Amin!..**

# Rrahim

MANIFESTIMI I VEÇANTË I MËSHIRËS

Ilir Hoxha

Për shkak se emri Rrahim vjen prej një rrënje me emrin Rrahman, në mënyrë të pashmangshme duhet që kuptimet e tyre t'i japim duke i krahasuar me njëra-tjetrën. “Rrahman”, është Ai që mëshirën e Tij ua dërgon të gjitha krijesave pa bërë asnjë dallim. Kjo mëshirë, nuk është e lidhur me asnjë kusht, meritë apo vullnet njerëzor. Për të gëzuar manifestimet e cilësisë “Rrahman”, mjafton të jemi krijuar, pra, të ekzistojmë.

Mirëpo, nëse mëshira e Allahut do të kategorizohet vetëm me cilësinë e Tij “Rrahman”, nuk do të bëhej asnjë dallim midis të mirit dhe të keqit, të drejtit dhe të padrejtit. Pra, fakti që njeriut i është dhënë një vullnet, nuk do të kishte asnjë vlerë, përpjekja për të bërë mirë do të ishte e padobishme dhe përsosja morale do të ishte e pamundur.

Ne e dimë se asnjë emër i Zotit tonë nuk është i pavarur dhe se çdo njëri prej tyre është në marrëdhënie të përsosur me të tjerët. Si rezultat i marrëdhënies së mëshirës me drejtësinë, emri “Rrahim”, shpreh një mëshirë të dytë, të cilën do ta gëzojnë robërit si shpërblim për përdorimin e vullnetit të tyre në rrugën e mirësisë. Kjo tregon se tek Allahu, ai që punon nuk është i barabartë me atë që nuk punon.<sup>1</sup>

Në Kuran, pasi thuhet se mëshira e Allahut përfshin gjithçka, theksohet se kush i beson profetit dhe zotëron disa cilësi të caktuara, në të ardhmen

do të gëzojë mëshirën hyjnore.<sup>2</sup> Për këtë arsye, në përgjithësi është pranuar se, cilësia “Rrahman” i përfshin të gjithë në jetën e kësaj bote, ndërsa “Rrahim”, shpreh mëshirën hyjnore që do të përfshijë vetëm besimtarët në botën tjetër.

Ja pra, Zoti ynë, i Cili e ka përfshirë fillimin dhe fundin tonë me manifestimin dy anësh të mëshirës së Tij, ndërkohë që me emrin “Rrahman”, i fal gjithë njerëzimit një shpresë absolute, me emrin “Rrahim”, i nxit njerëzit që i kryejnë përgjegjësitë e veta, që përpiqen për të mirë dhe janë bamirës, të vazhdojnë të jenë të tillë pa i shpëputur shpresat prej shpërblimit.<sup>3</sup>

Emri “Rrahim”, në Kuran është përdorur 154 herë për të cilësuar Allahun, ndër të cilat vetëm në tre ajete është përdorur i pashoqëruar<sup>4</sup> me cilësi të tjera. Ndërsa në përgjithësi ai është përmendur së bashku me një tjetër prej emrave të bukur të Allahut, si Rauf, Gafur, Teuab, etj., duke u ndjekur gjithmonë me nga një përgëzim. 38 ajete të Kuranit ku trajtohet çështja e teubes, mbarojnë me këtë emër, gjë e cila tregon qartë lidhjen emrit Rrahim me pranimin e teubes.

Në tregimin e tmerrit të Ditës së Kijametit në ajetin 167 të sures A'raf, përdorimi në një vend i cilësive të Allahut Seriu'l-Ikab dhe Gafuru'r-Rahim, na tregon se fuqia e dënimit është ekuilibruar me cilësinë e faljes. Edhe në ajetin 42 të sures Duhhan, është përmendur përsëri emri Rrahim, duke

1. - shih. Bekare, 2/218; Âl-i Imran, 3/132; Nisa, 4/175; Teube, 9/20-21; Neml, 27/46; Nur, 24/56; Ahzab, 33/43; Xhathije, 45/30; Huxhurat, 49/10; Hadid, 57/28.

2. - shih. A'raf, 156-157.

3. - shih. Junus, 26-27.

4. - shih. Nisa, 4/29; Isra, 17/66; Ahzab, 33/43.



u theksuar qartë se shpëtimi në Ditën e Kijametit, do të ndodhë vetëm në sajë të mëshirës së Allahut. Në ajetin 7 të sures Mumtehine, jepet përgëzimi se armiqësia midis njerëzve mund të shndërrohet në dashuri, sepse Allahu është Kadir, Gafur dhe Rrahim. Ndërsa në ajetin 14 të sures Tegabun, këshillohet që sjelljet armiqësore brenda familjes duhet të trajtohen me falje. Këtu, duke përmendur përsëri emrat Gafur dhe Rrahim, Allahu na kujton se edhe ne kemi nevojë për faljen dhe mëshirën e Tij dhe se për ta merituar atë, më parë duhet që edhe ne të sillemi ashtu me njerëzit e tjerë.

Një njeri që është pajisur me moralin e këtij emri, është një njeri që mëshiron ata që Allahu ka urdhëruar të mëshirohen, por që arrin edhe të vendosë ekuilibrin midis mëshirës dhe drejtësisë. Edhe nëse has vështirësi ndërkohë që përpiqet të jetë i dobishëm për njerëzit, ai duron duke dëshiruar vetëm kënaqësinë e Allahut dhe në vend të ankohet për këtë, për shkak se e konsideron veten si meritues për këto vështirësi, ai gjithmonë falënderon Allahun. Ai nuk mburret kurrë me faktin se është duke u përdorur nga Zoti i Tij për punë të mira dhe e di mjaft mirë se është vetëm një mjet për përhapjen e mirësisë.

Sipas asaj që na thotë psikologjia, mëshira, dhembshuria dhe ndjeshmëria emocionale, përveç

shëndetit shpirtëror, ka dobi të mëdha edhe për shëndetin fizik. Këto ndjenja, kanë efekt qetësues tek njeriu dhe e pakësojnë ankthin.

Pedagogia Dr. Ajshen Gyrxhan, në studimin e saj rreth çështjes së ndikimit të Esmau'l Husna/Emrave të bukur të Allahut në formimin e personalitetit, në qendër të personalitetit ka vendosur emrin "Aziz". Në bazë të rezultateve që ka arritur prej analizimit të përdorimit të këtij emri në Kuran, ajo thotë se pranë emrit Aziz, zë vend menjëherë emri Rrahim dhe se fuqia (Aziz) e cila nuk e ka aspektin e mëshirës (Rrahim), nuk mund të shprehë përsosmëri.

Diskutimi rreth faktit se si mund të përputhet mëshira e pafundme që i atribuohet Allahut me emrat Rrahman dhe Rrahim, me fenomenet e këqija që shihen në natyrë, në çdo periudhë qëndron përpara nesh si një problem i cili i vë njerëzit në vështirësi në aspektin besimor. Gazaliu, këtë çështje e shpjegon me faktin se në gjithësi nuk ekziston asnjë "e keqe absolute". Brenda gjërave që në pikëpamjen njerëzore cilësohen si të këqija, ndodhet e fshehur një mirësi që në fillim nuk e shohim. Gjithashtu, ai thekson se nuk duhet pasur asnjë dyshim që Allahu është erhamu'r-rahimin/më mëshiruesi i mëshiruesve. Porse është e pamundur t'i njohim të gjitha të fshehtat e akteve hyjnore.





# MOTIVIMI

## ÇFARË ËSHTË MOTIVIMI?

Njeriu është dërguar në këtë botë për të realizuar disa punë të caktuara. Dhe, në fund do të ketë disa përfitime si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Ja pra, tërësia e sjelljeve, si përpjekja, vullneti, pasioni etj., që shfaqen për të arritur kulmin e përfitimeve në këtë botë, quhet motivim.

## DINAMIKAT E MOTIVIMIT

Tërësia e përpjekjeve që një njeri duhet të bëjë për të arritur sukses në një çështje që dëshiron, quhet dinamikë motivimi. Të gjitha planet dhe programet në lidhje me atë çështje, madje edhe skicimet paraprake, parimet e metodave dhe veprimet, bëjnë pjesë në dinamikat e motivimit. Dinamikat e motivimit ndryshojnë në bazë të personave, kohës dhe veçorive të punës që do bëhet. Sigurisht që në këtë çështje ka edhe parime të përgjithshme. Mirëpo, edhe këto parime të përgjithshme mund të ndryshojnë në bazë të shumë faktorëve, si natyra e njeriut, edukimi, kultura, vendi ku jeton, etj.

Brenda dinamikave të motivimit gjenden dy pika shumë të rëndësishme. Zemra ushqen më parë veten, pastaj pompon gjak në pjesët e tjera të trupit. Ky është një ligj biologjik. Shtrirja e këtij ligji në fenomenet sociale, reflektohet si automotivim. Është e paimagjinueshme që të tjerët të mund të motivojnë një person, i cili nuk motivon dot veten. Ndërsa tjetra, është motivimi i këtij personi që arrin të vetëmotivohet, me anë të një metode të caktuar sipas pozicionit që ka në një punë -qoftë nëpunës, qoftë përgjegjës-.

Motivimi fillon prej lindjes së njeriut. Në fillim, foshnja dëshiron të bëjë vetë ndonjë gjë. Por nëse vihet re, atë e motivon gjithmonë rrethi i vet. Pra, edhe të folurit, edhe ecja, janë të lidhura me këtë motivim të jashtëm. Kjo lidhje është aq e fortë, sa e gjithë kultura dhe gjuha e bashkësisë ku foshnja bën pjesë, i jepen me motivim nga jashtë. Ky motivim është i domosdoshëm deri në një farë moshe, sepse fëmija është i detyruar të shohë dhe të dëgjojë shembujt në këtë mënyrë, që më pas të kalojë në aftësitë e veta.

## KUSH KA NEVOJË PËR MOTIVIM?

Të gjithë, në çdo kohë e në çdo periudhë kanë nevojë për motivim. Në fakt, nëse nuk do të ekzistonte një nevojë e tillë, jeta do ta humbiste kuptimin. Njeriu ka dëshirë të zotërojë disa gjëra, sidomos në këtë botë. Dhe, për t'i arritur këto, duhet të jetë i motivuar nga brenda ose nga jashtë.

Nëse nuk ka motivim, humbet qëllimi i jetës dhe njerëzit mbizotërohen nga depresionet dhe sëmundje të ngjashme me të, si një sistem elektrik që i është djegur siguresa. Dhe, kurimi i këtyre është shumë i vështirë. Njerëzit gjatë gjithë jetës kanë nevojë për doza të caktuara motivimi. Nëse kjo nevojë plotësohet në mënyrën e duhur, atij njeriu i shtohet produktiviteti dhe qetësia.



## LLOJET E MOTIVIMIT

Ekzistojnë disa lloje motivimi. Sigurisht që në formimin e këtyre luan rol të madh edhe opinioni publik, që orienton në mënyrën e duhur apo të gabuar kulturën dhe mendimet tona. Motivimi fillon në familje, vazhdon në institucionet ku njeriu punon, i atribuohet një shoqërie dhe për rrjedhojë i intereson të gjithë njerëzimit. Një ecuri e tillë, mund të jetë një motivim i drejtë, por edhe i gabuar. Ndërkohë që në sajë të motivimit të drejtë mund të arrihen zbulime në dobi të njerëzimit, në sajë të motivimit të gabuar mund të shkaktohen probleme si tensione, grindje, luftëra dhe shumë fatkeqësi të ndryshme njerëzore. Të dyja këto lloj motivimesh kanë shembujt e vetë në histori. Për këtë arsye, zhvillimi i motivimit pozitiv në çdo pjesë të shoqërisë ka një rëndësi të madhe.

Motivimi i vetes dhe i të tjerëve ka disa parime. Këto janë:

Gjykimi i situatës: Përcaktimi i sjelljes në bazë të pozitës dhe situatës në të cilën gjendet individi, është kushti i parë i motivimit. Pra, njeriu duhet ta dijë dhe ta vlerësojë mirë se përse ka ardhur në këtë botë, kush e ka dërguar dhe çfarë pret prej tij. Njeriu që e kalon fazën e parë, mund t'i zgjidhë lehtë të gjitha çështjet e tjera dhe mund të kapë llojet më të bukura të motivimit. Ndërsa njeriu që ende nuk e ka zgjidhur këtë çështje në mendjen dhe zemrën e tij dhe vazhdon të ngurrojë, kurrë nuk mund t'i ngjisë shkallët e tjera. Edhe sikur t'i ngjisë, për shkak se fillimi është i gabuar, ai anon gjithmonë nga rrugët e gabuara.

Familjarizimi dhe tensioni metafizik: Familjarizim, është shfaqja e një zakoni tek njeriu kundrejt diçkaje dhe mos interesimi me gjërat e mrekullueshme dhe origjinale që ndodhen përreth. Kur një çështje dëgjohet për herë të parë, është e gjallë dhe tërheqëse. Mirëpo pasi të ketë kaluar njëfarë kohe, ajo mbetet vetëm një histori në vija dhe kallëpe të ngrira.

Tensioni metafizik, entuziazmi i brendshëm, dashuria, emocioni dhe potenciali i dëshirës, janë burime force që i mbajnë gjithmonë aktive ndjenjat tona shpirtërore dhe na orientojnë në adhurime. Qenia gjithmonë energjike e qendrës së zemrës sonë, do të thotë që gjendja shpirtërore zotëron gjallërinë e pandërprerë me shpirtin e aksionit dhe veprimt.

## ÇËSHTJE NË LIDHJE ME BOTËN E BRENDSHME:

1. Duhet hequr dorë nga uni.
2. Duhet bërë përpjekje.

3. Duhet hequr dorë nga dhënia pas egos.
4. Duhet arritur marifetullahu (njohja e Allahut).
5. Duhet bërë operacion në zemër dhe në shpirt.
6. Duhet që zemra dhe mendja të ushqehen gjithmonë me meditim.
7. Edhe në imagjinatë duhet arritur orientimi i duhur.
8. Duhet kujtuar sa më shpesh vdekja.
9. Duhet punuar për zbutjen dhe delikatesën e zemrës.

## ÇËSHTJE NË LIDHJE ME BOTËN E JASHTME:

1. Duhet qëndruar gjithmonë mes shokëve të mirë.
2. Nuk duhet qëndruar asnjëherë pa u marrë me diçka.

Të shohësh dhe të mendosh globalisht: Kjo është një nga mënyrat më të rëndësishme të motivimit. Përndryshe, gjendja e një njeriu që fiksohet në një pikë të vogël dhe nuk mund të kalojë përtej saj, i ngjan një pllake gramafoni të thyer. Mendimi global është i lidhur fort me edukimin e njeriut dhe zhvillimin e vetes. Përveç kësaj, njeriu mund të arrijë mendimin global në bazë të pozicionit që ka. Nëse arrihet kjo pikë, është zgjidhur një nga anët më të rëndësishme të motivimit.

Kjo çështje, në të njëjtën kohë ka lidhje edhe me dinamikat themelore të besimit, me besimin në kader (caktimin e Allahut). Pasi individi të ketë plotësuar gjithçka që ka për detyrë në planin e shkaqeve, rezultatet i lidh me kaderin. Për rrjedhojë, ai nuk dëshpërohet dhe çdo gjë e konsideron si më të mirën për të. Në të njëjtën kohë, kjo e ruan personin edhe nga shqetësimet shpirtërore. Një individ i tillë është gjithmonë i ekuilibruar në jetë. Pra, për shkak se i vlerëson gjithmonë nga kjo pikëpamje të gjitha ndodhitë, pozitive apo negative qofshin, rezultati nuk është edhe aq i rëndësishëm për të. Edhe sikur të arrijë fitore, edhe sikur të pësojë humbje, tashmë kjo është një gjendje e pranueshme për të.

Gjithashtu, për shkak se i ka plotësuar të gjitha kërkesat e besimit dhe për shkak se shpërblimin e kësaj e pret prej Atij që e ka krijuar, tashmë atij i mbetet vetëm të vëzhgojë ngjarjet.

Kapërcimi i vështirësive: Të arrish të mendosh se çdo problem e ka një zgjidhje, është një nga mënyrat më të mira të motivimit. Në fakt, nuk ekzis-

ton asnjë problem pa zgjidhje. Mjafton të gjenden rrugët e duhura. Për shkak se Krijuesi ynë nuk do të na ngarkonte kurrë me një barrë që nuk mund ta mbajmë, tek ne gjendet aftësia për të zgjidhur çdo problem me të cilin përballemi. Mjafton që ne ta përdorim atë aftësi.

**Aftësia për të dhënë shpërblim:** Një nga dinamikat e rëndësishme të motivimit, është edhe aftësia e individit për të shpërblyer qoftë veten, qoftë personat me të cilët punon. Madje, kjo nuk duhet lënë kurrë pas dore. Dhe ky shpërblim duhet të jetë në përputhje me punën që bëhet. Ashtu siç mund të jetë një shpërblim material, ai mund të realizohet edhe me anë të fletave të lavdërimit ose me anë të komplimenteve me gojë.

**Aftësia për të dhënë dënim:** Është e rëndësishme që individit të jetë i aftë të japë edhe dënime frenuese në përputhje me punën që bëhet, qoftë vetes, qoftë personave me të cilët punon.

**Fytyra e qeshur:** Është një nga dinamikat e motivimit që nuk duhet neglizhuar asnjëherë dhe një prej veprimeve më të lehta. E me gjithë këtë, në ditët tona kjo është një nga veprimet që është harruar dhe kursehet më së shumti.

**Të jesh në paqe me vetveten:** Kjo është shumë e rëndësishme në pikëpamjen e punëve që njeriu do t'i bëjë vetë ose do t'ia bëjnë të tjerët. Njerëzit që nuk janë në paqe me vetveten, nuk mund të bëjnë shumë punë. Ndërsa njerëzit që janë në paqe me vetveten, janë njerëz që kanë arritur t'i hapin dyert e paqes me të gjithë njerëzimin. Këta njerëz mund të hyjnë gjithmonë nga këto dyer dhe, kur tregojnë shembuj të mirë motivimi, mund të realizojnë shumë punë të dobishme në emër të njerëzimit.

**Të zhvillosh dialog të rregullt:** Njerëzit që arrijnë të kenë dialog të mirë me personat me të cilët punojnë kur janë duke bërë çfarëdolloj pune, mund ta zhvi-

llojnë këtë aftësi dhe mund ta vazhdojnë për gjatë gjithë jetës, e jo vetëm për një kohë të caktuar.

**Largimi prej gjërave demoralizuese:** Ndërkohë që je duke bërë çfarëdolloj pune, është e domosdoshme të qëndrosh larg çdo gjëje që mund të demoralizojë. Nëse në një vend ka diçka të gabuar, ai gabim duhet zgjidhur me një metodë të përshtatshme, pa e kthyer në diçka demoralizuese. Kjo, sepse një situatë e tillë e pengon motivimin në mënyrë indirekte dhe prej asaj pune nuk arrihen rezultate të mira.

**Zgjedhja e synimeve të mira dhe të larta:** Nëse synimet zgjidhen gjithmonë të mira dhe të larta, edhe njerëzit e kushtëzojnë më mirë veten drejt atij synimi. Natyrisht që nuk duhet harruar se edhe motivimi duhet të jetë po në atë nivel të lartë.

**Përdorimi i mjeteve të duhura për arritjen e synimeve:** Gjetja e rrugëve të duhura drejt një synimi të caktuar, është një parim që dihet. Nëse përdoren metoda dhe mjete të gabuara, jo vetëm që nuk arrihet synimi, por bëhet shkak edhe i pengimit të motivimit në lidhje me punën.

**Adresimi dhe gjetja e ndërmjetësve të saktë:** Sado i mirë të jetë motivimi, nëse adresimi nuk është i saktë dhe ndërmjetësimi nuk bëhet prej personave të duhur, është e pamundur të arrihet synimi. Për këtë arsye, adresimi i saktë dhe ndërmjetësit e duhur, janë shumë të rëndësishëm në ruajtjen e motivimit, e madje edhe në rritjen e tij.

**Shikimi dhe tregimi i shembujve të duhur:** Në realizimin e një pune të çfarëdoshme, shikimi shembujve, tregimi i tyre dhe përfitimi prej përvojave të njerëzve që kanë punuar dhe kanë arritur suksese në atë punë, është një nga faktorët e rëndësishëm të motivimit.

**Largimi prej çdo mendimi pesimist:** Nëse në një punë të çfarëdoshme nuk arrihet rezultati që pritet, motivimi në mënyrë të





atillë që të mos e mendosh asnjëherë pesimizmin, e bën njeriun të punojë në atë punë derisa të arrijë rezultatin e kërkuar. Për këtë arsye, mos rënia asnjëherë në pesimizëm në asnjë çështje, rishikimi i situatës dhe zhvillimi i zgjidhjeve dhe alternativave sipas kushteve të reja, janë prej parimeve të motivimit.

**Të jesh i ekuilibruar:** Të qenit i ekuilibruar në çdo punë dhe çdo çështje, është po ashtu një nga dinamikat themelore të motivimit. Nëse ky ekuilibër humbet, jo vetëm që nuk do të arrihen rezultatet e kërkuara prej asaj pune, por nuk shkohet as drejt synimit.

**Ruajtja e reputacionit:** Një prej elementëve më të rëndësishëm të motivimit, është që njeriu të ruajë reputacionin në çdo kohë, kusht dhe pozitë që të jetë. Ky është një kredit i madh dhe një faktor i rëndësishëm që e bën të vazhdueshme kredinë e motivimit, madje edhe e shton atë. Në çështjen e reputacionit nuk duhen bërë lëshime edhe sikur ta dish se do vdesësh. Lidhur me këtë, historia është e mbushur me shembuj të shumtë.

**Realizimi i detyrave fetare:** Realizimi i detyrave që na ka ngarkuar feja jonë, vjen në krye të faktorëve që e shtojnë motivimin tonë. Në këtë mënyrë arrihet paqja e brendshme, gjë e cila lind një ekuilibër tek ne dhe na ndihmon t'i bëjmë më me dëshirë punë tona, duke ndjerë kënaqësi prej tyre. Për shembull, zgjimi në namazin e sabahut, është faktori i parë i motivimit në fillimin e ditës. Ndërsa dhënia e zekatit, është faktori që na bën ta përdorim me ndërgjegje të qetë pjesën e mbetur të pasurisë.

### **SHKAQET QË E PENGOJNË MOTIVIMIN**

E kundërta e faktorëve të mësipërm, janë shkaqe që e pengojnë motivimin. Në përgjithësi, individët që nuk janë në paqe me vetveten, që nuk arrijnë të

mendojnë globalisht, që nuk e rishikojnë situatën, që duken gjithmonë në probleme dhe telashe, që nuk u qesh fytyra, që nuk kanë synime të sakta, që nuk punojnë me njerëzit e duhur dhe nuk i japin rëndësi reputacionit, jo vetëm që nuk do të shqetësohen fare e nuk do ta ndejnë përgjegjësinë të motivojnë veten apo të tjerët, por askush në shoqëri nuk do të dëshironte të punonte me këta. Këta njerëz nuk janë konstruktivë, por gjithmonë shkatërrues. Nëse është e mundur, këta njerëz duhen kuruar dhe rehabilituar për t'i bërë përsëri të dobishëm për shoqërinë.

### **ÇFARË DUHET TË BËJMË?**

Të shfletojmë historinë dhe të zhvillojmë modelin e një njeriu dhe motivimi të mirë. Në krye të këtyre vjen Profeti ynë (a.s.) dhe shokët e tij. Qoftë në periudhën e parë të profecisë, qoftë kur ka dërguar delegacione në vende të ndryshme, qoftë gjatë betejave, e qoftë në fund të betejave, Profeti ynë (a.s.), ka treguar gjithmonë shembujt më të bukur të dinamikave që formojnë motivimin e mësipërm, gjithmonë ka bërë vlerësim të mirë të situatës, ka arritur të shohë globalisht në çdo çështje, nuk ka rënë asnjëherë në pesimizëm, gjithmonë ka dhënë kurajë dhe gjatë gjithë jetës ka qenë i ekuilibruar. Gjithashtu, këto veçori i vërejmë edhe tek shokët e tij.

Ajo që na takon neve si individë, është që në dobi të njerëzimit, në fillim të motivojmë veten në mënyrën më të mirë e të bukur, e më pas të motivojmë të tjerët. Ndërsa synimi ynë, duhet të jetë bërja e një jete me dinjitetin dhe reputacionin e të qenit njeri në këtë botë, më pas në botën tjetër, të japim llogarinë e jetës që jemi përpjekur të bëjmë po me atë dinjitet dhe ta përfundojmë këtë proces (sprovë) me shpresën e arritjes së mirësive që na ka premtuar Krijuesi ynë në botën tjetër.

# DIJETARI QË USHQEHEJ PREJ QIELLIT

Muaz Erdem

Galileo Galilei, Johannes Keple, Tycho Brahe... Janë emrat, që në të shumtën e rasteve na dalin përballë kur shfletojmë historinë e astronomisë. Të gjithë këta kanë një aspekt të përbashkët. Këta persona kanë lënë gjurmë të rëndësishme, të cilat vlerësohen si revolucion në botën e astronomisë. Mirëpo, vihet re se shumica e historisë së astronomisë që kemi studiuar, përbëhet nga perëndimorët dhe jomyslimanët. Por a është me të vërtetë kështu? Pra, ndërkohë që në historinë njerëzore astronomët perëndimorë punonin pa pushuar dhe i hapnin rrugën zbulimeve të reja, të parët tanë kanë qëndruar si spektatorë ashtu siç qëndrojmë neve sot?

Përgjigja e kësaj pyetje është një "Jo" e madhe. Interesi dhe nevoja që ndiheshin për astronominë, është e lidhur fort me fushën e bujqësisë. Kjo, sepse stina e mbjelljes ka nevojë për njohjen paraprake të kohës, pra për njohuritë e kalendarit. Veçanërisht egjiptianët kanë qenë të interesuar shumë më nga afër për kalendarin, sepse lumi Nil ishte burimi i jetës për ta dhe fryhej çdo vit në të njëjtën kohë. Përveç kësaj, përcaktimi i kohës më pjellore të tokës, bartte një rëndësi jetike për ta. Një aspekt tjetër, është edhe fakti se në Lindje ka diçka që në Perëndim nuk është shumë prezente: shkretëtira. Karvanët që detyroheshin të kalonin prej shkretëtirave duhet të përcaktonin drejtimin e tyre për të gjetur rrugën. Dhe, në përcaktimin e drejtimit yjet ishin miqtë e pandashëm. Në ajetin 97 të sures En'am, Allahu i Madhëruar urdhëron:

**"Është Ai që i ka krijuar yjet, për t'ju rrëfyer rrugën në errësirat e tokës dhe të detit..."**

Për këto arsye, për herë të parë, ata që janë interesuar seriozisht për astronominë, kanë qenë arabët. Në periudhat e mëvonshme, astronomia u zhvillua shumë tek grekët. Mirëpo, zhvillimin e vërtetë, e mori pas shekullit të VIII prej myslimanëve. E megjithatë, kontributi që i kanë dhënë myslimanët astronomisë midis shekullit të VIII dhe të XV, është fshehur qëllimisht nga ana e historianëve dhe orientalistëve Perëndimorë.

Këtu do të flasim për një astronom, i cili ka jetuar në atë periudhë, që po mundohen ta fshehin dhe emrin e të cilit mbase nuk e keni dëgjuar asnjëherë: El-Battani.

El-Battani lindi në vitin 858 në Battan, në zonën e Harranit, si fëmija i një familje Sabiine<sup>1</sup>. Sabiizmi është përmendur në tre vende në Kuran së bashku me fetë e tjera qiellore. Pjesëtarët e Sabiizmit në Harran ishin adhurues të yjeve. Mirëpo nëse shohim nofkën që ai ka marrë, pra "Battani", kuptohet se ai vetë ka qenë mysliman. Përveç kësaj, studimet e tij për të përcaktuar drejtimin e kiblës, tregojnë se ai ka qenë mysliman.

Battani kishte ndërtuar një observator privat në Rakka buzë lumit Eufrat. Ai filloi të vëzhgonte qiellin që në moshën njëzetvjeçare dhe vazhdoi deri sa ndërroi jetë. Për këtë arsye, nuk është pa vend nëse ne e cilësojmë Battanin si "dijetari që ushqehet prej qiejve".

Battani ka bërë vëzhgime të rëndësishme, veçanërisht midis viteve 887-918. Ai ka vëzhguar lëvizjet e Diellit, Hënës dhe planetëve, duke u përpjekur të llogarisë në mënyrë të saktë orbitat e tyre. Në të njëjtën kohë, ka shfaqur interes edhe për eklipsin e Diellit dhe të Hënës. Ai ka llogaritur në mënyrë tepër të saktë kohëzgjatjen e stinëve. Po ashtu, ka llogaritur edhe pjerrësinë ekliptike me 23° 35'. Nëse kemi parasysh se pjerrësia e saktë ekliptike është 23° 27', do të kuptojmë se sa të përpikta kanë qenë vëzhgimet e Battanit. Përveç këtyre, Battani ka arritur të llogarisë me një gabim shumë të vogël kohëzgjatjen e vitit Diellor me 365 ditë, 5 orë, 46 minuta dhe 24 sekonda.

Battani ka bërë studime të rëndësishme edhe në përcaktimin e drejtimit të kiblës, që ka një rëndësi shumë të madhe në astronominë islame. Në studimin e kësaj çështjeje, ai ka ndjekur një metodë ndryshe nga dijetarët e tjerë. Ai ka gjetur gjatësinë

1. - Sabiin: Një lloj feje, e cila përmendet edhe në Kuran: "Ata që besojnë (në Kuran), hebrenjtë, të krishterët dhe sabi'inët..."



dhe gjerësinë gjeografike të vendit prej nga ku do të përcaktohet drejtimi i kiblës dhe atë të Mekës. Më pas ka përdorur ndryshimin e këtyre gjatësive dhe gjerësive gjeografike dhe ka gjetur drejtimin e kiblës. Kjo metodë është përdorur më vonë nga Ibn Junusi.

Ekzistojnë katër vepra të cilat dihet me siguri që janë shkruar nga Battani. Më e rëndësishmja prej këtyre, është “Kitabu’z-Zixhr”. Në hyrjen e këtij libri, Battani shprehet se e ka shkruar këtë libër duke u nisur nga gabimet dhe debatet që kanë pasur studimet para tij. Ky libër përbëhet prej 57 kapitujve dhe brenda tij gjenden të kataloguar 489 yje dhe të dhënat e orbitave të Diellit, Hënës dhe planetëve. Kjo vepër që përmban të dhëna të hollësishme për

trupat qiellorë, ishte burimi më kryesor dhe i saktë i astronomisë i përgatitur deri në atë kohë.

Kitabu’z-Zixhr është përkthyer tri herë në latinisht dhe ka ndikuar shumë edhe mbi astronomët e famshëm evropianë si Johannes Kepler dhe Tycho Brahe. Ndërsa Nicolaus Copernicus, në veprën e tij revolucionare me titull “De Revolutionibus Orbium Coelestium”, ka shprehur mirënjohjen e tij për Battanin dhe në shumë vende të veprës së tij, ka cituar këtë astronom mysliman që ka jetuar 700 vite para tij. Përveç këtyre, fakti që e gjithë hyrja e veprës së Copernicus është shkruar në arabisht, vë në pah edhe njëherë se kontributi që i kanë dhënë myslimanët astronomisë ka qenë aq i madh sa nuk mund të anashkalohej.

# GËLLTITA NJËQIND MIJË ATOME!

Merve Shanllë

Sa i çuditshëm është ky univers!.. Njeriu i krijuar prej atomit ka një jetë të tërë që studion atomin. E llogarit me matematikë, e provon me kimi, e ndan në pjesë me fizikë dhe me astronomi del në udhëtim drejt botës makro, ndërsa me gjenetikë drejt botës mikro... Për shembull: Kur ndërrojmë vendin e një libri me dorën tonë, veprimi që bëjmë, në fakt është shkaktimi i shtyrjes së atomeve me njëri-tjetrin. Në fund të fundit edhe libri është i përbërë prej atomeve. Ne thithim ajrin, hamë ushqime dhe pimë ujë që përbëhen prej atomeve. Të gjithë përbëhemi prej grincave të vogla. Me duart tona të përbëra prej atomeve mbajmë teleskopin e përbërë prej atomeve dhe me syrin tonë të përbërë prej atomeve vëzhgojmë galaktikat e përbëra po prej atomeve. Shkurtimisht, me atomin vëzhgojmë atomin. Jemi aq të vegjël, aq të vegjël... Ja edhe vendi i sistemit tonë diellor në galaktikën e Rrugës së Qumështit:

Ne ndodhemi në vendin e treguar me shigjetë. Po, ajo pika. Një pikë e vogël, 25 mijë vite dritë larg qendrës së galaktikës.

Galaktika Rruga e Qumështit, që përmban rreth 200 miliardë yje ndër të cilët jemi edhe ne, lëviz me një shpejtësi prej 950 mijë km në orë brenda universit. Pavarësisht kësaj, nuk ndodh asnjë aksident apo përplasje, gjë e cila është një provë që tregon se universi është krijuar në harmoni të plotë. Madje, ndonjëherë edhe pse disa galaktika, që përmbajnë 200-300 miliardë yje kalojnë nëpërmjet njëra-tjetrës, nuk ndodh asnjë parregullsi. Gjerësia e galaktikës sonë, është 100 mijë vite dritë, ndërsa lartësia është 1000 vite dritë.

“Nëse Zoti ka ndërtuar një vend të tillë të mrekullueshëm me kaq kujdes dhe dashuri, kjo do të thotë se Ai ka dëshiruar që njeriu ta zbulojë këtë univers, ta studiojë, ta admirojë, të frymëzohet prej tij dhe më në fund ta gjejë Atë në sajë të universit, gjë e cila është shumë e natyrshme.” (Lee Strobel)

# KARUNI E KA MBUSHUR THESARIN E TIJ PLOT ME AR!

Njerëzit pandehin se sundimi i Karunit është shkaktërruar. Ku është gjithë ai ar që nuk e nxinin shpellat? Cila prej kasave të shteteve ka parë aq ar sa ajo e Karunit? Mos kujtoni se përgjigja është, “asnjë!”. Tashmë, në vend që t’i mbushin kasat me ar, Karunët mjaftohen duke i mbushur me disa kuti ilaçesh. Ndërsa pasuritë e tyre nuk i fshehin në shpellat e errëta, por në dhomat e errëta e të ftohta. Në kohën tonë, kur çdo vit xhirojnë miliarda dollar për ilaçe, nuk gjejnë vend për të vendosur arin. Ju mendoni se lindja e sëmundjeve të reja ditë pas dite, është punë e natyrës? Por fajin nuk do t’ia hedh menjëherë firmave të ilaçeve, sepse ne jemi ata që i shtojnë ato firma të prodhojnë ilaçe të reja, duke u dhënë mundësinë të bëhen Karunët e kohës. Në sajë të përdorimit të shpeshtë të ilaçeve nga ana jonë, mikrobet fitojnë rezistencë, duke i detyruar firmat e ilaçeve të zhvillojnë dhe të prodhojnë ilaçe të reja!

Nuk bëhet fjalë vetëm për sëmundjet, por sot po rritet një brez delikat që e kërkon zgjidhjen gjithmonë tek ilaçet. Fëmijët tanë që nuk lihen të luajnë në dhe e në parqet e lojërave në natyrë, por rriten me kompjuter në dorë nëpër shtëpi të betonuara, kur dalin jashtë sëmurën shpejtë dhe, për t’i shëruar, prindërit u vërsulen menjëherë ilaçeve.

Për rrjedhojë, me ngritjen e standardit të jetesës së shoqërisë sonë të llastuar, në një farë mënyre po varfërohet edhe botëkuptimi ynë për jetën e shëndetshme. Sapo të na dhembë pak koka apo qafa, e po të kemi edhe pak temperaturë, menjëherë i vërsulemi antibiotikëve, qetësuesve analgjezikë dhe antipiretikëve. Kujtojmë se do të fitojmë pavdekësinë duke gëlltitur disa ilaçe pas buke.

Bakteret, ose siç i thonë ndryshe, “mikrobet”, gjithmonë na janë dukur të frikshme. Këto gjallesa bëhen shkak i stërvitjes së sistemit mbrojtës të trupit tonë dhe i mbrojtjes nga sëmundjet e rrezikshme, madje edhe vdekjeprurëse. Por nëse ato bëjnë ndonjë “prapësi” në trupin tonë dhe ne sëmurëmi, armiqësohemi me të gjitha ato dhe duam t’i shkatërrojmë menjëherë me antibiotikë të fuqishëm. Me mendimin “sa më shumë të vrasim, aq më mirë është”, këto baktere

të dobishëm për trupin tonë i vrasim me antibiotikë dhe i japim trupit hare e gëzim me analgjezikë dhe antipiretikë.

*Antibiotikët nuk merren vetëm si ilaç!*

Me shtimin e popullsisë së botës, është vështirësuar edhe sigurimi i ushqimit. Për këtë arsye, Karunët industrialistë janë të detyruar të prodhojnë më shumë mish dhe ushqime bimore! Pula që rriten në një kohë të shkurtër pa e parë asnjëherë dritën e diellit dhe të bombarduara me antibiotikë, me qëllim që të mos sëmuren, na shiten të ambalazuara si pula që janë rritur mbi barin e gjelbër të fermës. Kjo situatë, bëhet shkak që bakteret rezistente ndaj antibiotikëve të kultivuar nëpër ferma, të vihen përsëri para nesh nëpër tavolina.

*Vdekja është shumë më afër nesh!*

Trupi ynë nuk ka gjuhë. Mirëpo, ai është mjeshtër në të folurën me “gjuhën e trupit”. Ngritja e temperaturës ose ndjenja e dhimbjes, nuk do të thotë me patjetër se mikrobet kanë fituar luftën. Përkundrazi, tregon se sistemi mbrojtës i trupit tonë është ende i fortë dhe po bën gjithçka që mundet. Mirëpo, ilaçet që ne përdorim menjëherë, e mbarojnë luftën pa filluar dhe bën që kjo të duket si një “luftë e rremë”, duke e lënë trupin tonë më të dobët e më të pambrojtur ndaj furtunave më të rrezikshme.

Ndër ilaçet që përdoren më shumë në rang botëror, antibiotikët renditen në vend të katërt, ndërkohë që qetësuesit nuk futen në këtë listë. Megjithatë, mendohet se në vendin tonë, përdorimi i antibiotikëve dhe qetësuesve janë në krye të listës. Mirëpo, përpjekja jonë për t’i fshirë sëmundjet në këtë mënyrë, me sa duket ka shkaktuar një ndikimi të kundërt, sepse në vendin tonë, shfaqja e baktereve që kanë më tepër rezistencë ndaj antibiotikëve, është më e lartë se në Amerikë dhe Evropë. Kjo situatë, jo vetëm që na e vështirëson edhe më tepër shëndetin në të ardhmen, por sa vjen, rëndon më tepër edhe për xhepat tanë, duke vazhduar të pasurojë edhe më tepër Karunët e kohës sonë.





# Krijova qelizën që eleminon kancerin!

Në këtë periudhë po punojmë mbi një projekt të ri... Prej njerëzve kemi marrë qeliza, të cilat i kemi ndryshuar gjenetikisht, madje u kemi shtuar edhe disa pjesë prej gjeneve të marra prej minjve dhe kemi ndërtuar qeliza të sistemit mbrojtës, që i njohin qelizat kancerogjene dhe i vrasin ato... Tani për tani, mund të krijojmë qeliza njerëzore të ndryshuara gjenetikisht, të cilat mund t'i njohin dhe t'i vrasin qelizat kancerogjene deri në 90-95%... Por ky nuk është një studim që është bërë dhe realizuar për herë të parë dhe, në laboratorin tonë presin shumë çështje që kërkojnë përgjigje. Në fakt, thelbi i çështjes nuk është ky sukses, por ndjenja arrogante “ne krijuam”, që lindin tek njerëzit suksese të tilla dhe imponimi në një mënyrë të tillë tek njerëzit...

Mendjemadhësia është diçka e keqe... Dhe mbase njerëzit më mendjemëdhenj rezultojnë të jenë prej atyre që merren me shkencë... Shembulli më i afërt i thirrjeve “krijova këtë apo atë”, mund të jepet prej studimeve në biologjinë sintetike... Këto studime, janë në kuadër të projekteve për të cilat kemi punuar çdo ditë në laboratorë ku kemi ndryshuar gjenetikën e gjallesave për t'i përdorur për qëllime të ndryshme. Nga këto, mbase edhe më gjithëpërfshirësi, është projekti i “qelizës sintetike”, ku kanë marrë pjesë më tepër se njëzet shkencëtarë nën udhëheqjen Craig Venter dhe me një buxhet prej dyzet milion dollarësh.

Ky projekt në lidhje me qelizën sintetike që është prodhuar plotësisht në kushte laboratorie, pothuajse nga të gjitha mediat është prezantuar me titujt, “Ata bëjnë rolin e Zotit!”, ose “Ata krijuan qeliza!”, gjë e cila shfaq përpara nesh një tablo që tregon se sa arrogant i bën njerëzit dimensionin materialist i shkencës.

Në mënyrë të përmbledhur, qeliza sintetike, mund të shpjegohet me analizimin plotësisht në kushtet kompjuterike të një kodi të gjallë, prodhimi i tij në kushtet laboratorike, klonimi dhe gjallërimi i këtij kodi të ADN-së brenda një qelize bakteriale që i është hequr ADN-ja. Mirëpo, megjithëse një pjesë e shkencëtarëve jetojnë në botën e mahnitjes që u ka dhënë kjo shkencë në këto lloj projektesh, shpirtërisht ka aq çështje që anashkalohen, sa që edhe disa shkencëtarë kanë filluar ta “shohin veten si Zot dhe

se mund të krijojnë nga asgjëja”.

Në fakt, ekzistojnë disa të vërteta që nuk duan t'i shohin as shkencëtarët që thonë se kanë “krijuar” gjallesa të ndryshme që nuk ndodhen në natyrë dhe as njerëzit që i ndjekin këto zhvillime shkencore dhe thonë “sa të kemi shkencën s’kemi nevojë të besojmë në një Krijues”. Në të vërtetë, asnjë prej kompjuterëve, kodeve të ADN-së, laboratorëve, kimikateve që janë përdorur në prodhimin e ADN-së, nuk janë krijuar nga asgjëja prej njeriut. Domethënë, askush nuk mund të thotë se shkencëtarët kanë krijuar nga asgjëja një gjallesë të re në kushtet laboratorike, ndërkohë që pajisjet, kimikatet dhe madje edhe vetë dija që është në mendjet e shkencëtarëve janë krijuar të gjitha nga asgjëja prej Allahut. E megjithatë heronjtë e “qelizave sintetike të ndryshuara gjenetikisht”, të cilat u prodhuan në sajë të të gjitha këtyre mundësive të krijuara dhe po ashtu me dijen që i është dhënë njeriut, ose e vunë veten në vendin e Zotit, ose u prezantuan si të tillë nga mediat e ndryshme.

Kur shkencëtarët bëjnë një zbulim të ri, janë në dilemë midis thënies “e bëra unë!” dhe “falënderimit të Allahut” për diturinë që u ka dhënë. Shembulli më i mirë i kësaj, mund të jepet prej historisë së Sulejmanit (a.s.), i cili i urdhëroi ndihmësit e tij t'i sillnin fronin e mbretëreshës së Sebës, Belkisës. Këtë detyrë e mori përsipër një njeri prej “ithtarëve të librit”, duke e sjellë fronin para Sulejmanit sa hap e mbyll sytë (me një teknologji që të sjellë ndërmend teletransportin). Kjo histori kuranore, mbase na tregon sjelljen që duhet të ketë njeriu kur të arrijë teknologjinë e teletransportimit në sajë të dijes që zotëron. Përndryshe, ky zhvillim shkencor, padyshim që do të bëhet shkak i mendjemadhësisë dhe arrogancës. Ndërsa Sulejmani (a.s.), ishte i vetëdijshëm se ashtu si sundimi që i ishte dhënë, edhe dija ishte prej Allahut të Madhëruar. **“...Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues.”** (Nemli, 40.)

Ende kemi shumë punë për të bërë...



# Muhasebe

**“O besimtarë, druajuni Allahut, dhe çdo njeri le të shikojë se ç’ka përgatitur për të nesërmen.”** (Hashr, 18)

Muhasebeja (vetëllogaritja) konsiston në llogaritjen e veprave të mira apo të këqija dhe vlerësimin e asaj që ke përgatitur për botën tjetër. Nëse pas muhasebesë udhëtari ka shumë mëkate atëherë duhet të kapet pas takvasë dhe të përpiqet të shtojë veprat e mira dhe pakësojë veprat e këqija. Sipas Ebu Osman El Magribit personit që është në rrugëtimin shpirtëror midis gjërave më të domosdoshme i duhet pikërisht muhasebeja. Po ashtu edhe sipas Vasitiut muhasebeja është elementi më i rëndësishëm për të mbajtur nën kontroll veprimet e dukshme kurse murakebeja (ndjenja e mbikëqyrjes) është më e rëndësishme për të rregulluar pjesën e padukshme të veprave. Kurse sipas Haris ibn Esedit në themel të muhasebesë është njohja, frika dhe shpresa. Krahas këtyre për të arritur një sukses në këtë shkallë duhet qëllimi, vullneti, pendimi, ushtrimi, dhikri, reflektimi dhe devotshmëria. Hapi i parë në shkallën e muhasebesë është një pendim i qëndrueshëm. Muhasebeja ka tre shtylla.

Shtylla e parë është krahasimi midis mirësive të Allahut kundrejt mëkateve të bëra. Në këtë mënyrë gjen mundësinë për të kuptuar se cilat vepra peshojnë më rëndë, të mirat apo mëkatet. Dhe sipas rezultatit të arritur rishikon gjendjen e tij. Sipas Hereviut për të bërë një muhasebe të tillë duhen tre element

a. Dituria për të ndarë të mirën nga keqja, të vërtetën nga gënjeshtra.

b. Vetëdija se pa ndihmën dhe mbrojtjen e Allahut egoja nuk ndërmerr asnjë veprim të mirë sepse ajo është burimi i gjithë të këqijave. Fjala e Jusufit (a.s) **Unë nuk e shfajsoj veten, meqë egoja (e njeriut) është**

**të fort e prirur për të keqe, përveç atij që e mëshiron Zoti im.** (Jusuf,53) shpreh pikërisht këtë gjendje të egos. Mendimi pozitiv për egon pengon evidentimin e mangësive dhe pikave të dobëta.

c. Dallimi midis sprovës dhe mirësisë, thënë ndryshe cila mirësi të afrojnë me Allahun dhe cila të largojnë prej Tij. Të gjitha ato që të afrojnë tek Allahu janë mirësi kurse ata që të largojnë prej Tij janë sprova qofshin në formën e mirësive apo vështirësive.

Shtylla e dytë e muhasebesë është ndërgjegjësimi se detyra e ibadetit është e drejtë e Allahut mbi robin e vet prandaj duhet kryer pa shpresuar për asnjë shpërblim. Çdo vepër është një mundësi dhe një dhuratë për robin për t’u afruar pranë Allahut. Nga ana tjetër çdo mëkat është një argument kundër robit në Ditën e Gjykimit. Prandaj robi duhet të përpiqet që në çfarë do lloj situatë duhet të distancohet nga mëkatet.

Shtylla e tretë është të kuptojë se çdo veprim që i shkakton vetëkënaqësi është argument kundra tij. Vetëkënaqësia për veprimin e bërë e bën njeriun të mendojë se e ka kryer në mënyrë të përsosur detyrën e adhurimit ndaj Allahut. Kjo sjell vetëkënaqësinë e egos e cila nga ana e saj e mashtron njeriun. Çështja më e rëndësishme që duhet të ketë parasysh udhëtari gjatë rrugëtimin të tij shpirtëror është pikërisht kjo. Çdo opinion i egos nuk meriton vlerësimin hyjnor.

Nga ana tjetër udhëtari nuk duhet të mbajë qëndrim kritik ndaj mëkateve të tjerëve dhe të mendojë se është më i mirë se ata. Kjo e çon atë në vetëkënaqësi dhe në mendimin se vetë nuk mund të bjerë në të njëjtën gjendje mirëpo kjo është një mëkat më i madh se mëkati i tjetrit të cilin e kritikoi. Prandaj Imam Hereviu për të mos rënë në një gabim të tillë këshillon që njeriu të jetë vazhdimisht në gjendje vetëkontrolli.



# Natë

Edison Çeraj

Nata nuk është errësirë. Nata është falë ditës. Po edhe dita është falë natës. Të dyja janë falë Kohës. Edhe Koha është falë... Gjej një përgjigje për këtë! Kërko! Mos kërko! Kthehu! Fshehu! Shfaqu! Qëndro! Dëgjo!

Nata ngjan si një motër e vetmisë, ose si strehë e saj. Është ajo kohë dhe ajo gjendje kur njerëzit ikin. Dikush ikën për natën e tij. Dikush ngaqë nuk qëndron dot më gjatë. Dikush për të fjetur, dhe kjo është ikja më e thellë, ndonjëherë pa kthim. Prandaj gjumi njihet edhe si vdekja e vogël. Gjumi është shkëputje. Trupi mbetet, vetja shetgton.

Dhe ti je vetëm. Jo tamam vetëm, pasi ke veten, që nuk mund t'i ikësh kurrë.

Natë. Me veten. Ose vetja me ty. Peshë. Kush peshon më shumë, ti apo vetja? Varet nga njësia matëse. Sidoqoftë vetja është prania më përfshirëse e mundshme. Nata e thellë dhe kjo prani. Një prani. Dy prani. Kjo prani. Dy gjendje dhe qenia në pritë. Prani me të cilën nuk duhet të mësohesh. Vetëm të shqetësohesh e të gëzohesh. Me raste. Pa rastësi. Drithërimë. Lumturimi është një iluzion, ose një embrion që nuk mund të zhvillohet këtu.

Vërshime të brendshme që nuk njohin ndalesë, as pauzë. Pikërisht natën. Në natë. Me natën. Pastaj pa natën. Përsëri natë.

Zërat e heshtjes marrin terren. (Ti nuk i komandon dot.) Një terren kaq i zbrazët që mbushet kaq dendur, kaq depërtueshëm. Dendësi, depërtim dhe zëra në natë. Nata mbështjell çdo gjë përveç vetes. Rrëqethje. Drithërimë. Pastaj hapje. Zbulesë.

Ti vazhdon të mbash peshën. Jepesh, se nuk ke zgjidhje tjetër. Pa u dorëzuar, pa hequr dorë. Ky vullnet. Kjo syçelje. Në vendnumëro. Në lëvizje të papërbalueshme. Arrati dhe përplasje. Kjo të shton edhe ndonjë thinjë. Errësira që zbardh një pjesë tënden, një pjesë të papjesshme, por kaq emblematike. Çdo thinjë është një lajmëtare. Një thinjë. Një dritë.

Pranë vetes, pavarësisht çdo gjëje. Vetja dhe gjëja si një kombinim pa një vijë melodike fikse.

Natë dhe zgjatim në errësirë. Yjet shtojnë thellësinë, por edhe cakun tënd që nuk i gjen dot një emër. Pa emër.

Nata ka poezinë, dita prozën. Natën feks ideja, dita kërkon jetësimin e saj, ose braktisjen. Duke ecur e duke mbjellë. Duke ecur e duke braktisur. Duke u privuar. Duke marrë atë që të takon. Pa jehonë.

Përsëri vetmia dhe kredhja në kujtime ose në imagjinatë. Të tjerët nuk janë asnjëherë natën, edhe pse mund të jenë të pranishëm. Peshon vetja, flutur bëhet tjetri. Tjetri flutur pa krahë. Ti ke nevojë për tjetrin. Nuk ke nevojë për tjetrin.

Objektet heshtin, gjërat rigjallërohen. Dhe kujton. Kujton çfarë ka ndodhur në të ardhmen. Kujton çfarë nuk ka ndodhur në të shkuarën. Ndodh vetëm një çarje e vogël, nga ku kundron ato botë që i beson vetëm ti. Pra një çarje në botë dhe shpresa resht së qenuri absurde për pak çaste. Çaste. Çasti je ti. As para e as pas teje, por përnjëherë me ty. Ato çaste që nxënë të gjitha ditët që kanë kaluar. Çaste që nuk maten me asgjëkafshë; vetëm banohen. Bano dhe mbill. Kthehu e prit. Çaste që e vlerësojnë pritjen me heshtje, ose me melodi. Pa melodi.

Çfarë ndodh natën i takon asaj mbretërie. Përrallat marrin krahë natën, se ditën druhen të shfaqen.

Natë e thellë me hënë. Pa hënë. Më mirë të mos gërvishtej hëna. Tani ajo nuk është më e ndrojtur pas velit. Tani ajo është e guximshme. Pa turp. Me trup. Dje ishte pa trup e me turp. Megjithatë nata vazhdon ta pranojë si stoli. Pa stoli. Dritare. Rrezaton më pak. Më pak se herë më parë dukur. Vetëm dukje. Pak dritë. Falë natës.

Mbështjellje. Çlirim. Udhëtim. Pa lëvizur. Me sy. Me pulitje qepallash. Me zemër. Me natë. Natën. Vazhdo.



# ALIJA IZETBEGOVIÇ

Familja Izetbegoviç lindi në qytetin Bosanski Shamac të Bosnjës. Alija Izetbegoviç shkollën e mesme e kreu në kolegjin Gjerman të Sarajevës. Aty u njoh për përkushtimin e madh që tregonte ndaj shkencës dhe filozofisë. Alija Izetbegoviç qysh në moshën e hershme filloi të lexojë veprat më serioze të filozofisë, artit dhe kulturës evropiane si veprat e Hegelit, Spinozës, Kantit, Spenglerit etj. Gjatë viteve të shkollës së mesme filloi të shfaqë interes edhe për çështjet islame. Në këtë periudhë themeloi klubin e rinisë islame, në kohën që themeloi këtë klub ishte vetëm 16 vjeç por me aftësitë e tij të rralla inteligjente dhe organizative arriti që klubin ta shndërrojë në një qendër aktive. Gjatë luftës së II botërore ky klub realizoi aktivitete shoqërore mjaft të rëndësishme.

Në 13 Janar 1946 Bosnja fitoi pavarësinë, por ngaqë gjatë viteve të luftës partia komuniste kishte luajtur

një rol të rëndësishëm, arriti të merrte pushtetin pas çlirimit. Në këtë mënyrë Bosnja u bë pjesë e federatës Jugosllave. Me shtrirjen e pushtetit komunist në gjithë vendin filloi edhe lufta kundër feve dhe veçanërisht kundër fesë Islame. Duke qenë se Alija ishte i njohur si aktivist islam dhe si një kundërshtar i zjarrtë i ateizmit, menjëherë u vu në shënjestër të pushtetit komunist. Në këtë mënyrë në vitin 1949 u dënua me 5 vjet burg.

Me ardhjen e Titos në pushtet presioni ndaj Alijës u rrit më shumë por ai nuk hoqi dorë nga kauza islame, ai vazhdoi angazhimin e tij intelektual për të ndriçuar dhe zgjuar myslimanët. Me hyrjen në fuqi të kushtetutës së re në vitin 1974 presioni mbi myslimanët u lehtësua pak dhe iu dha e drejta të ri-organizonin institucionet tradicionale islame. Gjatë kësaj periudhe u hapën disa xhami dhe medrese.



Megjithëse në përmasa të vogla hapja e institucioneve islame bëri të mundur një ringjallje të shpejtë dhe të madhe të myslimanëve në Bosnje.

Aktiviteti intelektual i Alijës nuk i shpëtoi sigurimit të brendshëm të shtetit Jugosllav. Kështu më 3 Mars të vitit 1983 Alija së bashku me një grup të madh miqsh u arrestua. Pas zhvillimit të një procesi gjyqësor të inskenuar Alija u dënua me plot 41 vjet heqje lirie në burg. Akuzat ishin për prishje të rendit shoqëror dhe politik në Jugosllavi për të ndërtuar në të shëriatin islamik. Regjimi bazohej në “faktin” se libri Deklarata Islame, i shkruar para disa vitesh dhe i përkthyer në shumë gjuhë të huaja ka shërbyer si libër frymëzues për veprim kundër-revolucionar. Më vonë dënimi iu ul në 9 vjet. Pas ankesave të tij se gjykimi ishte një proces i montuar politik u lirua më 25 Nëntor 1988.

Nisur nga fakti që situata në Jugosllavi ishte shumë e tensionuar dhe kriza politike kishte arritur kulmin, Alija e shikonte të domosdoshëm themelimin e një partie, e cila do t'i artikulonte idetë dhe mendimet e individëve dhe të partisë në tërë territorin e Jugosllavisë. Por ligji jugosllav e ndalonte organizimin politik andaj ai ishte në kërkim të njerëzve që mund ta bartnin këtë mision. Pas shumë konsultimesh, partia u themelua me emrin “Partia e Aksionit Demokratik”. Edhe pse fillimisht partia ka qenë shumëstresore, parti e të gjitha ndarjeve, më vonë, me ndryshimin e kufijve të brendshëm politik të Jugosllavisë, PAD-i u profilizua në parti nacionale boshnjake dhe e boshnjakëve.

Fushata parazgjedhore e PAD-it ishte mbresëlënëse në çdo vend ku shkonin. Duke e pasur parasysh strukturën nacionale dhe fetare, vlen të theksohet qëndrimi i qartë i Alijës se ai nuk donte një Bosnjë islame as një Bosnjë socialiste, por donte një Bosnjë qytetare. Gjithashtu kërkesë e fuqishme e tij ishte që Bosnja të mbetej në Jugosllavi me kusht që të mbeteshin edhe Sllovenia dhe Kroacia, por kurrë vetëm në përbërje të Serbisë dhe të Malit të Zi, sepse ajo do të ishte një Serbi e Madhe. Kësaj kërkesë iu

kundërvu drejtpërdrejtë: “Nëse ka nevojë, Myslimanët me armë do ta mbrojnë Bosnjën.” Në fund fushata parazgjedhore rezultoi me fitore bindëse të PAD-it.

Si anëtarë i ri i Kryesisë së Bosnjës, Alija fitoi të drejtën të merrte pjesë në mbledhjet e Kryesisë së Jugosllavisë. Çështja kryesorë në atë kohë ishte si të ruhet Jugosllavia. Në këtë periudhë Alija bën edhe tubimet e para në botë. Udhëton në Austri, Turqi, Iran, SHBA etj, për ta prezantuar Bosnjën dhe për të fituar përkrahje politike dhe ekonomike, por përkrahja ishte e pamjaftueshme. Me gjithë kërkesat serbe dhe kroate që Bosnja të ndahej, Alija nuk pranonte kurrsesi sepse e dinte që

ndarja di t'i thoshte lamtumirë ekzistimit të mëtejshëm të popullit boshnjak dhe të shtetit të Bosnjës. Lufta në Slloveni dhe më pas në Kroaci tregonte një realitet shumë të qartë: ose duhej të ishe me Serbinë e Madhe ose në luftë. Alternativë tjetër nuk kishte. Kjo e shtyri Alinë që në Kuvendin e BeH-së të kërkojë referendum për të ardhmen e Bosnjës. Referendumi i dha një shenjë jeshile: shumica e popullsisë ishte për Bosnjën dhe Hercegovinën e pavarur. Nisur nga ky rezultat, serbët e Bosnjës me ndihmën e ushtrisë jugosllave, filluan rrethimin e qyteteve boshnjake dhe spastrimin etnik.

Serbët nuk u kursyen as në shkatërrimin e objekteve fetare me fame botërore si, Allaxha Xhamia në Foçë, ajo në Banjallukë etj.

Lufta filloi. Këtë e dëshironin me çdo kusht serbët dhe Serbia. Bosnja nuk e donte luftën, sepse as e gashmë nuk ishte. Por, Bosnja nuk e donte as robërinë, të cilën Alija e quante “zgjidhjen më të keqe, më të keqe se luftën”. Lufta zhvillohej e ashpër. Nuk kursehej asgjë, madje as ndërtesa e Kryesisë së BeH-së, e cila u sulmua dhjetra herë, me pasoja në njerëz dhe dëme materiale. Mirëpo, kjo nuk e trembte Alinë, i cili shpeshherë i vizitonte ushtarët edhe në fushëbetejë dhe gëzonte autoritet të jashtëzakonshëm tek ushtarët e tij, madje deri në shkallën idealiste.





Krahas aktivitetit ushtarak, Alija zhvillonte edhe aktivitet politik ndërkombëtar. Urtësia e tij, dija dhe guximi që kishte, i dhanë atij atributin e një udhëheqësi karizmatik. Nuk munguan edhe mirënjohjet ndërkombëtare si: Shpërblimi i Mbretit Fejsal më 1993 etj. Ai bëri disa udhëtime dhe fjalime në mbledhjet e Konferencës Islame dhe organizmave të tjera ndërkombëtare.

Korriku i vitit 1995 ishte tragjik, këtë muaj para syve të tërë botës ndodhi tragjedia e Srebrenicës, komploti botëror, ku e pësuan mbi 8000 qytetarë të paarmatosur dhe shumëfish më shumë njerëz pa shtëpi, pa të dashurit e tyre. Kjo masakër bëri që me të drejtë të aktivizohet edhe më tepër diplomacia boshnjake, por edhe ajo botërore. SHBA-të më në fund vendosën të pozicionohen në dobi të paqes. Kjo ndodhi më 30 gusht 1995 kur filluan sulmet ajrore mbi pozicionet serbe në tërë Bosnjën. Lufta në terren dhe pozicionet dialoguese u përmirësuan ndjeshëm në favor të Bosnjës.

Më 14 Dhjetor 1995 në Dejton u firmos marrëveshja për përfundimin e luftës. Serbët dhe kroatët donin të arrinin sa më shumë favore në dëm të boshnjakëve myslimanë. Megjithatë, Alija me ekipin e vet qëndroi i pathyeshëm në shumë gjëra, edhe pse në disa gjëra lëshoi pe përballë makinerisë botërore.

Pas Dejtonit shëndeti i Alisë filloi të përkeqësohet. Alija pësoi infarkt. Përkundër rikuperimit, nuk ishte më Alija i vjetër, i pandalshëm. Megjithatë, ai vazhdoi të kryejë shumë detyra me rëndësi, të marrë pjesë nëpër konferenca. Në Perëndim mbronte Islam, kurse në Lindje mbronte Perëndimin, pa harruar se është Musliman.

Më 6 korrik 2000, Alija deklaroi dorëheqjen e tij të përvokueshme në fund të mandatit në tetor të po atij viti. Në një deklaratë për TV, Alija tha: "Sikur të më ofrohej sërish të jetoja, do ta refuzoja. Por, nëse do të duhej sërish të lindesha, do ta zgjidhja jetën time."

### JETA DHE IDETË KRYESORE

Sipas intelektualit të madh boshnjak, Abdullah Sidran, veprat e Izetbegoviçit janë një armë jash-tëzakonisht e fuqishme për boshnjakët dhe fëmijët e tyre, për autorët e ardhshëm dhe historianët, një armë me ndihmën e së cilës do të mbrohet lehtë figura dhe vepra e tij historike nga të këqijtë dhe injorantët e tashëm dhe të ardhshëm.

Vepra *Problemet e rilindjes fetare* të e Alija Izetbe-

goviçit është përmbledhje shkrimesh të lira, tema të rilindjes islame, që i përkasin zhanrit të literaturës fetaro-polike, kurse *Deklarata islame* është manifest politik nga prespektiva islame. Vepra është shkruar në dekadat VI-VIII të shekullit XX.

Ndër veprat më të përkthyer të Izetbegoviçit është *Islami mes Lindjes dhe Perëndimit*. Vepra nuk ka karakter teologjik, por para së gjithash ajo ka karakter publicistik. Ajo nxit përsiatje të gjallë për Islam, dhe për vendin e tij ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, shprehje këto reale dhe figurative, me plot kuptim në kohën e *Luftës së Ftohtë*. Alija ka synuar që idetë e tij t'i shtrojë kryesisht në dy vija të përhershme të mendimit njerëzor: vijën religjioze dhe shkencore.

Vepra *Ikja ime në liri* paraqet shënimet e autorit nga burgu i Foçës ndërmjet viteve 1983-1988. Titulli është figurativ dhe tregon ikjen e autorit në aspektin shpirtëror e ideor dhe jo ikjen fizike.

Libri *Kujtimet* është një arritje e suksesshme në fushën e memoareve, në historinë politike nacionale, rajonale dhe botërore, në historinë e mendimit religjioz, filozofik, etik, sociologjik. *Kujtimet* kryesisht janë autobiografi ose fragmente të jetës së kryetarit të Kryesisë së Beh, në kohën kur e mira dhe e keqja, drejtësia dhe padrejtësia, jeta dhe vdekja, kuptimi dhe absurdi janë të skajshëm, të dëshiruar, por të largët.

Vepra me titull *Robër nuk do të bëhemi* përmban fjalime e paraqitje publike të Alija Izetbegoviçit nga themelimi i Kuvendit të SDA-së më 1990 e deri në fund të vitit 1995, duke paraqitur ekspozenë për Dejtonin nga Kuvendi i BeH-së.

*Ditët e paqes së ftohtë e të hidhur* është një tjetër veper që përmban fjalime dhe paraqitje publike të Alisë, të cilat janë mbajtur ndërmjet viteve 1996-2003. Titulli i veprës *Ditët e paqes së ftohtë e të hidhur* është nxjerrë nga një fjalim i mbajtur disa muaj pas marrëveshjes së Dejtonit në qytetin e Zenicës, kur ai shkurtimisht paraqet fshatrat dhe qytetet e rrënuara, familjet pa kryefamiljarë, invalidët, refugjatët, të papunët.

Vepra *Në Kufij të botëve* përbëhet prej deklaratave, paraqitjeve, mesazheve ndërmjet viteve 1990-2003. Periudha e gjatë e vështirëson të kuptuarin e veprës, sidomos në aspektin e qëndrimi konsekuent të një vije perceptimi, interpretimi dhe veprimi.

*Dinjiteti i zgjedhjes njerëzore* është ndryshe nga veprat e tjera, sepse në vetvete ka pjesë që flet për të tjerët dhe pjesën ku të tjerët flasin për të.



# ETIKA DHE ESTETIKA PËRBËJNË NJË BINOM

Edison Çeraj

## Etika dhe estetika janë një

- WITTGENSTEIN -

Kemi pasur rastin ta theksojmë edhe më parë, se etika dhe estetika nuk bëjnë dot pa njëra tjetrën. Anashkalimi i njëres apo i tjetres përbën një gjymtim – së pari metafizik – të llojit të vet. Nuk duhet ndonjë përpjekje akademike për të marrë me mend se ato janë dy anë të së njëjtës medalje. Sa më shumë t'i japësh rëndësi njëres duke zhvlerësuar tjetër, aq më afër të pamundurës je. Sa më shumë të mendosh e të jetosh një ekuilibër mes të dyjave, aq më e mundur bëhet jeta.

Nëse e figurativizojmë më tej, kjo marrëdhënie është si marrëdhënia e lëvozhgës/lëkurës me frutin.

Në njëfarë kuptimi, etika, që ka dhe forcën më të madhe të rëndesës, nuk mund të jetësohet apo të shpërfaqet ndryshe përveçse nëpërmjet një ndërmjetësimi të caktuar – le të themi – estetik. Pra, një gjendje estetike e caktuar, natyrisht që fshihet edhe një etikë të caktuar, siç ndodh në rastin e një veprë arti, ku raporti mes formës dhe përmbajtjes përkthehet si marrëdhënia mes estetikës dhe etikës. Por, këtë marrëdhënie e hasim gjithandej: në arkitekturë, urbanistikë, letërsi, mjekësi, teknologji, te marrëdhëniet mes njerëzve e kështu me radhë.

Qoftë edhe një buzëqeshje, – që fatkeqësisht na është shndërruar në një forcë zakoni që e vazhdon incerinë falë muskujve të fytyrës – e bart këtë marrëdhënie mes estetikës (vënia re e saj/tërheqja) dhe etikës (mesazhi që marrim prej saj).

Nëse do marrim rastin e arkitekturës dhe urbanistikës, do vëmë re se është dallimi etik apo botëkuptimet e ndryshme që bëjnë dallimin edhe në rrafshin estetik të një qyteti nga tjetri. Fjala vjen, nëse krahasojmë Jerusalemin me Romën e dikurshme apo Firencën dhe Dubain sot, do kuptojmë shpejt se pas dallimit të madh që shohim mes këtyre qyteteve, qëndron një dallim po aq i madh dhe më i rëndësishëm në rrafshin etik. Dubai e ka sfidën me të

## Duku siç je ose ji siç dukesh

- RUMIU -

shkuarën, ndërsa Firencja me të ardhmen. Kjo ngaqë Dubai apo çdo qytet i ri që shkaktoi modernizmin nuk ka të shkuar, dhe i duhet ta shpikë atë, kurse Firencja e ka sfidën me të ardhmen, pikërisht ngaqë i duhet të ruajë të shkuarën, nga e cila ka përfutur identitetin që ka.

Po kjo ndodh edhe me vetë ndërtesat, ku secila ka formën e vet arkitektonike në varësi të qëllimit për të cilin është ngritur. Është qëllimi, domethënë aspekti etik, që përcakton mandej edhe dukjen, pra aspektin estetik.

Përjetimi që na shkakton një veprë arti nuk vjen ndryshe te ne përveçse nëpërmjet një shpërfaqjeje apo manifestimi të caktuar estetik. Në njëfarë mënyre, ana estetike është një lloj kujtese për ne se kemi diçka për të marrë nga vepra, qoftë një mesazh konkret/të kapshëm, qoftë një përjetim të brendshëm të pashprehshëm.

Kështu ndodh edhe me muzikën: ajo që dëgjojmë është vetëm një vello të cilën vetëm pak individë arrijnë ta depërtojnë, për të bujtur në këtë mënyrë në një realitet tjetër.

Mbi të gjitha, përthyerjen e këtij binomi e hasim te vetë qenia njerëzore, ku ajo çfarë ne shohim dhe dëgjojmë nga njëri-tjetri janë reflektime të asaj çfarë besojmë dhe mendojmë. Secili është peng i qëndrimit të tij etik mbi jetën.

Siç na mësojnë të gjitha traditat e hershme, njeriu përbëhet nga trupi dhe shpirti<sup>1</sup>, dhe marrëdhënia për të cilën po flasim është rrjedhojë e natyrishtme e këtij binomi qenësor.

Çekuilibrimi i këtij binomi shkakton çekuilibrim edhe te binomi etikë-estetikë.

1. Përkthimi: kemi një anë të kapshme dhe një anë të pakapshme; një anë të konstatueshme dhe një anë tjetër të pakonstatueshme; një anë të ndriçuar dhe një të errët; një anë normale dhe një anë anormale; një anë të parashikueshme dhe një tjetër të paparashikueshme; një anë vetmitare dhe një tjetër shoqërore e kështu me radhë.





## Sulbe të zgjedhura

Naim Drijaj

# Istihare, Istishare

Kur myslimani është në dyshim për të bërë diçka ose ballafaqohet me një problem, atëherë ka dy zgjedhje të bëjë: istihare dhe istishare.

**Istihare do të thotë:** Të lutësh Allahun e Lartësuar të të drejtë nga vendimi më i drejtë. **Istishare do të thotë:** Të konsultohesh me njerëzit e ditur, të mençur dhe të urtë etj. Këto dy rrugë janë edhe suneti (praktika) e Pejgamberit (a.s.). Si argument për këto dy vepra imam Neveviu në librin e tij **“Rijadus-Salihin”** ka sjellë dy ajete dhe një hadith.

Argumenti i parë që ka përmendur imam Neveviu është urdhri Allahut, ndërsa argumenti i dytë është lavdërimi prej Tij. Allahu (xh.sh.), i drejtohet profetit Muhamed (a.s.), por njëkohësisht edhe gjithë besimtarëve me këto fjalë: **“...Konsultohu me ata për çështje të ndryshme...”**<sup>1</sup> Në këtë ajet shohim se si Allahu e urdhëron të Dërguarin e Tij që vazhdimisht të konsultohet me shokët e tij. Jo vetëm se ai ka pasur nevojë për konsultim, por edhe për t’u mësuar myslimanëve se konsultimi është cilësi e pandarë e besimtarit.

Taberiu në komentimin e këtij ajeti thotë: “Pa dyshim se Allahu e ka urdhëruar të Dërguarin e Tij që ai të konsultohet me umetin, por edhe umeti të konsultohet për situatat e reja me të cilat ndeshet.”<sup>2</sup> Në komentimin e ajetit të mësipërm Fahrudin Raziu përmend fjalët e Hasanit dhe Sufjan ibn Ujejes, të cilët kanë thënë: “Vërtet Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë urdhëruar konsultimin që duhet kthyer në shprehje për umetin”.<sup>3</sup>

Ibn Kethiri, në komentimin e këtij ajeti përmend shembujt praktikë të konsultimit të Pejgamberit (a.s.), me shokët e tij dhe që janë të shumtë, siç ishte rasti i betejës së Bedrit, Uhudit, Hendekut, marrëveshjes në Hudejbijes, si dhe shumë situata të tjera.

1. Ali Imran, 159.

2. Taberiu në tefsirin e tij.

3. Fahrudhin Er-Raziu, në tefsirin e tij “Mefatihul-l-Gajb”.

Saadi, në tefsirin e tij, në komentimin e ajetit të lartpërmendur, thotë se na parashtrohet një pyetje logjike: “Në qoftë se Allahu iu drejtua të Dërguarit të Tij, i cili është me mendim më të plotë, më i dituri, me pikëpamje më të mira, me fjalët: “konsultohu me ta”, atëherë merret me mend se si duhet të veprojnë të tjerët.”

Konsultimi është fryt i bashkimit të dashurisë dhe i respektit reciprok.

Në Kuranin famëlartë ka një sure e cila quhet surja Shura (surja e këshillimit, konsultimit). Kjo sure ka zbritur në Meke dhe ka 53 ajete. Në këtë sure përmendet rëndësia e konsultimit. Nëse ju o myslimanë nuk do të këshilloheni dhe nuk do të konsultoheni me njëri-tjetrin, do të dështoni në arritjen e objektivave. Kjo sure vë theksin tek rëndësia e unitetit dhe shmangia e çdo gjëje që çon në përçarje.

Surja mban këtë titull, sepse në një nga vargjet e saj këshillimi midis besimtarëve përmendet si një karakteristikë e atyre që do të fitojnë shpërblimin e Zotit në jetën tjetër. Allahu (xh.sh.), thotë: **“Dhe ata konsultohen mes tyre për punët e veta.”**<sup>4</sup> Imam Katade prej tabiinëve ka thënë: “Kush konsultohet për hir të Allahut për një çështje të caktuar, Allahu e drejton në hajrin e Tij”.

Dijetarët kanë thënë: “Kush bën istihare, nuk pendohet dhe kush konsultohet nuk dështon”.

Omer ibn Abdulazizi ka thënë: “Konsultimi dhe diskutimi janë dyer të mëshirës dhe bereqetit, me ndihmën e tyre mendimi nuk është i gabuar dhe as guximi nuk dobësohet. Kur bëj ndonjë hap, për të cilin jam konsultuar me njerëz kompetentë jam shumë më i guximshëm dhe nuk kam frikë se kam gabuar.”

Edhe sahabet e Profetit (a.s.), janë konsultuar me njëri-tjetrin për çështje të ndryshme.

Omeri (r.a.), në prag të vdekjes ka thënë: “Disa po

4. Esh-Shura, 38.





më sugjerojnë ta emëroj halifin, por unë jam i sigurt se Allahu nuk e humb këtë fe dhe këtë hilafet, të cilën e solli nëpërmjet të dërguarit të Tij. Sidoqoftë, nëse më ndodh diçka, hilafeti mbetet nën konsultimin e këtyre gjashtë vetëve, (Aliut, Othmanit, Talhas, Zubejrit, Sadit dhe Abdurrahman ibn Avf), nga të cilët Pejgamberi (a.s.), u nda i kënaqur. Po ashtu, e di se ka njerëz të cilët e kundërshtojnë këtë, por unë kam luftuar me ta derisa e kanë pranuar Islam. Nëse bëjnë diçka të tillë, ata janë armiq të Allahut dhe të humbur...”<sup>5</sup>

I Dërguari i Allahut (a.s.) ia ka ligjësuar umetit të tij që t’ia parashtrorë Allahut gjërat që kanë dhe që shfaqen gjatë jetës së tyre, dhe t’i kërkojnë Atij të mirën në ato gjëra.

Xhabir ibn Abdullahi<sup>6</sup> (r.a.), thotë: “Pejgamberi (a.s.), na mësonte istiharen (të kërkuarit e asaj që është më e mirë) në të gjitha gjërat, ashtu sikurse na i mësonte suret e Kuranit. Ai thotë: *“Kur dikush prej jush dëshiron të bëjë diçka, le të falë dy rekate namaz (jo farz), pastaj le të thotë: “O Zoti im, Ty të drejtohem që të më orientosh me dijen Tënde për atë që është më mirë për mua. Ty të drejtohem që të më japish fuqi për kryerjen e punëve të mira, me fuqinë Tënde, kërkoj dhuntinë Tënde të pakufishme, Ti je i Gjithëfuqishëm, ndërsa unë nuk kam fuqi, Ti je Ai që posedon dituri, ndërsa unë nuk di dhe Ti je Ai që i di të fshehtat. O Zoti im, nëse sipas dijenisë Tënde, kjo punë është e mirë (hajr) për mua, për fenë time, jetën time si dhe për përfundimin tim atëherë më ndihmo, lehtësoma mua dhe bëje atë të begatshme. Po, nëse në dijeninë Tënde e di se kjo punë për mua është e dëmshme (sherr), për fenë time, për jetën time dhe për përfundimin tim, largoje atë prej meje dhe më largo mua prej saj. Më cakto mua të mirën (hajrin) kudo qoftë, pastaj më bëj të kënaqur me të”*

5. Muslimi.

6. Lindi në vitin 16 para Hixhri (607 diellor) dhe ndërroi jetë në vitin 78 Hixhri (697 diellor). Ai ka transmetuar nga Profeti (a.s.), 1540 hadithe.

Pastaj Profeti (a.s.), tha: “Pas kësaj lutjeje e përmend dhe hallin që ka”.<sup>7</sup>

### CFARË PËRFITJMË NGA HADITHI?

1. Istiharja bëhet me namaz dhe dua.
  2. Vlerën e lutjes së istihares dhe t’u përmbahemi fjalëve të saj siç janë përmendur në hadith duke mos e ndërruar atë.
  3. Mëshirën e Profetit (a.s.), për Umetin e tij, që manifestohej duke u mësuar atyre atë që u sjell dobi në fenë dhe në jetën e tyre.
  4. Lutja e istihares tregon për lidhjen e zemrës së besimtarit me Allahun e Latësuar në të gjitha aspektet.
  5. Praktikimi i detyrimeve, distancimi nga të ndaluarat, praktikimi i të pëlqyeshmeve dhe lënia e të urryerave, nuk kanë nevojë për istihare.
  6. Istiharja është sunet.
  7. Istiharja mund të bëhet në rastet kur njeriu është i pavendosur për diçka.
  8. Në faljen e dy rekateve nuk është kushtëzuar leximi i ndonjë sureje të veçantë, apo ndonjë ajeti të posaçëm pas këndimit të fatihës.
  9. Momenti i duasë së istihares bëhet pas dhënies së selamit. (Pas namazit).
  10. Istiharja nuk është e lidhur me ëndërrat. (Ëndërrat mund të jenë edhe prej shejtanit, nga gjërat që përjeton njeriu gjatë ditës dhe nga Allahu (xh.sh.).
- Pejgamberi (a.s.), nuk ka caktuar numër lidhur me istiharen.

7. Buhariu.



## SHEGA, FRUTI ÇUDIBËRËS

A e dini se shega është një ndër frutat më të rrallë në tokë për nga vlerat që ka për shëndetin? Nëse doni të dini se çfarë duhet të konsumoni gjatë kësaj periudhe, atëherë dini se shega duhet me patjetër të jetë pjesë e konsumit frutor për stinën e vjeshtës. Shega, fruti shërues i pasur me antioksidantë, gjithmonë është vlerësuar si simbol i shëndetit. Jashtëzakonisht të popullarizuara janë lëngu, farat dhe vaji i saj.

Shumë studime kanë vërtetuar që bëhet fjalë për një nga frutat më shëruese në botë për shkak të ndikimit të dobishëm në sistemin kardiovaskular, nervor dhe eshtëror. Është treguar që edhe doza ditore e ekstraktit të shegës nga i cili më së shpeshti e konsumojmë çaj, mund të ndihmojë në uljen e tensionit të gjakut dhe nivelit të kolesterolit. Shkencëtarët konsiderojnë që kjo mund të reduktojë rrezikun nga sëmundjet e zemrës te personat obez për 17 për qind. Përveç dobive për zemrën dhe enët e gjakut, përbërësit e shegës pengojnë rritjen e kancerit të gjirit, prostatës, zorrës së trashë, leukemisë dhe parandalojnë ndryshimet të cilat nxisin rritjen e tumorit.

Shega është po ashtu e mbushur me vitaminë C dhe konsiderohet mjet i shkëlqyeshëm kundër proceseve inflamatorë, ndërsa është burim i shkëlqyer i vitaminës B5, kaliumit, fenoleve natyrale si elagitanin dhe flavonoidet. Përmban fitokimikate që nxisin krijimin e serotoninës për disponim më të mirë dhe estrogenit për ruajtjen e masës eshtërore, ndërsa ky zbulim është jashtëzakonisht i rëndësishëm për parandalimin e osteoporozës. Për ngritjen e imunitetit dhe parandalimin e çrregullimeve shëndetësore ekspertët rekomandojnë konsumimin ditor të 2,5 decilitrave të lëngut të shtrydhur të shegës ose atij kualitativ të blerë. Hulumtimet kanë treguar që vaji i shegës mbron nga kanceri, diabeti, shëndoshja dhe sëmundjet e zemrës, ndërsa të pasurit e antioksidantëve me shumicë e bën shegën aleat të fuqishëm kundër plakjes, ajo kthen elasticitetin lëkurës, duke luftuar njëkohësisht kundër ekzemave, psoriasis dhe lëkurës së djegur nga dielli. Acidet yndyrore që i përmban reduktojnë ënjtjet dhe dhimbjet në muskuj.

Shega është e pasur me fitoestrogjene, të cilat lehtësojnë simptomat e menopauzës dhe paramenopauzës si ndryshimi i disponimit dhe djersitja gjatë natës.

### DOBITË

Studimet shkencore te ditëve të sotme po hedhin dritë mbi të vërtetat; përse kjo bimë është bërë kaq e dashur deri mitike nga të gjithë popujt e botës!? Që në lashtësi, rreth 3000 vjet më parë, njerëzimi i ka pikasur cilësitë e veçanta të kësaj bime në drejtim të luftimit të sëmundjeve dhe përmirësimit të shëndetit njeriut. Studime shkencore rreth përfitimeve mjekësore nga shega kanë qenë të pakta. Vitet e fundit këto studime janë intensifikuar, shumë shkencëtarë po kryejnë kërkime shkencore, të cilat janë në stadin e epruvetave, të provave në kafshë dhe pak aplikime janë bërë në njerëz. Deri tani, shkencëtarët e mjekësisë moderne janë befasuar nga të dhënat e para që kanë zbuluar në drejtim të dobive shëndetësore për njeriun, dhe e kanë cilësuar si një bimë “çudibërëse”. Në kokrrat e shegës është zbuluar një lëndë që quhet punicalagins, një antioksidant që e përmban vetëm shega.

Qendrat shëndetësore prestigjioze në botë e rekomandojnë shegën dhe lëngun e saj për disa sëmundje:

1. Parandalimin e sëmundjeve të zemrës.
2. Parandalimin e Kancerit, veçanërisht kancerin e prostatës dhe të gjirit tek femrat.
3. Për uljen e kolesterolit në gjak.
4. Parandalon mbipeshën.
5. Lufton dëmtimin e qelizave; parandalon degradimin e ADN-së qelizore

### 11 FAKTE QË DUHET T’I DINI PËR SHEGËN, JA ÇFARË KURON

Shega është një frut që është përdorur që nga koha e Hipokratit. Mjekësia tradicionale përdor lëkurën, gjethet dhe farat e saj për të luftuar diarrenë, dizenterinë kronike dhe plagët. Farat e pabëra përdoren



për temperaturën, ndërsa të pjekurat për kollën. Në Romën Antike, ajo ishte e njohur për cilësitë kozmetike të saj.

1. Shega njihet si simbol i pjellorisë dhe i fatit të mirë.

2. Brenda një shege ka rreth 800 kokrra të vogla ngjyrë të kuqe.

3. Lëngu i shegës shton prodhimin e ruazave të kuqe të gjakut dhe zvogëlon ngarkesën kardiake.

4. Ideale për fëmijët e vegjël që kanë kollë dhe temperaturë.

5. Lëngu i shegës është ideal për flokët, lëkurën dhe thonjtë falë përbërësve që ka.

6. Shega është e mbushur me antioksidantë.

7. Parandalon kancerin e mushkërive, të prostatës, të gjirit, gjithashtu diabetin, osteoporozën, etj.

8. Lëngu i shegës shuan etjen, hap oreksin dhe kthjellon mendimet.

9. Shega redukton rrudhat në fytyrë dhe i jep freski asaj.

10. Lëngu i shegës ka 3-4 herë më shumë antioksidantëve se rrushi i zi dhe çaji jeshil.

11. Është shumë e pasur me kalium, hekur dhe vitaminat A,C dhe E.

## LËNGU I SHEGËS, LUFTON INFARKTET DHE IKTUSIN

Lëngu i shegës tashmë mund të quhet një bar i çmuar për zemrën. Nëse pini një gotë me lëng shege çdo ditë, do të mund të parandaloni formimin e pllakëzave në enët e gjakut, duke ulur kështu rrezikun për t'u prekur nga arteriosklerozat. Fruti i shegës është simbol i jetëgjatësisë. Autorët e këtij studimi shpjegojnë se efektet e lëngut varen nga aftësia e organizmit për të përthithur dy gjene që aktivizohen nga substanca oksiduese, të cilët forcojnë muret e enëve të gjakut. Nëse pini çdo ditë një gotë lëng shege, kjo mund të jetë një mënyrë natyrale për të parandaluar dhe luftuar arteriosklerozat. Eksperimenti i kryer mbi qelizat njerëzore të marra nga arteriet koronare dhe te minjtë me nivele tepër të larta kolesterolit në gjak, kanë treguar se lëngu i shegës pengon veprimin e ELK-1 e p-JUN, që janë dy gjene të njohur për favorizimin e formimit të pllakëzave në enët e gjakut dhe ndihmon për aktivizimin e substancave oksiduese.

## PËRDORIMI I SHEGËS NË MJEKËSINË POPULLORE

Në mjekësinë popullore përdoren frutat dhe lëvozhgat e tyre, lulet, farat, rrënjët dhe lëvorja e degëve dhe e rrënjëve, e cila ka shije te athet dhe ere. Shega me

farat e saj te kuqe si rubin është një frutë i shijshëm por edhe shume i vlefshëm për organizmin e njeriut. Ajo është konsideruar si frutë i fertilitetit. Lëngu i shegës përmban mesatarisht 12 për qind sheqer, acide organike, pektine, vitamine C etj. Lëngu dhe vaji i nxjerre nga farat e shegës është një antioksidant i fuqishëm. Vetëm 30 minuta pas marrjes se lëngut te shegës aktiviteti ynë rritet me 32 për qind. Lëngu i shegës shuan etjen, nxit oreksin dhe përmirëson tretjen e ushqimeve. Ai përdoret me sukses në sëmundjet e stomakut dhe te zorrëve, është freskues dhe mënjanon helmet e organizmit. Lëngu i shegës jep rezultate në luftimin e parazitëve që zhvillohen në zorre. Lulet e shegës përmbajnë tanine dhe kanë veti rrudhëse e tonike ; ato rekomandohen në dhimbjet e barkut, në hemorragji, në hemorroidet, si dhe për gargara të

gojës, kundër ënjtjes se bajameve dhe acarimeve te mishrave të dhëmbëve. Lëngu i shegës përdoret me sukses në sëmundjet e stomakut dhe të zorrëve, është freskues dhe mënjanon toksinat e organizmit. Ai i jep freski mendimit të njeriut. Lulet e shegës

përmbajnë tanine dhe kanë veti rrudhëse e tonike ; ato rekomandohen në dhimbjet e barkut, në hemorragji, në hemorroidet, si dhe për gargara (shpëlarje të gojës) kundër ënjtjes së bajameve dhe acarimeve të mishrave të dhëmbëve. Kuron:

- Sëmundjet e stomakut
- Sëmundjet e zorrëve
- Dhimbjet e barkut
- Hemorroidet
- Ënjtjen e bajameve
- Acarimin e mishrave të dhëmbëve

Merren 20-30 gramë lule shege në një litër ujë dhe vihen të zihen për gjysmë ore. Nga ky çaj merren 2-3 gota çaji në ditë. Edhe lëvozhga e frutave të shegës ka veti regjëse. Lëvozhga e thatë, para se të përdoret, duhet të vihet në ujë për disa orë që të zbutet. Çaji i lëvozhgave të shegës përdoret kundër diarreve, si dhe për luftimin e krimbave parazitare të zorrëve. Lëvozhga e frutave të shegës lufton me sukses amebat, të cilat e dobësojnë shumë organizmin, e veçanërisht te fëmijët. Për këtë merren lëvozhgat e një kokrrë shege, vendosen në një enë prej balte dhe zihen në gjysmë litri ujë derisa të mbetet gjysma e sasisë së ujit. Pasi ftohet lëngu, pihen dy gota likerit në ditë, një në mëngjes e një në darkë, gjithmonë para buke, për 10-15 ditë. Pa përdorur tjetër ilaç, organizmi do të çlirohet nga amebat.

**PËRZIERJA MAGJIKE**  
Lëng shege me kivi. Përzierje fantastike, antikancerogjene dhe energjike. Që të dyja përmbajnë sasi të konsiderueshme të vitaminës C.



## SA KOHË MUND TË RRIJË NJË NJERI PA GJUMË DHE PËRSE FLEMË

Ne mund të luftojmë gjumin për një kohë të gjatë, por pas një pike të caktuar, pagjumësia do të na çojë në çmenduri të përkohshme dhe më pas, në vdekje!

Është e habitshme të mendosh sesi ne shpenzojmë kohën e jetës sonë. Nëse një njeri është 78-vjeç, sipas disa përllogaritjeve, shpenzon 9 nga këto vite duke parë televizor, katër vite duke ngarë makinën, 92 ditë në tualet. Ndërsa kur bie fjala tek gjumi, një përllogaritje e thjeshtë tregon se një njeri rreth të 78-ave, 25 vite prej tyre i harxhon duke fjetur. Duke parë sesa shumë kohë kalon në njeri në gjumë, një pyetje e thjeshtë na vjen në mend: – Sa gjatë mund të rrimë ne zgjuar dhe cilat janë pasojat e pagjumësisë? Çdo njeri i shëndetshëm që mund ta provojë personalisht sesi është të rrish pa gjumë, do ta kuptojë. “Nevoja për të fjetur do ta mundë nevojën për të ngrënë” thotë Erin Hanlon, një profesore asistente në universitetin e studimit të gjumit, metabolizmit dhe shëndetit në Çikago. “Truri juaj do të bjerë në gjumë, pavarësisht përpjekjeve tuaja për të qëndruar i kthjellët.”

### PËRSE FLEMË?

Pikërisht domosdoshmëria për të fjetur e bën këtë çështje akoma më misterioze. “Funksioni i qartë i gjumit mbetet për t’u sqaruar”, thotë Hanlon. Ajo shton, se ka diçka rreth gjumit që mesa duket i jep komandën “rivë” sistemit të trupit tonë. Për më tepër, studimet kanë treguar se, gjumi i mjaftueshëm promovon shërimin, funksionin imunitar, metabolizmin e duhur, dhe shumë më shumë – e cila është ndoshta arsyeja pse ndihemi të rifreskuar pas një gjumi të mirë.

Në anën tjetër, dremitja e pamjaftueshme është një ndër shkaktarët e diabetit, sëmundjeve të zemrës, obezitetit, depresionit e shumë sëmundjeve të tjera. Për të kuptuar sesi afrohen këto pasoja, gjumi na jep disa shenja siç janë: mungesa e energjisë, djegia e syve, qepallat e rënda, etj. Nëse përpiqemi të luftojmë gjumin atëherë do të përballemi me

mungesën e përqendrimit dhe dëmtimin e memories afat-shkurtër. Nëse i injorojmë këto efekte anësore dhe rrimë zgjuar, truri jonë do të pësojë kriza. Do të bëhemi paranojakë dhe do të shohim objekte që nuk ekzistojnë, do të shohim halucinacione dhe ndoshta edhe çmendemi. Këtë i ka konfirmuar edhe drejtori i Universitetit të Kalifornisë në San Diego, i cili studion gjumin. Shumë studime kanë dokumentuar një rënie paralele të trupit gjatë privimit të gjumit. Hormonet e stresit të tilla si adrenalina dhe kortizoli pësojnë rritje në gjak, nga ana tjetër shkaktojnë ngritjen e presionit të gjakut. Megjithatë studimet kanë treguar se këto sëmundje janë të përkohshme nëse gjumi rikthehet në sistem.

### KUR PERDET NUK MBYLLEN KURRË

Po sikur gjumi mos vijë kurrë? Ekziston një sëmundje e rrallë gjenetike e njohur si Fatal Familial Insomnia (FFI) e cila përfaqëson pagjumësinë ekstreme. Rreth 40 familje në botë kanë sëmundjen FFI në genet e tyre. Një gen i sëmurë shkakton proteinat e trurit të ngecin në gracka dhe të humbasin funksionin e tyre primar. Këto gracka janë disa proteina në formë qesharake dhe janë në formën e vrimave të djathit zvicerian dhe dëmtojnë talamusin. Një i prekur nga kjo sëmundje nuk arrin të çlodhet dhe si pasojë has simptoma si pupila të zvogëluara të syrit dhe djersitje masive. Pas pak javësh, viktimat e kësaj sëmundjeje pësojnë vegime, ecin somnambul, kanë lëvizje të pavullnetshme të muskujve të cilët herë pas here bien në gjumë, humbasin në peshë dhe mund të vdesin. Megjithatë, pagjumësia në vetvete nuk është menduar të jetë një agjent vdekjeprurës, sepse FFI të çon në dëmtimin e përhapur të trurit. “Nuk është humbja e gjumit e cila i vret këta individë”, thonë studiuesit. Kjo mënyrë pagjumësie, shpesh e



përdorur si taktikë torture tek të burgosurit nuk ka shkaktuar vdekjen (edhe pse ata vuajnë tmerrësisht). Studime nga Allan Rechtschaffen në Universitetin e Çikagos në vitet 1980 i cili ka vendosur disa minj në një tabaka me ujë që rrotullohej dhe nuk i lejonte ata të flinin, rezultoi se pas një muaji përpjekjesh e eksperimentesh, të gjithë minjtë ngordhën. Me shumë gjasa, stresi dhe përpjekjet për të fjetur rreth 1000 herë në ditë i ka vrarë ata. Ndër simptomat e tjera, minjtë shfaqën çrregullime në temperaturën e trupit dhe humbje në peshë, pavarësisht oreksit në rritje. Ky është problemi në interpretimin e studimeve të gjumit mbi njerëzit dhe kafshët: nuk mund të privosh një person ose një kafshë për gjumë bashkëpunimin e tyre dhe nuk imponosh një sasi të mjaftueshme të stresit”, thotë Siegel. Nëse vdekja ndodh, pyetja është: “Kush është shkaktari, stresi apo humbja e gjumit? “Ky nuk është një studim i thjeshtë”

## HAPËSIRA: 7 MISTERE ENDE TË PAZGJIDHURA

Eksplorimi i hapësirës ka ecur me hapa gjigante, por njeriu vetëm tani është duke projektuar kalimin e kufijve të Sistemit tonë Diellor. Në këtë mënyrë ka shumë pikëpyetje për Universin dhe Hapësirën, ja cilat janë shtatë misteret më të mëdha.

### 1- VRIMAT E ZEZA

Teleskopët, sado të perfeksionuar qofshin janë në gjendje të kapin dhe perceptojnë rrezatimin elektromagnetik, rrezet X dhe së fundmi, valët gravitacionale, por ende deri me sot asnjë nuk e di se çfarë ka brenda kësaj “rëre të lëvizshme” kozmike që është në gjendje të ushtrojë një tërheqje të tillë gravitacionale, së cilës edhe vetë drita nuk mund t’i shpëtojë.

### 2- BOSHLLËKU GJIGAND

Kjo zonë në hapësirë ndodhet 1.5 miliardë vite drite larg nesh dhe që ka një diametër që besohet se është rreth 1.3 mijë vite dritë, dhe që shquhet pikërisht për atë që nuk përmban brenda vetes. Ka vetëm pak galaksi të shkueshme, pra pak materie. Nuk është një Vrimë e Zezë, por një boshllëk i materies së errët. Mendohet se brenda kësaj zone, por edhe në disa të tjera, më të vogla, të Universit, mund të fshihet origjina e energjisë së errët.

### 3- MATERIA E ERRËT

Është një element i nevojshëm për të shpjeguar disa anomali që përfshijnë prezencën e disa masave që nuk arrijmë t’i dallojmë me aparaturat që kemi në dispozicion. Mendohet se përbën 27% të të gjithë Universit, por me gjithë përpjekjet për evidentimin e saj, ende edhe sot vazhdon të mbetet e panjohur.

## ZGJOHU, ZGJOHU!

E gjitha kjo mund të bëjë që shumë njerëz të eksplorojnë kapacitetin e të qëndruarit pa gjumë, por pyetja tjetër është: sa gjatë mund të qëndrojmë zgjuar? Deri më sot, rekord pagjumësie ka shënuar 17-vjeçari, në atë kohë, Randy Gardner një student në San Diego të Kalifornisë. Për një projekt shkencor në vitin 1964, Gardner mundi të rrinte zgjuar për rreth 11 ditë ose 264 orë. Rekord tjetër më vonë në vitin 1977, shënoi një grua britanike e cila qëndroi në një karrige rrotulluese për 18 ditë.

Në përgjithësi, juria vlerëson sesa një njeri mund të qëndrojë zgjuar, por kjo nuk është diçka e mirë. Si pasojë në dhjetë vitet e fundit Libri i Rekordeve Guinness e ka hequr këtë rekord nga klasifikim.

Një hipotezë thotë se ajo mund të jetë e përberë nga vrira të zeza në fillesat e tyre.

### 4- ENERGJIA E ERRËT

Mendohet se përbën 68% të energjisë së gjithë masës së Universit dhe përgjegjësjë kryesore që çon në zgjerimin e tij.

### 5- MAGNETI I MADH

Është një anomali gravitacionale 220 milionë vite dritë larg nesh, që tërheq galaksi, përfshi edhe Rrugën e Qumështit, me një forcë të barabartë me atë të 1 mijë miliard diejsh si yni. Galaksia jonë është drejtuar drejt kësaj anomalie me një shpejtësi prej 2 milionë km në orë. Për disa shkencetarë të tjerë, është një akumulim i materies së errët.

### 6- “PEGGY”, HËNA E SATURNIT

Në vitin 2013 ndërsa fotografonte unazën A të Saturnit, sonda Cassini evidentoi një anomali në ekstremin e saj, 20% më pak e shkëlqyeshme se pjesa tjetër. Mendohet se është një Hënë e vogël me diametër 1 km në formim e sipër.

### 7- ANOMALIA DI KIC 8462852

22% e shkëlqimit të yllit që ndodhet 1.480 vite dritë larg duket si e rrjetëzuar. Kjo anomali është e pashpjegueshme edhe me prezencën e një planeti të madh si Jupiteri në orbitën e yllit. Hipotezat e deritanishme flasin për ndonjë lojë që bën vetë drita, por ka edhe nga ata që mendojnë se ne afërsi te saj ndodhet një megastrukturë aliene. Pritet që të dhënat e James Webb Space Telescope të mund të thonë ndonjë gjë më shumë për këtë.



O besimtarë!  
Pranojeni  
Islamin tërësisht  
dhe mos ndiqni  
hapat e shejtanit  
sepse ai është  
armiku juaj  
i përbetuar.

*(Bekare, 208)*